

# Udhëzues praktik për dhënien e informacionit Qasja në procedurën e azilit





# **Udhëzues praktik për dhënien e informacionit**

**Qasja në procedurën e azilit**

**Shkurt 2023**

On 19 January 2022, the European Asylum Support Office (EASO) became the European Union Agency for Asylum (EUAA). All references to EASO, EASO products and bodies should be understood as references to the EUAA.



Manuscript completed in November 2022

Neither the European Union Agency for Asylum (EUAA) nor any person acting on behalf of the EUAA is responsible for the use that might be made of the information contained within this publication.

Luxembourg: Publication Office of the European Union, 2023

Print ISBN 978-92-9403-547-9

doi:10.2847/28762

BZ-09-22-072-SQ-C

PDF ISBN 978-92-9403-548-6

doi:10.2847/829448

BZ-09-22-072-SQ-N

© European Union Agency for Asylum (EUAA), 2023



This document was translated and published thanks to the “EU Regional Support to Protection-Sensitive Migration Management in the Western Balkans”, a project funded by the European Union. Its contents are the sole responsibility of EUAA and do not necessarily reflect the views of the European Union.

Cover page illustration amended from SiberianArt © iStock, 2021

Reproduction is authorised provided the source is acknowledged. For any use or reproduction of photos or other material that is not under the EUAA copyright, permission must be sought directly from the copyright holders.



# Informacion për udhëzuesin

**Pse u krijua ky udhëzues?** Misioni i Agjencisë së Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) është të lehtësojë dhe mbështesë aktivitetet e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendeve të asociuara (vendet e BE+ <sup>(1)</sup>) në zbatimin e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS). Sipas synimit të saj të përgjithshëm për të promovuar një zbatim korrekt dhe efektiv të CEAS dhe për të mundësuar konvergencën, EUAA-ja zhvillon standarde dhe tregues të përbashkët operacionalë, udhëzime dhe mjete praktike.

**Si u zhvillua ky udhëzues?** Ky udhëzues është rezultat i një përpjekjeje të përbashkët midis ekspertëve nga vendet e BE+, EUAA-së dhe Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (Frontex). Një kontribut i vlefshëm ka ardhur nga Komisioni Evropian, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnimin e Institucioneve të Zbatimit të Ligjit, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët dhe Këshilli Evropian për Refugjatët dhe Personat në Ekzil <sup>(2)</sup>. Para se të dilte versioni përfundimtar, u krye një konsultim me të gjitha shtetet BE+ nëpërmjet Rrjetit të EUAA-së për Proceset e Azilit. Ne dëshirojmë të falënderojmë anëtarët e grupit të punës që përgatitën hartimin e këtij udhëzuesi: Pavol Cích, Christina Kallergi, Konstantinos Koulaxidis, Ľubomíra Mieresová, Nadine Santos de Brito, Daniela Stross dhe Gerfried Tschoegl.

**Kush duhet ta përdorë këtë dokument?** Ky udhëzues synohet kryesisht për zyrtarët e kontaktit të parë, zyrtarët e regjistrimit dhe politikëbërësit pranë autoriteteve kombëtare. Gjithashtu, ky udhëzues është i dobishëm për çdo person ose organizatë tjetër që punon ose është përfshirë në fushën e dhënies së informacionit në kontekstin e qasjes në procedurën e azilit në kontekstin e BE-së.

**Si ta përdorim këtë udhëzues.** Ky udhëzues është i strukturuar në tri pjesë, që u korrespondojnë tre kapitujve. Kapitulli 1 jep udhëzime mbi parimet bazë të dhënies së informacionit, teknikat dhe kanalet e komunikimit. Kapitulli 2 jep udhëzime mbi strukturën organizative të dhënies së informacionit gjatë qasjes në procedurën e azilit dhe Kapitulli 3 jep udhëzime mbi informacionin që duhet t'i jepet aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare gjatë qasjes në procedurën e azilit.

Ky udhëzues praktik për dhënie të informacionit në kontekstin e qasjes në procedurën e azilit bazohet në standardet e CEAS. Ai duhet parë si një plotësues i mjeteve të tjera të disponueshme të EUAA-së, në veçanti, mjeteve praktike për qasjes në procedurën

<sup>(1)</sup> 27 Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, të plotësuara nga Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.

<sup>(2)</sup> Vini re se udhëzuesi i finalizuar nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Agjencisë së Bashkimit Evropian për Trajnimin e Institucioneve të Zbatimit të Ligjit, Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët ose Këshillit Evropian për Refugjatët dhe Personat në Ekzil.





e azilit <sup>(3)</sup> dhe *Udhëzuesin praktik për regjistrimin: Depozitimi i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare* <sup>(4)</sup>. Në të njëjtën kohë, konsistenca e tij me mjetet e tjera ka qenë një konsideratë parësore, veçanërisht në lidhje me modulën e kurrikulës së trajnimit të EUAA-së “Komunikimi dhe dhënia e informacionit për azilkërkuesit” <sup>(5)</sup>.

**Si lidhet me legjislacionin dhe praktikën vendase ky udhëzues?** Ky është një mjet i butë konvergjence. Ai pasqyron standardet operationale të pranuar të përbashkëta të vendeve BE+. Ky mjet nuk është ligjërisht detyrues.

#### **Deklaratë për përjashtim nga përgjegjësia**

Ky udhëzues u përgatit pa cenuar parimin se vetëm Gjykata e Drejtësisë e BE-së ka autoritetin të bëjë interpretimin e legjislacionit të BE-së.

<sup>(3)</sup> EASO-Frontex, *Qasja në procedurën e azilit – Mjete praktike për zyrtarët e kontaktit të parë*, 2016.

<sup>(4)</sup> EASO, *Udhëzues praktik mbi regjistrimin – Depozitimi i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare*, Dhjetor 2021.

<sup>(5)</sup> Shiko EASO, *Katalogu i Trajnimit, Qendra e Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional*, fq. 14.





# Përmbajtja

<b>Lista e shkurtimeve .....</b>	<b>7</b>
<b>Hyrje .....</b>	<b>8</b>
<b>1. Parimet dhe aftësitë bazë për dhënie e informacionit.....</b>	<b>10</b>
1.1 Kërkesat ligjore.....	10
1.2 Si të komunikoni informacionin .....	13
1.2.1 Teknikat bazë të komunikimit.....	13
1.2.2 Komunikimi verbal.....	17
1.2.3 Përshtatni teknikat tuaja të komunikimit me rrethanat personale të aplikuesit për mbrojtje .....	22
1.3 Si të përcillni informacionin .....	30
1.3.1 Merrni parasysh kanalet e komunikimit që do të përdoren.....	30
1.3.2 Përdorni disa kanale në të njëjtën kohë .....	36
1.3.3 Mbështetni dhënie e informacionit me materiale të ndryshme informative .....	36
<b>2. Struktura organizative e dhënies së informacionit.....</b>	<b>42</b>
2.1 Koha e dhënies së informacionit.....	43
2.1.1 Identifikoni mundësitë për të dhënë informacion .....	44
2.1.2 Përcaktoni kohën e dhënies së informacionit për tema të caktuara .....	47
2.2 Vendi i dhënies së informacionit.....	47
2.2.1 Jepni informacion në kontaktin e parë.....	49
2.2.2 Jepni informacion gjatë regjistrimit dhe akomodimit .....	52
2.3 Kush e jep informacionin?.....	53
2.3.1 Përcaktoni se cilat organizata duhet të japin informacion .....	53
2.3.2 Koordinoni midis organizatave që japin informacion .....	54
<b>3. Temat e dhënies së informacionit .....</b>	<b>56</b>
3.1 Konceptet dhe parimet kryesore të procedurës së azilit.....	60
3.1.1 Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare? .....	60
3.1.2 Çfarë është procedura e azilit? .....	62
3.1.3 Konfidencialiteti .....	64
3.1.4 Parimi i interesit më të lartë të fëmijës .....	65
3.1.5 Mekanizmi i ankesave.....	66
3.2 Procedurat që duhen ndjekur.....	68
3.2.1 Procedura e regjistrimit .....	68
3.2.2 Regjistrimi i personave të rritur në ngarkim .....	70
3.2.3 Regjistrimi i fëmijëve .....	72





3.2.4	Vlerësim i moshës.....	72
3.2.5	Intervista personale .....	73
3.2.6	Afatet kohore për shqyrtimin.....	76
3.2.7	Ndalimi.....	77
3.2.8	Hapat e ardhshëm nëse kërkesa kanalizohet përmes një procedure të veçantë shqyrtimi.....	79
3.3	Të drejtat e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare .....	85
3.3.1	Qëndrimi në vendin që është në pritje të procedurës së shqyrtimit... ..	86
3.3.2	E drejta për të pasur përkthyes.....	87
3.3.3	Asistenca dhe përfaqësimi ligjor .....	88
3.3.4	E drejta për të komunikuar me UNHCR-në dhe organizata të tjera që ofrojnë konsulencë ligjore .....	89
3.3.5	E drejta për kushte materiale pritjeje.....	89
3.3.6	Tërheqja e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare .....	90
3.3.7	Të drejtat në lidhje me fëmijët (e pashoqëruar).....	90
3.3.8	Të drejtat për aplikuesit për mbrojtje për mbrojtje me nevoja të veçanta .....	92
3.4	Detyrimet e një aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare .....	93
3.4.1	Bashkëpunimi me autoritetet .....	94
3.4.2	Nënshtrimi ndaj kontrollit personal për arsye sigurie .....	95
3.4.3	Marrja e të dhënave biometrike.....	95
3.4.4	Komunikimi të autoritetet i adresës së kontaktit dhe ndryshimeve në adresë .....	96
3.4.5	Paraqitja e elementeve për të mbështetur kërkesën.....	97
3.5	Pasojat e mundshme të mospërbushjes së detyrimeve dhe për mosbashkëpunimin me autoritetet.....	100
3.5.1	Kërkesa mund të konsiderohet si e tërhequr ose e braktisur në mënyrë të nënkuptuar.....	100
3.5.2	Mund të ketë ndikim të vlerësimi i elementeve të rëndësishme të kërkesës për azil.....	102
3.5.3	Procedura e azilit mund të përshpejtohet .....	102
3.5.4	Kushtet materiale të pritjes mund të pakësohen ose të hiqen .....	103
3.6	Kthimi vullnetar .....	103







## Lista e shkurtimeve

Shkurtesa	Përkufizimi
<b>CEAS</b>	Sistemi i Përbashkët Evropian për Azilin
<b>DK (e riformuluar)</b>	<b>Direktiva e Kualifikimeve</b> – Direktiva 2011/95/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 2011 “Për standardet e kualifikimit të shtetasve nga vendet e treta ose të personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status refugjati uniform ose për personat që kanë të drejtë të përfitojnë mbrojtje plotësuese dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë” (e riformuluar)
<b>DKP (e riformuluar)</b>	<b>Direktiva për Kushtet e Pritjes</b> – Direktiva 2013/33/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, “Për standardet e pritjes së personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare” (e riformuluar)
<b>DPA (e riformuluar)</b>	<b>Direktiva për Procedurat e Azilit</b> – Direktiva 2013/32/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 për procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare (e riformuluar)
<b>EASO</b>	Zyra Evropiane e Mbështetjes për Azilin
<b>EUAA</b>	Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin
<b>GjDBE</b>	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
<b>Konventa për refugjatët</b>	Konventa e vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve dhe Protokolli i saj i vitit 1967 (referuar në legjislacionin e BE-së për azilin dhe nga GjDBE si “Konventa e Gjenevës”)
<b>LGBTIQ</b>	personat lezbike, homoseksualë, biseksualë, trans, interseksualë dhe queer
<b>Pyetje të shpeshta</b>	pyetjet e shpeshta
<b>Shtete Anëtare</b>	Shtete Anëtare të BE-së
<b>UNHCR</b>	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
<b>Vendet BE+</b>	Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet e asociuara



# Hyrje

Ky udhëzues praktik është zhvilluar në kontekstin e projektit **Let's Speak Asylum të EUAA-së**, qëllimi i të cilit është të ofrojë një grup të standardizuar mjetesh praktike për zbatimin e aktiviteteve të dhënies së informacionit gjatë procedurave të azilit, procedurës së Dublinit, pritjes dhe zhvendosjes. Ky udhëzues praktik synon çdo person të përfshirë në dhënien e informacionit për aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare dhe politikëbërësit që koordinojnë aktivitetet e dhënies së informacionit gjatë qasjes në procedurën e azilit.

Në përputhje me Direktivën 2013/32/BE (Direktiva për Procedurat e Azilit (DPA) (e riformuluar))<sup>(6)</sup>, aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare ka të drejtë të informohet në kohë për procedurën e azilit. Dhënia e informacionit u mundëson aplikueseve për mbrojtje të gëzojnë të drejtat e tyre dhe të përmbushin detyrimet e tyre. E drejta për informim është një nga garancitë më të rëndësishme që jepet në kuadër të DPA-së (e riformuluar), e cila synon të garantojë një procedurë azili të drejtë dhe efektive. Dorëzimi i informacionit tek aplikuesit për mbrojtje është në interes të aplikuesit për mbrojtje dhe autoriteteve.

Dhënia e informacionit është efektive kur aplikuesit për mbrojtje kupton se çfarë do të thotë ky informacion në praktikë. Ky udhëzues praktik synon të ndihmojë ofruesit e informacionit në arritjen e këtij qëllimi.

Kapitulli 1. [Parimet dhe aftësitë bazë për dhënien e informacionit](#) përshkruan parimet bazë për dhënien e informacionit. Ai paraqet teknikat e komunikimit për të dhënë informacion dhe për të përshtatur metodën e komunikimit sipas aplikuesit për mbrojtje, për të siguruar kuptueshmërinë. Ai gjithashtu paraqet se si informacioni mund të përcillet përmes kanaleve të komunikimit verbal, të printuar, digjital dhe audiovizual.

Kapitulli 2. [Struktura organizative e dhënies së informacionit](#) diskuton se kur aplikuesi për mbrojtje duhet të marrë informacione të caktuara për të ndjekur plotësisht procedurën dhe se si kjo mund të përshtatet me kontekstin kombëtar. Ai gjithashtu paraqet se si rrethanat mund të ndikojnë në aktivitetet e dhënies së informacionit. Gjithashtu, kapitulli prezanton se si mund të koordinohet dhënia e informacionit ndërmjet organizatave të shumta.

Kapitulli 3. [Temat e dhënies së informacionit](#) përshkruan me detaje temat e ndryshme të informacionit që duhet të mbulohen në kontekstin e qasjes në procedurë. Kapitulli jep informacion bazë për secilën nga këto tema, duke u fokusuar në atë që ofruesi i informacionit duhet të dijë rreth temës dhe mesazhit që duhet t'i jepet aplikuesit për mbrojtje. Këshillat praktike se si të jepet ky informacion plotësojnë përshkrimin e temave të informacionit. Udhëzuesi praktik nuk synon të japë formulime specifike që duhet t'i përcillen drejtpërdrejt aplikuesit për mbrojtje. Përkundrazi, ai përshkruan mesazhet që duhet të përcillen.

---

<sup>(6)</sup> e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, "Për dhënien dhe heqjen e mbrojtjes ndërkombëtare" (e riformuluar), Fletorja Zyrtare nr. L 180, 29.6.2013).



Ky udhëzues praktik është pjesë e një seti mjetesh për qasjen në procedurën e azilit, i cili mbështet dhënie e informacionit efikas në të gjitha vendet BE+. Përveç udhëzuesit praktik, seti i mjeteve përfshin gjithashtu materiale informative dhe modele për dhënie e informacionit drejtpërdrejt tek aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare në fazën e hershme të procedurës së azilit, gjatë kryerjes, regjistrimit dhe depozitimit të një qasje. Mbështetje dhe informacione të mëtejshme ofrohen në platformën Let's Speak Asylum, e cila përmban të gjitha produktet e zhvilluara në kuadër të projektit Let's Speak Asylum. Platforma mund të ketë qasje përmes faqes së internetit të EUAA-së.



# 1. Parimet dhe aftësitë bazë për dhënien e informacionit

Dhënia e informacionit synon kryesisht t'u mundësojë aplikuesëve për mbrojtje të kenë qasje dhe të kuptojnë plotësisht procedurën e azilit. Aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare shpesh kanë njohuri të kufizuara në lidhje me azilin kur kanë qasje për herë të parë në procedurë. Në të njëjtën kohë, pritet që ata të përthithin sasi të mëdha informacioni të ri që përfshin informacion ligjor mbi procedurat administrative. Detyra juaj si ofrues i informacionit nuk është vetëm të jepni informacionin, por gjithashtu të siguroheni që aplikuesi për mbrojtje të kuptojë se çfarë do të thotë ky informacion në praktikë.

Është gjithashtu në interes të administratës së azilit që aplikuesi për mbrojtje ta kuptojë plotësisht informacionin që i është dhënë që në fillim të procedurës. Ky informacion u mundëson atyre të kuptojnë se çfarë pritet prej tyre në faza të ndryshme të procedurës, e cila rrjedhimisht rrit cilësinë dhe efikasitetin e përgjithshëm të procedurës së azilit. Është e nevojshme të sigurohet që aplikuesi për mbrojtje të marrë informacion të saktë dhe të përputhshëm në lidhje me procedurat e azilit, pasi ai mund të ketë marrë dezinformim nga persona të tjerë, si trafikantët.

Ky kapitull paraqet kërkesat ligjore në lidhje me dhënien e informacionit dhe teknikat bazë të komunikimit që ju lejojnë të përshtatni mesazhin tuaj sipas rrethanave personale të aplikuesit për mbrojtje dhe të verifikoni kuptimin e tyre. Ai gjithashtu paraqet se si mund t'u përcillet informacioni aplikuesëve për mbrojtje verbalisht, në formë të printuar, në platforma digjitale dhe nëpërmjet mediave të transmetimit.

## 1.1 Kërkesat ligjore

E drejta për informim është një nga garancitë më të rëndësishme që jepet në kuadër të DPA-së (e riformular), për të garantuar një procedurë azili të drejtë dhe efektive. Është gjithashtu parakusht për qasje efektive në procedurë: aplikuesi për mbrojtje duhet të kuptojë se çfarë është mbrojtja ndërkombëtare dhe procedura e azilit, për të qenë në gjendje të marrë pjesë plotësisht në procedurë. <sup>(7)</sup> Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet situatës së personave në ndalim, për t'u siguruar që ata të marrin informacionin e nevojshëm <sup>(8)</sup>.

<sup>(7)</sup> Për më shumë informacion, shih GJEDNJ, aktgjykimi i datës 20 korrik 2021, *D. kundër Bullgarisë*, Nr 29447/17, ECLI:CE:ECHR:2021:0720JUD002944717, paragrafi 116 (disponohet vetëm në frëngjisht). Një përmbledhje e vendimit gjendet në *Bazën e të dhënave të jurisprudencës së EUAA-s*; GJEDNJ, aktgjykimi i 23 shkurtit 2012, *Hirsi Jamaa dhe të tjerët kundër Italisë*, Nr 27765/09, ECLI:CE:ECHR:2012:0223JUD002776509, paragrafi 204. Një përmbledhje e vendimit gjendet në *Bazën e të dhënave të jurisprudencës së EUAA-s*.

<sup>(8)</sup> Shih nenin 8(1) të DPA-së (e riformular): "Kur ka indikacione se shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi të mbajtur në ambientet e ndalimit ose të pranishëm në pikat e kalimit kufitar, duke përfshirë zonat e tranzitit, në kufijtë e jashtëm, mund të dëshirojnë të bëjnë një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, Shtetet Anëtare duhet t'u japin atyre informacion mbi mundësinë për ta bërë këtë."



Aplikuesi për mbrojtje ka të drejtë të informohet në lidhje me procedurën e azilit në kohën e duhur <sup>(9)</sup>. Si rezultat, aplikuesi për mbrojtje duhet të informohet vazhdimisht në momente vendimtare gjatë procedurës. Në kontekstin e qasjes në procedurën e azilit, kjo nënkupton dhënien e informacionit për azilin në momentin e qasjes në procedurën e azilit dhe, për shërbimet e pritjes, brenda 15 ditëve pas depozitimit të kërkesës.

DPA-ja përcakton informacionin që duhet t'i jepet aplikuesit për mbrojtje në lidhje me procedurën e azilit, në gjuhën që ai e kupton, në momentet vendimtare të procedurave.



### Neni 12(1)(a) i DPA-së (e riformuluar) – Garancitë për aplikuesit për mbrojtje

*1. Sa i takon procedurës së parashikuar në Kapitullin III, Shtetet Anëtare duhet të garantojnë se të gjithë aplikuesit për mbrojtje gëzojnë garancitë e mëposhtme:*

*(a) ata duhet të informohen në një gjuhë që e kuptojnë ose ka arsye të mendohet se e kuptojnë për procedurën që duhet ndjekur, për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë procedurës dhe për pasojat e mundshme në rast mospërbushjeje të detyrimit të tyre dhe në rast mosbashkëpunimi me autoritetet. Ata duhet të informohen për afatet kohore, mjetet në dispozicion të tyre për përmbushjen e detyrimit për paraqitjen e elementeve të përmendura në Nenin 4 të Direktivës 2011/95/BE, si dhe për pasojat e tërheqjes së hapur ose të heshtur të kërkesës. Ky informacion duhet dhënë në kohë për t'u dhënë aplikuesëve për mbrojtje mundësinë të ushtrojnë të drejtat e garantuara në këtë Direktivë dhe të përmbushin detyrimet e parashikuara në Nenin 13;*

Më tej, ai specifikon se ky informacion duhet të jepet pa pagesë dhe sipas rrethanave të veçanta të aplikuesit për mbrojtje.



### Neni 19(1) i DPA-së (e riformuluar) – Dhënia e informacionit ligjor dhe procedural pa pagesë në procedurat e shkallës së parë

*1. Në procedurat e shkallës së parë të parashikuara në Kapitullin III, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që, me kërkesë të tyre, aplikuesëve për mbrojtje t'u jepet informacion ligjor dhe procedural pa pagesë, duke përfshirë, të paktën, informacion mbi procedurën në dritën e rrethanave të veçanta të azilkërkuarit. Në rast të një vendimi negativ për një kërkesë në shkallën e parë, Shtetet Anëtare gjithashtu, me kërkesë të tyre, u japin aplikuesëve për mbrojtje informacion, përveç atij të dhënë në përputhje me nenin 11(2) dhe nenin 12(1)(f), në mënyrë që të sqarohen arsyet e një vendimi të tillë dhe të shpjegohet se si mund të kundërshtohet.*

Direktiva 2013/33/BE (DKP (e riformuluar)) <sup>(10)</sup> përcakton informacionin që duhet t'i jepet aplikuesit për mbrojtje në lidhje me pritjen brenda 15 ditëve nga mbërritja e tij në vend.

<sup>(9)</sup> Për më shumë informacion, shih GJEDNJ, aktgjykimi i 21 janarit 201, *MSS kundër Belgjikës dhe Greqisë*, Nr 30696/09, ECLI:CE:ECHR:2011:0121JUD003069609, paragrafi 304. Një përmbledhje e vendimit gjendet në [Bazën e të dhënave të jurisprudencës së EUAA-s](#).

<sup>(10)</sup> [Direktiva 2013/33/BE](#) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, për standardet e pritjes së personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare (e riformuluar), (Fletorja Zyrtare nr. L 180, 29.6.2013).





## Neni 5 i DKP-së (e riformuluar) – Informimi

*1. Brenda një afati të arsyeshëm jo më vonë se 15 ditë pas dorëzimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, Shtetet Anëtare duhet të njoftojnë aplikuesit për mbrojtje të paktën për përfitimet që u njihen dhe për detyrimet që ata duhet të respektojnë kundrejt kushteve të pritjes. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që aplikuesëve për mbrojtje t'u jepet informacion mbi organizatat ose grupet e personave që ofrojnë ndihmë ligjore specifike dhe organizatat që mund të jenë në gjendje t'i ndihmojnë ose t'i informojnë ata në lidhje me kushtet e disponueshme të pritjes, duke përfshirë kujdesin shëndetësor.*

*2. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që informacioni i përmendur në paragrafin 1 të jetë me shkrim dhe në një gjuhë që aplikuesi për mbrojtje e kupton ose supozohet në mënyrë të arsyeshme ta kuptojë. Kur është e përshtatshme, ky informacion mund të jepet edhe verbalisht.*

Në kontekstin e qasjes në procedurën e azilit, kjo do të thotë se është me rëndësi të madhe që aplikuesi për mbrojtje të kuptojë se çfarë është mbrojtja ndërkombëtare dhe çfarë pritet prej tyre gjatë kryerjes, regjistrimit dhe depozitimit të kërkesës së tyre për mbrojtje ndërkombëtare. Kjo përfshin procedurën që duhet ndjekur, të drejtat dhe detyrimet e aplikuesit për mbrojtje, pasojat e mospërmbushjes së detyrimeve të tilla dhe pasojat e tërheqjes së kërkesës.

Në përgatitje për intervistën personale, aplikuesit për mbrojtje duhet të kuptojnë gjithashtu se çfarë pritet prej tyre, duke përfshirë mënyrën e paraqitjes së provave për të mbështetur kërkesën e tyre dhe afatin kohor të zbatueshëm për hapat e ardhshëm të procedurës së azilit. Aplikuesi për mbrojtje duhet gjithashtu të informohet për përfitimet dhe kushtet e tij të pritjes, nga persona që punojnë në kuadër të procedurës së azilit ose në pritje. Në mënyrë të ngjashme, duhet të jepet informacion për përpunimin e gjurmëve të gishtërinjve në Eurodac kur merren gjurmët e gishtave të aplikuesit për mbrojtje <sup>(1)</sup>.

Në varësi të situatës individuale të aplikuesit për mbrojtje, mund të nevojiten informacione shtesë. Për shembull, fëmijët e pashoqëruar duhet të marrin informacion specifik për çështje që kanë të bëjnë me procedurën dhe të drejtat e tyre, siç janë e drejta e tyre për një përfaqësues dhe roli i këtij të fundit gjatë procedurës. Një shembull tjetër është ai i aplikuesëve për mbrojtje me nevoja të veçanta procedurale, të cilët do t'u duhet të marrin informacion shtesë për mbështetjen që është në dispozicion për ta.

Informacioni duhet të jepet në një mënyrë të tillë që garanton se është kuptuar dhe merr parasysh rrethanat e veçanta të aplikuesit për mbrojtje, të tilla si moshë, gjinia dhe/ose niveli i arsimimit, në mënyrë që ti jepet qasje efektive ndaj të drejtave dhe aftësia për të përmbushur detyrimet <sup>(2)</sup>. Për shembull, informacioni i përshtatshëm për fëmijët merr parasysh moshën

<sup>(1)</sup> Shih nenin 29 të rregullores së Eurodac për më shumë informacion mbi të drejtën e informacionit në lidhje me marrjen e gjurmëve të gishtave.

<sup>(2)</sup> Shih tekstin shpjegues 22 të DPA-së (e riformuluar) mbi arsyet për t'u dhënë informacion aplikuesëve për mbrojtje ndërkombëtare





dhe pjekurinë e fëmijës në mënyrë që informacioni të komunikohet në një mënyrë sa më të kuptueshme për fëmijën.

Për të mundësuar qasje efektive në informacion, ky i fundit duhet të ofrohet pa pagesë dhe në një gjuhë që aplikuesi për mbrojtje supozohet në mënyrë të arsyeshme se e kupton.

## 1.2 Si të komunikoni informacionin

Një listë e gjatë e temave të mundshme mund të mbulohet në fillim të procedurës së azilit për ta shpjeguar plotësisht atë. Shpesh aplikuesi për mbrojtje nuk është gati ta pranojë këtë informacion, pasi ai mund të jetë i sapoardhur dhe të ketë nevoja të tjera më urgjente, si p.sh. i mungojnë anëtarët e familjes dhe ka nevoja bazë të paplotësuara, ose has vështirësi në përpunimin e informacionit të ri për shkak të traumatizimit. Nëse ia jepni të gjithë informacionin aplikuesit për mbrojtje menjëherë, rrezikoni ta mbingarkoni atë. Megjithatë, nëse e reduktoni shumë sasinë e informacionit, mund të mos jeni në gjendje t'u jepni aplikuesëve për mbrojtje informacion të mjaftueshëm që ata të marrin pjesë në mënyrë efektive në procedurë.

Në këtë seksion mund të gjeni teknikat bazë të komunikimit që mund të përdorni për të ulur këtë rrezik.

### 1.2.1 Teknikat bazë të komunikimit

#### (a) Reduktoni kompleksitetin

Reduktimi i kompleksitetit i referohet komunikimit të qartë të mesazhit tuaj kyç duke përdorur një gjuhë të kuptueshme. Kjo do të thotë se të gjitha konceptet ligjore dhe abstrakte duhet të shpjegohen në gjuhë jo-teknike. Informacioni gjithashtu mund të bëhet që të përshtatet me aplikuesin për mbrojtje duke përdorur shembuj praktikë nga sfera e jetës së tyre, për të ilustruar se çfarë kuptimi ka në praktikë një pjesë e caktuar e informacionit. Megjithatë, reduktimi i kompleksitetit nuk duhet ta bëjë mesazhin të paplotë ose të pasaktë.

#### Konsideratat praktike

- Shkruani ndërsa flisni ose bisedoni për koncepte abstrakte në gjuhë të thjeshtë ndërsa flisni.
- Bëjeni informacionin konkret duke përdorur shembuj dhe mjete ndihmëse pamore.
- Filloni me atë që është më e rëndësishme; hiqni detajet e parëndësishme.
- Përdorni fjali relativisht të shkurtra dhe të qarta që përfshijnë kryesisht vetëm një ide.
- Përdorni gjuhën e drejtpërdrejtë dhe foljet veprare.
- Shmangni akronimet.
- Shpjegoni dallimet kulturore, kur është e nevojshme.
- Përmbliidhni informacionin thelbësor.



### **(b) Merrni parasysh numrin e temave të informacionit**

Duke kufizuar numrin e temave të ndryshme që mbulohen në të njëjtën kohë, ju i lejoni aplikuesit për mbrojtje të përqendrohet në informacionin që është drejtpërdrejt i rëndësishëm për të në atë moment specifik në kohë. Për shembull, në fillim të procedurës, është e nevojshme që aplikuesi për mbrojtje të kuptojë se çfarë do të thotë mbrojtje ndërkombëtare dhe çfarë ndodh gjatë procedurës së azilit. Pasi kjo të kuptohet, tema të mëtejshme informacioni mund të shtohen brenda këtij kuadri bazë.

#### **Konsideratat praktike**

- Së pari, jepni informacion që është drejtpërdrejt i rëndësishëm për aplikuesit për mbrojtje në atë moment, duke përfshirë informacionin mbi hapin e procedurës së azilit në të cilin janë dhe si të përgatiten për hapin tjetër.
- Gruponi temat e informacionit rreth temave që lidhen me njëra-tjetrën, për shembull kur flisni për detyrimet e aplikuesit për mbrojtje, mund të jepni informacion për disa tema në të njëjtën kohë.
- Njoftojeni aplikuesin për mbrojtje se do të marrë më shumë informacion. Udhëzoni ata se si të gjejnë vetë informacione të mëtejshme. Informojeni aplikuesin për mbrojtje se kur do të zhvillohet sesioni i ardhshëm i dhënies së informacionit verbalisht.

### **(c) Merrni parasysh nivelin e detajeve**

Niveli i detajeve të ofruara korrespondon me atë që është e nevojshme që aplikuesi për mbrojtje të marrë pjesë në procedurë në mënyrë domethënëse dhe efektive. Në fillim të procedurës, dhënia e një niveli më të ulët të detajeve në hapat e mëvonshëm të procedurës do ta bëjë më të lehtë për aplikuesin për mbrojtje që të përthithë informacionin. Ky informacion thelbësor do të plotësohet me detaje të mëtejshme më pas, kur aplikuesi për mbrojtje të njihet me informacionin bazë.

#### **Konsideratat praktike**

- Jepni informacion të detajuar vetëm për temat që lidhen drejtpërdrejt me aplikuesin për mbrojtje, duke marrë parasysh fazën e tij aktuale në procedurë dhe rrethanat e tij personale.
- Jepni informacion shtesë të detajuar për tema të tjera pasi të siguroheni që aplikuesi për mbrojtje ka marrë tashmë informacionin bazë në një fazë të hershme.

### **(d) Përsëriteni informacionin**

Përsëritja e informacionit gjatë qasjes në procedurë e ndihmon aplikuesin për mbrojtje të kujtojë përmbajtjen thelbësore. Identifikoni mesazhet qendrore të secilës temë informacioni dhe përsëritini ato disa herë, për shembull përmes kanaleve të ndryshme të dhënies së informacionit.





### Konsideratat praktike

- Përdorni terminologji konsistente kur jepni informacion thelbësor.
- Zgjeroheni mesazhin thelbësor duke ofruar informacion shtesë në një fazë të mëvonshme.

#### (e) Përdorni një stil vizual për komunikimin me shkrim

Teknikat e komunikimit vizual mund të ndihmojnë në organizimin e përmbajtjes së informacionit, duke lehtësuar kështu kuptueshmërinë dhe përvetësimin e tij. Formatet që janë vizualisht të qarta i lejojnë aplikuesit për mbrojtje të kenë qasje dhe të kuptojnë mesazhet kyçe që janë të rëndësishme për ta.

### Konsideratat praktike

Ndajini tekstet e gjata në paragrafë të shkurtër.

- Përdorni tituj dhe nëntituj.
- Përdorni formatet e theksuara për t'i bërë mesazhet thelbësore të dallohen.
- Përmbliidheni informacionin kryesor në pika kryesore që në fillim.
- Shtoni mjete ndihmëse vizuale vetë-shpjeguese, të tilla si fotografi, vizatime, piktograme dhe diagrame.
- Ku është e mundur, përdorni ngjyra dhe modele të tilla si vijat ose pikat në mjetet ndihmëse tuaja vizuale, diagramet dhe grafikët.



#### Këshillë praktike për projektet vizuale

Përdorni mjete ndihmëse vizuale, ngjyra dhe modele në përputhje me informacionin thelbësor që i përsëritet aplikuesit për mbrojtje. Ripërdorni të njëjtën ndihmë vizuale në materiale të ndryshme për t'iu referuar të njëjtës temë informacioni. Kjo do ta ndihmojë aplikuesin për mbrojtje të kujtojë përmbajtjen thelbësore.

Shmangni përdorimin e shkronjave, datave ose ndonjë elementi tjetër të përkohshëm në mjetet ndihmëse vizuale. Duke vepruar kështu, ilustrimet tuaja nuk do të kenë nevojë të modifikohen për materiale të tjera dhe versione gjuhësore.

Sigurohuni që ndihmat tuaja vizuale të jenë sa më vetëshpjeguese që të jetë e mundur. Kjo do të lehtësojë kuptueshmërinë e mesazhit.





### Këshillë praktike për formatet e lehta për t'u lexuar <sup>(13)</sup>

Përdorni formate **të lehta për t'u lexuar** për t'u siguruar që informacioni është i mundur të qaset nga personat që kanë vështirësi në leximin dhe kuptimin e informacionit të shkruar, duke përfshirë personat me vështirësi në shkrim e këndim, shikim të reduktuar, vështirësi njohëse dhe në të nxënë dhe njohuri të kufizuara të një gjuhe të caktuar.

Formatet e lexueshme lehtësojnë kuptueshmërinë e informacionit duke përdorur gjuhë të thjeshtuar dhe mundësojnë qasjen në informacion duke përdorur fotografi dhe paraqitje vizuale.

Materiali informativ mund të vihet në dispozicion në një format të lehtë për t'u lexuar duke thjeshtuar përmbajtjen dhe duke aplikuar stilin e duhur vizual.

Për një tekst **të lehtë për t'u kuptuar**, ndiqni këto udhëzime.

- Përdorni fjalë të thjeshta.
- Përdorni emrat e përveçëm në vend të përemrave të tillë si “ai” ose “ata”.
- Filloni një fjali të re në një rresht të ri.
- Përfshini vetëm një ide për faqe.
- Shoqëroni tekstin me fotografi shpjeguese kur është e mundur.

Për një tekst **të lehtë për t'u qasur**, aplikoni një paraqitje vizuale specifike.

- Rreshtojeni të gjithë tekstin në të majtë dhe mbajini të gjitha imazhet në të majtë të shkrimit.
- Përdorni font të thjeshtë sans-serif, si Arial ose Calibri.
- Përdorni madhësi të madhe fonti: të paktën 14 pt.
- Përdorni hapësirë të gjerë: të paktën 1,5 midis rreshtave.
- Shmangni nënvizimet, shkronjat e pjerrëta, shkrimet me ngjyra dhe dizajnin e veçantë të shkrimit.
- Përdorni anë të gjera të fletës.
- Përdorni madhësi të madhe faqeje: të paktën A4 ku është e mundur.
- Përdorni hapësira të gjera të bardha duke përfshirë vetëm një sasi të kufizuar përmbajtjeje në secilën faqe.

Meqenëse materiali i lehtë për t'u lexuar është shpesh shumë më i gjatë se materiali tjetër për shkak të mënyrës se si formatohet, mund të jetë e dobishme të shkurtohet teksti i mesazheve kyçe që aplikuesi për mbrojtje duhet të dijë.

<sup>(13)</sup> Për më shumë informacion mbi formatet e lehta për t'u lexuar, shihni për shembull: Inclusion Europe, *Informacion për të gjithë: Standardet evropiane për ta bërë informacionin të lehtë për t'u lexuar dhe kuptuar*, 2010 dhe Inclusion Europe, *Lista kontrolluese e lehtë për t'u lexuar: Lista kontrolluese për t'u siguruar që dokumenti juaj është i lehtë për t'u lexuar*, 2010.



### Këshillë praktike për përkthimin e materialit informativ

Teknikat bazë të komunikimit lehtësojnë përkthimin e informacionit në gjuhë të ndryshme. Për shembull, sa më pak të ndërlikohet informacioni dhe sa më shumë të shpjegohet terminologjia abstrakte, aq më i lehtë është përkthimi i saktë.

Gjatë përkthimit të materialit informativ, rekomandohet t'i jepni përkthyesit detaje se si do të përdoret materiali. Për shembull, është mirë të informohet përkthyesi rreth audiencës së synuar, si p.sh. kur materiali është i destinuar për fëmijë ose persona me nevoja të veçanta, për t'u siguruar që gjuha e përkthimit të përdoret sipas këtij grupi të synuar. Është gjithashtu mirë të informohet përkthyesi për stilin e gjuhës që synohet për materialin, si për shembull kur përdoret stil joformal, për t'u siguruar që përkthimi të pasqyrojë të njëjtin stil.

Korrigjimi i materialit të përkthyer nga folës vendas që janë të njohur me kontekstin e azilit ndihmon për t'u siguruar që përkthimet janë të sakta dhe se ato kuptohen siç duhet.

## 1.2.2 Komunikimi verbal

Komunikimi verbal është forma më e vjetër dhe më e besueshme e shkëmbimit të informacionit mes njerëzve. Kjo e bën atë gjithashtu, deri tani, opsionin e preferuar për dhënien e informacionit për aplikuesin për mbrojtje.

Dhënia e informacionit verbalisht mund të jetë metoda më e përdorur, por megjithatë mund të jetë sfiduese. Ju mund ta gjeni veten duke i dhënë informacion verbalisht një aplikuesi për mbrojtje individual ose një grupi më të madh në një sesion të dedikuar informacioni. Ju gjithashtu mund të zbuloni se dhënia e informacionit verbal nuk është i përshtatshëm për grupe të caktuara, si p.sh. aplikuesit për mbrojtje me probleme me dëgjimin. Në raste të tilla duhet t'u jepet përparësi metodave të tjera të komunikimit.

Ndërtimi i besimit dhe sigurimi i një hapësire konfidenciale për dhënien e informacionit lehtëson dhënien efektive të informacionit. Kjo i lejon aplikuesit për mbrojtje të bëjnë pyetje që janë të rëndësishme për të dhe që ndonjëherë mund të jenë të natyrës delikate ose personale. Informimi i aplikuesit për mbrojtje për organizimin për dhënien e informacionit dhe mënyrën se si sigurohet konfidencialiteti kontribuon gjithashtu në ndërtimin e këtij besimi.

Ky seksion paraqet teknikat dhe metodat e komunikimit verbal që mund të përdoren për të verifikuar nëse aplikuesi për mbrojtje e kupton saktë informacionin që i jepet.

### (a) Teknikat e komunikimit verbal

Teknikat bazë të komunikimit të paraqitura më sipër vlejné edhe për komunikimin verbal. Megjithatë, ka teknika shtesë që ndihmojnë për të dhënë informacion gojarisht në një mënyrë që e bën mesazhin më të lehtë për t'u kuptuar.



### **Filloni me një diskutim informal**

Fillimi i një sesiioni për dhënien e informacionit me një diskutim informal ndihmon në ndërtimin e besimit dhe e bën më të lehtë për aplikuesin për mbrojtje të bëjë pyetje gjatë seancës.

### **Flisni me një ritëm të ngadaltë dhe të qëndrueshëm**

Kur flisni me një individ ose një grup, **mos flisni shumë shpejt**.

Ju ndoshta e keni ndarë informacionin tuaj shumë herë më parë, por aplikuesi për mbrojtje do ta dëgjojë atë për herë të parë. Të folurit me një ritëm më të ngadaltë mund t'i ndihmojë gjithashtu përkthyesit të kuptojnë atë që thoni, gjë që përmirëson cilësinë e mesazhit. Pausat gjatë të folurit gjithashtu i lejojnë aplikuesit për mbrojtje të bëjë pyetje.

### **Përdorni një volum të përshtatshëm**

Është e rëndësishme që aplikuesi për mbrojtje t'ju dëgjojë mirë kur flisni.

Ky është gjithashtu një rregull bazë: përdorni volumin e kërkuar që të dëgjoheni, por jo më të lartë se kaq. Të folurit me zë të lartë ose të bërtiturit mund të shihet si sjellje agresive, veçanërisht kur i drejtoheni një individ. Duke bërë pyetjen “A më dëgjoni mirë?” para se të filloni të jepni informacion, kjo mund t'ju ndihmojë të përshtatni volumin tuaj.

### **Përdorni prozodinë në mënyrë efektive**

Toni i zërit tuaj ka rëndësi. Ai mund t'ju ndihmojë të theksoni një mesazh ose të lidheni me aplikuesin për mbrojtje. Për shembull, tregoni se një mesazh është i rëndësishëm duke përdorur një ton serioz. Një ton miqësor komunikon ndjeshmëri dhe respekt, gjë që mund të ndihmojë që aplikuesi për mbrojtje të ndihet më komod dhe më i sigurt me ju.

### **Planifikoni më shumë kohë ose bëni një pushim**

Aplikuesi për mbrojtje mund të ketë vështirësi t'ju kuptojë ose mund ta ketë të vështirë të qëndrojë i përqendruar për një kohë të gjatë. Lini kohë për pyetje dhe për të bërë pushim një ose më shumë herë. Kjo mund ta ndihmojë aplikuesin për mbrojtje të përpunojë atë që keni thënë dhe të rrisë kuptueshmërinë.

### **Puna me përkthyesit**

Teknikat tuaja të komunikimit duhet të marrin parasysh punën me përkthyesit. Juve mund t'ju duhet t'i shpjegoni përkthyesit terminologjinë që përdorni për të siguruar përkthim të saktë në një gjuhë tjetër. Juve gjithashtu mund t'ju duhet të caktoni më shumë kohë për dhënien e informacionit në mënyrë që përkthyesi të mund të përkthejë atë që thuhet.





Ju duhet t'i shpjegoni qartë aplikuesit për mbrojtje rolin tuaj dhe rolin e përkthyesit në fillim të seancës informative. Roli juaj është të jepni informacionin dhe roli i përkthyesit është i kufizuar në përkthimin e asaj që ju dhe aplikuesi për mbrojtje thonë. Është gjithashtu e rëndësishme t'i vihet në dukje aplikuesit për mbrojtje se përkthyesi është i detyruar të ruajë konfidencialitetin, të ketë paanshmëri, neutralitet, integritet dhe sjellje profesionale, në mënyrë të ngjashme me ju.

Kur punoni me një përkthyes, ju jeni përgjegjës për kontekstin e komunikimit. Për shembull, ju nuk duhet të lejoni që përkthyesi të ndërveprojë me aplikuesin për mbrojtje në emër të tij, pasi kjo do të rezultonte në humbjen e kontrollit mbi informacionin që i transmetohet aplikuesit për mbrojtje. Nëse kjo ndodh, këshillohet që t'i kujtoni menjëherë përkthyesit rolin e tij.



### Këshilla praktike për të punuar me përkthyesit

- Jini i vetëdijshëm se si kuptohen terma të caktuar në një gjuhë të caktuar dhe shpjegoni qartë se çfarë nënkuptoni. Për shembull, termi “shëndet” duhet të kuptohet se përfshin shëndetin mendor dhe fizik, termi “familje” duhet të kuptohet si familje bazë dhe jo si familje e zgjeruar dhe termi “vëllezër dhe motra” u referohet vetëm vëllezërve dhe motrave.
- Verifikoni verbalisht nëse aplikuesi për mbrojtje dhe përkthyesi e kuptojnë njëri-tjetrit.
- Kini parasysh shenjat që tregojnë se aplikuesi për mbrojtje dhe përkthyesi nuk e kuptojnë plotësisht ose nuk i besojnë njëri-tjetrit, për shembull aplikuesi për mbrojtje heziton t'u përgjigjet pyetjeve ose ai jep përgjigje më të gjata sesa përkthyesi po përkthen.
- Drejtojuni aplikuesit për mbrojtje drejtpërdrejt kur jeni duke folur, duke e parë atë dhe duke përdorur vetën e dytë (“ju”), edhe kur ai nuk mund ta kuptojë gjuhën tuaj.
- Ndaloni pas çdo një deri në tre fjali për të mundësuar përkthim të saktë.



### Praktika e mirë për sigurimin e përdorimit të terminologjisë së duhur

Është e rëndësishme të siguroheni që përkthyesi njeh terminologjinë e saktë dhe të përshtatshme për t'u përdorur gjatë dhënies së informacionit. Fjalorthët shumëgjuhësh mund të lehtësojnë përkthimin e saktë. Fjalorthë të tillë duhet të përfshijnë terminologjinë e lidhur me procedurën e azilit që përdoret zakonisht gjatë sesioneve të dhënies së informacionit, ose terminologjinë e specializuar të përdorur kur u jepet informacion grupeve të caktuara të aplikuesëve për mbrojtje, p.sh. azilkërkuesve LGBTIQ.

Projekti i terminologjisë së EUAA-së synon të krijojë një fjalorth shumëgjuhësh të termave dhe përkufizimeve që janë të rëndësishme në kontekstin e azilit. Fjalori mund të gjendet këtu: <https://iate.europa.eu/search/collection/FC1BBC4EE1BB4CB4BA96C7146607554F>.





## Trajnime të ngjashme të EUAA-së

EUAA-ja ofron një modul trajnimi mbi **përkthimin në kontekstin e azilit**, i cili shpjegon rolin e përkthyesit në procedurën e azilit dhe parimet e përkthimit në kontekstin e azilit.

Nëse jeni i interesuar të ndiqni kurse trajnimi të EUAA-së, ju lutemi kontaktoni personin përgjegjës për trajnimin brenda autoritetit tuaj për të marrë informacion shtesë.

### (b) Metodatat e verifikimit për të siguruar kuptueshmërinë

Aplikuesi për mbrojtje duhet të inkurajohet të bëjë pyetje gjatë dhënies së informacionit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të sqaruar çdo dyshim dhe për të hedhur poshtë çdo thashethem ose informacion të rremë që aplikuesi për mbrojtje mund të ketë dëgjuar ose marrë.

Për t'u siguruar që audienca juaj e ka kuptuar informacionin që keni ndarë me të, duhet të kontrolloni në mënyrë aktive nëse e ka kuptuar saktë mesazhin tuaj.

### Përshtypjet verbale nga audienca juaj

Edhe pse aplikuesi për mbrojtje mund të përgjigjet me të vërtetë “po” kur ju pyesni nëse e kuptoi atë që keni shpjeguar, ka disa arsye pse ai mund të përgjigjet “po” edhe pse në të vërtetë nuk e kuptoi. Ju mund ta trajtoni këtë duke aplikuar metoda të ndryshme verifikimi.

#### Përmbliidheni me fjalët tuaja

Pas një seksioni informacioni, mund të përmbliidhni atë që keni thënë duke nënvizuar sërish pikat kryesore dhe duke e ndarë informacionin në njësi të vogla. Kjo lejon diskutime/pyetje të shkurtra përpara se të vazhdoni.

#### Kërkojini aplikuesit për mbrojtje të përsërisë me fjalët e veta

Ju mund t'u kërkonit aplikuesëve për mbrojtje të përsërisin me fjalët e tyre atë që sapo keni thënë. Në këtë mënyrë ju do të jeni në gjendje të përcaktoni nëse ka ndonjë keqkuptim ose nëse aplikuesi për mbrojtje ka humbur informacione të rëndësishme. Gjithashtu kjo do ta ndihmojë aplikuesin për mbrojtje të kujtojë më mirë atë që keni thënë.

#### Bëni një pyetje testuese

Pa i bërë “kuiz” aplikuesit për mbrojtje për njohuritë e tij, ju mund të bëni një pyetje më të detajuar për të parë nëse e ka kuptuar një pikë të caktuar. Për shembull, pasi të shpjegoni një takim të ardhshëm, mund të pyesni “A mund të më thoni se ku duhet të jeni?”

#### Jepni hapësirë për pyetje të mëtejshme

Ju mund ta pyesni në mënyrë proaktive aplikuesin për mbrojtje nëse ka ndonjë pyetje. Kjo është një mënyrë e mirë për të treguar që herët se jeni i interesuar për përshtypjet dhe pyetjet e tyre dhe gjithashtu mund t'ju japë një ide për shqetësimet kryesore të aplikuesit për mbrojtje.



## ▶ Ndajeni informacionin në segmente

Përsëritni metodat e sugjeruara të verifikimit ndërsa sesioni i dhënies së informacionit është në proces. Mos i bëni të gjitha pyetjet në fund të sesionit informues. Aplikuesi për mbrojtje mund të dekurajohet t'ju thotë se nuk ka kuptuar gjithçka pasi të keni dhënë një shpjegim të gjatë. Prandaj, shpjegoni në fillim të sesionit se mund të bëhen pyetje në çdo kohë gjatë dhënies së informacionit dhe ndajeni mesazhin tuaj në segmente të ndjekura nga një sesion pyetje-përgjigje.



### Këshilla praktike për të kundërshtuar keqkuptimet

Ju mund të hasni shumë të pavërteta në lidhje me procedurën e azilit. Është e rëndësishme që t'i kundërshtoni këto keqkuptime, por është po aq e rëndësishme që ta bëni këtë me takt.

Mos thoni drejtpërdrejt se aplikuesi për mbrojtje e ka gabim, pasi kjo mund të përforcojë ndonjë mosbesim që aplikuesi për mbrojtje ndjen tashmë. Në vend të kësaj, ftojini atë të shpjegojë atë që ka dëgjuar për (një aspekt të) procedurës dhe përpiquni të adresoni shkakun e gënjeshtërs. Pastaj, mund të thoni se informacioni që ai ka dëgjuar është i gabuar dhe **kundërshtoni të pavërtetat duke shpjeguar situatën ose procedurën reale**. Ju mund ta mbështesni atë që thoni me materiale informative, të tilla si një fletëpalosje, një hartë ose forma të tjera me materiale mbështetëse.

## Përshtypjet joverbale

Kur komunikoni me aplikuesin për mbrojtje, ju përdorni një kombinim të sinjaleve verbale dhe joverbale. Ju mund të tregoheni vigjilent për shenjat joverbale me të cilat aplikuesi për mbrojtje (pa vetëdije) ju bën të ditur se nuk e ka kuptuar atë që thatë. Shikoni për sinjalet e mëposhtme:

- shprehjet e fytyrës si vrenjtja ose hapja e gojës;
- shikimi nëpër dhomë ose ngulja e syve;
- ndryshimi i humorit ose ndryshimi i tonit të zërit;
- krahët e kryqëzuar;
- tundja e kokës.

Ju mund t'i kundërshtoni këto reagime duke përdorur teknikat bazë të komunikimit joverbal, duke përfshirë sa vijon.

## ▶ Përshtëndesni me një buzëqeshje

Kur përshtëndesni aplikuesin për mbrojtje, tregoni një qëndrim pozitiv dhe empatik.



### ➤ **Mundohuni t'i mbani neutrale shprehjet e fytyrës**

Përdorni shprehje neutrale dhe të qarta të fytyrës. Kjo ju ndihmon të përcillni mesazhin pa konfuzion dhe lini hapësirë për përgjigjen e aplikuesit për mbrojtje. Ju mund ta përshtatni shprehjen tuaj të fytyrës me përgjigjen që merrni, por mbani një qëndrim profesional.

### ➤ **Jepini përshtypjet joverbale aplikuesit për mbrojtje**

Kur dëgjoni aplikuesin për mbrojtje, ju mund të sinjalizoni se e dëgjoni dhe e kuptoni se çfarë po thotë duke tundur kokën.

### ➤ **Tregoni me gjuhën e trupit se po i kushtoni vëmendje aplikuesit për mbrojtje**

Kur komunikoni me aplikuesin për mbrojtje, sigurohuni që të keni një pozicion të hapur që është përballë tij drejtpërdrejt dhe që të keni kontaktin e duhur me sy me të. Kur është e mundur, përpiquni të mos keni asnjë objekt (si p.sh. tabela) midis jush dhe aplikuesit për mbrojtje.

### ➤ **Përdorni duart**

Gjestet neutrale të duarve mund t'ju ndihmojnë të shpjegoni se çfarë doni të thoni. Për shkak të dallimeve të mundshme kulturore, rekomandohet të shpjegoni edhe verbalisht se çfarë nënkuptohet me gjestet e duarve.



#### **Këshillë praktike për të qenë të vetëdijshëm për dallimet kulturore**

Përshtypjet joverbale nga aplikuesi për mbrojtje mund të tregojnë se ai e kuptoi atë që thatë, për shembull sepse po tundte kokën kur po flisnit. Megjithatë, kjo mund të bëhet edhe për respekt, ndërkohë që vetë mesazhi ka humbur.

Sinjalet tuaja joverbale gjithashtu kanë rëndësi. Mesazhi juaj mund t'ju duket juve si lajm i mirë, por ai mund të merret si diçka negative nga aplikuesi për mbrojtje. Lini hapësirë për reagimin e tij emocional duke mbajtur një qëndrim profesional dhe neutral.

Kini parasysh se buzëqeshja, mbajtja e kontaktit me sy ose shtrëngimi i duarve kanë konotacione të ndryshme në shoqëri të ndryshme. Nëse aplikuesi për mbrojtje nuk po buzëqesh ose shmang vështrimin te ju, kjo mund të jetë një shenjë respekti ose modestie dhe jo sjellje jo bashkëpunuese. Për më tepër, siç dihet gjerësisht, në disa kultura tundja e kokës do të thotë “po”.

### **1.2.3 Përshtatni teknikat tuaja të komunikimit me rrethanat personale të aplikuesit për mbrojtje**

Teknikat e komunikimit të përshtatura me rrethanat personale të aplikuesit për mbrojtje do t'i lejojnë aplikuesit për mbrojtje të kuptojë më mirë mesazhin. Kështu, teknikat e personalizuara të komunikimit i mundësojnë aplikuesit për mbrojtje të gëzojë plotësisht të drejtat e veta dhe të përmbushë detyrimet e veta.







Kur përshtatni teknikat tuaja të komunikimit, merrni parasysh se çfarë lloj komunikimi siguron kuptueshmërinë në dritën e rrethanave personale të aplikuesit për mbrojtje. Në kontekstin e procedurës së azilit, rrethanat më të zakonshme për t'u marrë parasysh përfshijnë sa vijon.

- [Kultura](#).
- [Arsimi dhe niveli i shkrim-leximit](#).
- [Gjinia](#).
- [Mosha](#).
- [Vështirësitë njohëse dhe me të mësuarit](#).
- [Dëmtimet e shikimit dhe dëgjimit](#).

#### **(a) Kultura**

Kultura ndikon në stilin e komunikimit të një personi - mënyrën se si ata e kuptojnë, interpretojnë dhe ritregojnë informacionin. Megjithatë, nuk duhet të supozohet se të gjithë personat e një kulture të caktuar sillen ose ndërveprojnë në një mënyrë të caktuar. Faktorë të tillë si mosha, gjinia ose statusi shoqëror gjithashtu kanë ndikim.

Kultura mund të ndikojë në stilin e komunikimit në disa mënyra.

- Disa koncepte mund të kenë kuptime të ndryshme: datat, stinët, distancat dhe nocionet e rrethit të ngushtë familjar ose moshës mund të ndryshojnë në varësi të kulturës. Shumë koncepte abstrakte mund të jenë gjithashtu të reja për aplikuesin për mbrojtje, të tilla si të drejtat themelore ose ndihma ligjore.
- Gjuha e trupit dhe gjestet mund të shprehin kuptime të ndryshme në varësi të kulturës.
- Nocionet që lidhen me sjelljen, zakonet ose përfshirjen e duhur në jetën publike mund të ndryshojnë në varësi të kulturës.
- Komunikimi në kulturat kolektive, si në Afrikë, shpesh e vë theksin në rutinat e përbashkëta, marrëdhëniet shoqërore dhe ndërveprimin, ndërsa në kulturat individuale, si në Evropë, komunikimi zakonisht fokusohet në përvojat, rolet dhe emocionet individuale.

#### **Konsideratat praktike**

- Shpjegoni konkretisht çdo koncept abstrakt të përdorur në dhënie e informacionit.
- Njihuni me stilet e ndryshme të komunikimit në kulturën e aplikuesit për mbrojtje, duke përfshirë nivelin e drejtpërdrejtshmërisë, mënyrat e përsëritjes, gjuhën e trupit, etj.





## Praktika e mirë në punën me ndërmjetësuesit kulturorë

Ndërmjetësuesit kulturorë mund të lehtësojnë kuptueshmërinë e konteksteve kulturore që kanë të bëjnë si me vendin tuaj ashtu edhe me vendin e origjinës së aplikuesit për mbrojtje. Ata mund të ndihmojnë në shpjegimin e terminologjisë dhe të japin shembuj me të cilët aplikuesi për mbrojtje mund të krijojë lidhje. Ata gjithashtu mund të këshillojnë për gjuhën e trupit dhe gjestet që mund të kenë kuptime të ndryshme midis kulturave. Përveç përkthyesve zyrtarë përdoren edhe ndërmjetësuesit kulturorë kryesisht në kontekste ku nuk nevojitet përkthim i saktë, si p.sh. gjatë aktiviteteve me bazë në komunitet. Ndërmjetësuesit kulturorë nuk duhet të ngatërrohen me përkthyesit të cilëve u kërkohet të certifikojnë njohuri të mjaftueshme gjuhësore dhe kanë detyrimin e sjelljes profesionale në lidhje me rolin e tyre në procedurën e azilit.

### (b) Arsimi dhe niveli i shkrim-leximit

Niveli i arsimimit mund të ndikojë në qasjen në informacion dhe aftësinë për të kuptuar informacionin në lidhje me aspekte të caktuara jashtë sferës së tyre personale të jetës. Arsimi (formal) i kufizuar ose mungesa e tij mund të ndikojë në stilin e tyre të komunikimit në disa mënyra, siç shpjegohet në pikat e mëposhtme.

- Meqenëse shumica e njerëzve mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë në shkollë, mungesa e arsimit formal mund të çojë në arsimim të kufizuar ose mungesë të aftësive në shkrim-leximi dhe ato digjitale. Kjo kufizon mundësitë për të pasur qasje në informacionin e dhënë me shkrim ose nëpërmjet platformave digjitale.
- Arsimi formal zhvillon aftësinë tonë për të menduar në mënyrë abstrakte në sekuencat logjike dhe kuptimin tonë të koncepteve si madhësia, distancat, përmasat, koha dhe shkaku. Aplikuesit për mbrojtje me arsim të kufizuar mund të mos jenë në gjendje të kuptojnë terminologjinë abstrakte.
- Arsimi formal na furnizon me njohuri të përgjithshme për botën, si njohuri historike, gjeografike dhe shkencore. Arsimi (formal) i kufizuar ose mungesa e tij mund të ndikojë në njohuritë e aplikuesit për mbrojtje për çështje jashtë sferës së tyre personale të jetës, si për shembull se si funksionojnë procedurat administrative.

### Konsideratat praktike

- Jepni shpjegime për çdo terminologji abstrakte.
- Jepni informacion në një mënyrë që lidhet me mjedisin personal të jetesës ose përvojat e aplikuesit për mbrojtje në vend të njohurive të përgjithshme.
- Përdorni material vizual për të ilustruar mesazhin tuaj dhe sigurohuni që mjetet ndihmëse vizuale të përdorura të jenë sa më vetëshpjeguese dhe të kuptueshme pa tekst shoqërues.
- Sigurohuni që aplikuesit për mbrojtje analfabetë dhe me aftësi të pakta në shkrim-lexim të kenë qasje në informacione verbale dhe në materiale informative audio-vizuale.



- Sigurohuni që materiali informativ audio-vizual të jetë i lehtë për t'u gjetur në platformat digjitale edhe për personat me aftësi të kufizuara digjitale. Tregojini aplikuesit për mbrojtje se si mund ta gjejë këtë material duke përdorur një kompjuter.

### (c) Gjinia

Gjinia u referohet roleve sociale të ndërtuara të femrave dhe meshkujve. Këto role sociale mund të përjashtojnë personat që supozohet se janë gra dhe vajza nga vendimmarrja brenda familjes dhe komunitetit të tyre. Kështu, këto role ndikojnë gjithashtu në ofrimin e informacionit për aplikueset për mbrojtje femra, pasi ato mund të mos bëjnë pyetje në mënyrë proaktive përpara familjes së tyre ose anëtarëve të komunitetit, veçanërisht nëse këto pyetje lidhen me situatën e tyre personale.

Gratë dhe vajzat mund të kenë qasje më të kufizuar në kanalet e komunikimit sesa burrat dhe djemtë. Aplikuesit për mbrojtje meshkuj mund të kenë qasje më të mirë në informacionin digjital përmes kompjuterëve ose telefonave celularë, nëse janë më të arsimuar në aspektin digjital sesa femrat. Kështu, dhënia e informacionit verbalisht është veçanërisht e rëndësishme kur komunikoni me aplikueset për mbrojtje femra.

Gratë dhe personat, identiteti gjinor (dhe/ose seksual) i të cilëve nuk përputhet me normat, mund të kenë nevojë të veçantë për hapësira të sigurta për aktivitetet e dhënies së informacionit. Pyetjet dhe shqetësimet e tyre në lidhje me procedurën e azilit mund të jenë veçanërisht delikate dhe personale, duke kërkuar kështu konfidencialitet.

### Konsideratat praktike

- Jepuni informacion aplikueseve për mbrojtje femra drejtpërdrejt, qoftë individualisht ose në një sesion grupi vetëm me gra.
- Organizoni sesione informuese dhe ofroni materiale informative në hapësirat ku gratë kalojnë jetën e tyre të përditshme, si për shembull në hapësirat vetëm për gratë në qendrat e pritjes.
- Kushtojni vëmendje të veçantë garantimit të konfidencialitetit gjatë dhënies së informacionit, për shembull duke shpjeguar se çfarë do të thotë konfidencialitet, duke dhënë informacion vetëm në grupe të vogla, duke ofruar një mundësi për dhënie e informacionit individual, etj.
- Siguroni përkthyes femra për seancat e dhënies së informacionit.

### (d) Moshë

Informacioni i përshtatshëm për fëmijët i referohet informacionit që përshtatet me moshën, pjekurinë, gjininë dhe kulturën e fëmijës<sup>(14)</sup>. Ju duhet ta përshtatni kompleksitetin e informacionit sipas situatës së fëmijës: përdorni fjalë të thjeshta dhe konkrete në vend të koncepteve abstrakte. Ju gjithashtu duhet të rregulloni komunikimin tuaj sipas spektrit të

<sup>(14)</sup> Shih Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës, *Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë e përshtatshme për fëmijët*, 2010, fq. 21.





vëmendjes së fëmijës: është e preferueshme një seri seancash të shkurtra me shumë pushime sesa një seancë e gjatë. Komunikimi juaj duhet gjithashtu të marrë në konsideratë formimin e fëmijës, duke përfshirë gjininë dhe kulturën, për ta bërë gjuhën tuaj sa më të kuptueshme. Sa më i ri dhe më pak i pjekur të jetë fëmija, aq më shumë duhet të përshtatet komunikimi juaj <sup>(15)</sup>.

Mosha dhe pjekuria e një fëmije ndikon në mënyrë të ngjashme në qasjen e tij në informacion. Një fëmijë mund të mos jetë në gjendje të lexojë ose të mos ketë durim për t'u përqendruar në tekstin e shkruar. Për fëmijët e shoqëruar, është e nevojshme t'u jepet informacion të gjithë anëtarëve të familjes, duke përfshirë fëmijët që mund të kenë kërkesat e veta për azil nga anëtarët e familjes së tyre. Për fëmijët e pashoqëruar, është e rëndësishme të theksohet se ata duhet të marrin informacion specifik që është i rëndësishëm për ta. Ata gjithashtu kanë nevojë për më shumë mbështetje për të pasur qasje në materialet përkatëse informative, pasi nuk kanë prindër (ose kujdestarë të tjerë) vazhdimisht në dispozicion të tyre për t'i ndihmuar në procedurë ose për të shpjeguar informacionin.

Në disa kultura individët konsiderohen si të rritur dhe e shohin veten si të tillë në një moshë më të re se 18 vjeç. Për më tepër, pas përvojës së udhëtimit të tyre të migrimit, ata mund të ndihen më të pjekur se mosha e tyre aktuale. Prandaj, është e nevojshme t'i jepet informacion fëmijës duke përdorur një gjuhë të përshtatur për pjekurinë e tij, duke e shpjeguar informacionin në mënyrë të mjaftueshme për të siguruar kuptueshmërinë e tyre.

### **Konsideratat praktike**

- Thjeshtojeni informacionin dhe përdorni një terminologji më të thjeshtë sesa do të bënit zakonisht.
- Shpjegoni fjalë të vështira dhe jepni shembuj.
- Përsëritni informacionin thelbësor, verifikoni kuptueshmërinë dhe lini më shumë kohë dhe pauza më shpeshta sesa do të bënit zakonisht.
- Përdorni material informues që tërheq vëmendjen e fëmijës dhe jep informacion në formën e një loje, si p.sh. një libër aktivitësh, për ta bërë informacionin interesant.
- Ndajeni informacionin në formate që fëmijët përdorin normalisht, duke përfshirë mjetet digjitale, mjetet ndihmëse vizuale dhe lojërat.
- Krijoni një hapësirë të sigurt për dhënien e informacionit pa shpërqendrim.
- Bëjeni fëmijën të ndihet komod me ju, për shembull duke filluar me një temë për të cilën fëmija ndihet komod të flasë.
- Merrni parasysh dhënien e informacionit në mënyrë individuale në vend që ta bëni në grup.
- Lini kohë të mjaftueshme për dhënien e informacionit dhe pauzat e planifikuara.

<sup>(15)</sup> Për më shumë informacion mbi parimet dhe këshillat praktike në lidhje me ofrimin e informacionit të përshtatshëm për fëmijët, shih Komisioni Evropian, *Krijimi i versioneve të përshtatshme për fëmijë të dokumenteve të shkruara: Një udhëzues*, 2021; Këshilli i Evropës, *Si të përcillni informacion të përshtatshëm për fëmijët te fëmijët në migrim: Një manual për profesionistët e vijës së parë*, 2018, fq. 15–30; Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, *Udhëzues teknik: Procedurat e përshtatshme për fëmijët*, 2021, fq. 13–16.





Mund t'ju duhet të përshtatni teknikat tuaja të komunikimit jo vetëm kur flisni me fëmijët, por edhe me personat e moshuar. Në këtë rast, rrethanat e tyre personale mund të lidhen me aftësi të kufizuara digjitale, rënie të dëgjimit ose shikimit, ose vështirësi njohëse. Për më shumë informacion, shih seksionin 1.2.3(e) “Vështirësitë njohëse dhe të të mësuarit” dhe seksionin 1.2.3(f) “Dëmtime të shikimit dhe dëgjimit”.

### (e) Vështirësitë njohëse dhe të të mësuarit

Vështirësitë njohëse dhe të të mësuarit mund të mos jenë të dukshme në shikim të parë. Megjithatë, mund të vëreni se aplikuesi për mbrojtje ka vështirësi në dhënie e deklaratave të qarta dhe koherente, në memorizimin e informacionit ose në fokusimin te dhënia e informacionit. Vështirësitë njohëse dhe të të mësuarit mund të rezultojnë nga probleme mjekësore të tilla si aftësi të kufizuar intelektuale, depresion, lëndime të trurit ose varësi nga droga ose alkooli, ose mund të jenë një efekt anësor i ilaçeve të forta.

Në varësi të nivelit të vështirësive njohëse dhe të të mësuarit, mund të jetë e nevojshme të jepet informacion verbalisht për t'u siguruar që mesazhi të përcillet. Duke qenë se dhënia e informacionit për personat me vështirësi njohëse dhe të të mësuarit mund të jetë sfidues, mund të merret parasysh edhe ndihma nga shërbimet e specializuara. Rekomandohet gjithashtu dhënia e informacionit në mënyrë individuale.

Është e rëndësishme të **vini re se ekspozimi ndaj ngjarjeve traumatike mund të shkaktojë stres post-traumatik** që mund të ndikojë gjithashtu në kujtesën dhe sjelljen e aplikuesit për mbrojtje. Aplikuesit për mbrojtje e traumatizuar shpesh kanë kujtesë të dobët. Ata mund të jenë vazhdimisht vigjilentë, gjë që ul aftësinë e tyre për t'u përqendruar, dhe mund të shmangin informacionin që lidhet me traumën e tyre që mund të përfshijë çështjet e azilit. Ata gjithashtu mund të ndihen të mpirë, gjë që mund të duket si mosreagim. Kështu, aplikuesit për mbrojtje shumë të traumatizuar mund të kenë nevojë për teknika të ngjashme komunikimi me personat me vështirësi njohëse dhe të të mësuarit, në varësi të sjelljes dhe reagimeve të aplikuesit për mbrojtje.

### Konsideratat praktike

- Përqendrohuni në mesazhet thelbësore duke përdorur fjali të shkurtra dhe gjuhë të thjeshtë.
- Përsëriteni informacionin më shpesh sesa do të bënit zakonisht.
- Përdorni formate të lehta për t'u lexuar për materialin informativ.
- Mos jepni shumë informacion në të njëjtën kohë.
- Përdorni teknika për të verifikuar kuptueshmërinë.
- Dëgjoni në mënyrë aktive dhe angazhoheni aplikuesin për mbrojtje në diskutim për të rritur përqendrimin e tij.
- Përdorni një ton neutral dhe një qëndrim jogjykses.
- Kushtojni vëmendje të veçantë dhënies së informacionit në segmente dhe bëni pauza të shpeshta për të lënë kohë për të përpunuar informacionin dhe për të bërë pyetje.





- Planifikoni më shumë kohë dhe pauza sesa do të bënit zakonisht.
- Lejoni praninë e një personi mbështetës të besuar, nëse aplikuesi për mbrojtje dëshiron.

#### **(f) Dëmtimet e shikimit dhe dëgjimit**

Dëmtimet e shikimit dhe/ose të dëgjimit mund të ndryshojnë nga mangësi të lehta deri në verbëri dhe shurdhim. Çdo aplikues për mbrojtje mund të ketë dëmtime të tilla, megjithatë ato janë më të zakonshme te të moshuarit. Teknikat e komunikimit duhet të përshtaten sipas nivelit të dëmtimit(eve).

Dhënia e informacionit për aplikuesit për mbrojtje me dëmtime mund të kërkojë aftësi dhe njohuri të specializuara. Në varësi të nivelit të dëmtimit, këshillohet të merrni në konsideratë shërbime të specializuara, të tilla si interpretë të gjuhës së shenjave, për të ndihmuar në dhënien e informacionit. Mund të jetë e nevojshme dhënia e informacionit në mënyrë individuale.

Aplikuesi për mbrojtje mund të mos jetë në gjendje të ketë qasje në informacionin në formate të ndryshme, si verbalisht, me shkrim dhe në formate audio-vizuale. Kështu, është e nevojshme të vihet në dispozicion informacioni në forma të ndryshme për t'u siguruar që mesazhet përkatëse të vihen në dispozicion të aplikuesëve për mbrojtje me lloje të ndryshme dëmtimesh.

Dëmtimet e të folurit mund të ndikojnë gjithashtu në komunikimin tuaj nëse aplikuesi për mbrojtje nuk është në gjendje të bëjë pyetje verbalisht dhe të shprehë çështje që janë të rëndësishme për dhënien e informacionit. Metodot alternative të komunikimit duhet të bazohen në formën e zakonshme të shprehjes së përdorur nga aplikuesi për mbrojtje.

#### **Konsiderata praktike në komunikimin me aplikuesit për mbrojtje me dëmtim të shikimit**

Në varësi të shkallës së dëmtimit të shikimit, mund të zbatohen këshillat e mëposhtme.

- Merrni parasysh regjistrimin e seancës së dhënies së informacionit në mënyrë që aplikuesi për mbrojtje të mund të ketë përsëri qasje në informacion.
- Vini në dispozicion materiale informative të lexueshme me font mjaft të madh dhe mjete ndihmëse vizuale.
- Përdorni kanale të tjera përveç komunikimit personalisht për të dhënë informacion, duke përfshirë materialin audio.

#### **Konsiderata praktike në komunikimin me aplikuesit për mbrojtje që kanë dëmtim të dëgjimit**

Në varësi të shkallës së dëmtimit të dëgjimit, mund të zbatohen këshillat e mëposhtme.

- Flisni ngadalë dhe qartë.
- Shmangni përdorimin e zërit me intonacion të lartë pasi është i vështirë për t'u dëgjuar.
- Vendosuni direkt përballë aplikuesit për mbrojtje në nivelin e syve, në mënyrë që ai të mund të lexojë nga buzët dhe të marrë shenja vizuale.





- Mbajini duart larg fytyrës kur flisni.
- Kini parasysh se zhurmat e sfondit mund të ulin aftësinë për të dëgjuar.
- Përdorni një bllok shënimesh për të shkruar atë që po thoni. Shkruani termat e rëndësishme/kyçe.
- Njoftojeni aplikuesin për mbrojtje kur do të ndryshoni temën, për shembull duke bërë një pauzë të shkurtër.
- Përdorni një interpret të gjuhës së shenjave, kur është e përshtatshme.
- Përdorni materiale të shkruara dhe vizuale së bashku me kanale të tjera, në vend të komunikimit verbal.

### **Sigurohuni që t'i përshtatni mesazhet tuaja përveç teknikave tuaja të komunikimit**

Përveç përshtatjes së teknikave tuaja të komunikimit me rrethanat personale të aplikuesit për mbrojtje, ju gjithashtu duhet të përshtatni përmbajtjen e informacionit me mesazhet që aplikuesi për mbrojtje duhet të marrë.

Kur jepni informacion mbi qasjen në procedurë, ju duhet t'i përshtatni mesazhet tuaja, të paktën, për profilet e mëposhtme të aplikuesëve për mbrojtje:

- fëmijët e pashoqëruar;
- fëmijët e shoqëruar;
- personat e rritur në ngarkim;
- aplikuesit për mbrojtje me nevoja të veçanta;
- azilkërkuesit e kanalizuar në një procedurë të caktuar, si procedura e Dublinit, procedura e përshpejtuar, procedura e pranueshmërisë ose procedura në kufi;
- aplikuesit për mbrojtje në ndalim.



#### **Këshillë praktike për ofrimin e informacionit për një familje duke përshtatur si mesazhin ashtu edhe teknikat e komunikimit**

- Sigurohuni që të gjithë anëtarëve të familjes t'u jepet individualisht informacioni që është veçanërisht i rëndësishëm për ta.
- Përshtatni teknikat tuaja të komunikimit të paktën për fëmijët dhe gratë. Për shembull, informacioni duhet t'u jepet fëmijëve në një mënyrë të përshtatshme për fëmijët, duke marrë parasysh moshën dhe pjekurinë e tyre për t'u siguruar që është kuptuar, ndërkohë që gratë mund të kërkojnë hapësirë për dhënie e informacionit që garanton konfidencialitetin, për t'u siguruar që ato mund të bëjnë të gjitha pyetjet që janë të rëndësishme për kërkesën e tyre.
- Vëzhgoni në mënyrë proaktive rrethana të tjera të mundshme ndaj të cilave komunikimi duhet të përshtatet.





### Këshillë praktike për materialet dhe seancat e synuara informative

- Hartoni materiale informative dhe seanca të synuara për fëmijët e pashoqëruar dhe profile të tjera aplikuesish për mbrojtje.

Për disa profile aplikuesish për mbrojtje, do t'ju duhet jo vetëm të përshtatni teknikat e komunikimit sipas rrethanave personale, por edhe të jepni informacion specifik në lidhje me procedurën e azilit. Për shembull, fëmijët e pashoqëruar kërkojnë teknika specifike komunikimi dhe gjithashtu duhet të marrin informacion specifik rreth procedurave.

Përmbajtja e mesazheve që duhet t'u dërgohen aplikuesëve për mbrojtje është shtjelluar në [Kapitullin 3](#).

## 1.3 Si të përcillni informacionin

Informacioni mund t'u përcillet aplikuesëve për mbrojtje përmes një sërë kanalesh, duke përfshirë komunikimin verbal, materialin informativ të printuar, materialin digjital dhe materialin audio-vizual. Duke qenë se çdo kanal komunikimi arrin te aplikuesit për mbrojtje në mënyra të ndryshme dhe komunikon lloje të caktuara informacioni në mënyrë më efektive, këshillohet që informacioni të transmetohet përmes disa kanaleve të komunikimit njëkohësisht. Gjithashtu shpesh është e nevojshme të mbështetet përcjellja e informacionit duke përdorur materiale informative.

Ky seksion përshkruan kanale të ndryshme komunikimi për të përcjellë informacionin, përfitimet e përdorimit të disa kanaleve të komunikimit njëkohësisht dhe se si materiali informativ mund të mbështesë shpërndarjen e informacionit.

### 1.3.1 Merrni parasysh kanalet e komunikimit që do të përdoren

Jo të gjitha kanalet e komunikimit janë të njëjta. Një kanal i caktuar mund të përshtatet më mirë për një kategori të caktuar aplikuesish për mbrojtje dhe, në mënyrë të ngjashme, kanale të tjera mund të përshtaten më mirë për mesazhin specifik që po kërkon të komunikoni në një moment të caktuar. Prandaj është e rëndësishme të zgjidhni kanal(et) më të përshtatshme të komunikimit për të dhënë informacion.

Kur zgjidhni kanal(et) tuaja të komunikimit, sigurohuni që është **i përshtatshëm për qëllimin tuaj** (p.sh. duke marrë parasysh se sa i detajuar apo kompleks është mesazhi juaj) dhe që është **i përshtatshëm për aplikuesin për mbrojtje** (duke marrë parasysh rrethanat e tyre personale).

#### (a) Komunikimi verbal

Komunikimi verbal ju lejon të kontrolloni për së dyti nëse informacioni është kuptuar. Për këtë arsye, aplikuesi për mbrojtje duhet t'u komunikohet gojarisht informacioni kompleks, i shoqëruar me shpjegimet e duhura.





Ju duhet t'i përshtatni teknikat tuaja të komunikimit me rrethanat personale të aplikuesit për mbrojtje dhe të jepni informacione që janë drejtpërdrejt të rëndësishme për ta. Ju gjithashtu mund të aplikoni teknika për të verifikuar menjëherë nëse aplikuesi për mbrojtje e ka kuptuar saktë mesazhin tuaj. Për këto arsye, rekomandohet që çdo aplikuesi për mbrojtje t'i jepet informacion verbalisht të paktën një herë gjatë qasjes në procedurë.

Për më shumë informacion mbi teknikat e komunikimit verbal, shih seksionin [1.2.2\(a\) "Teknikat e komunikimit verbal"](#).

Avantazhet	Disavantazhet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arrin të gjithë aplikuesit për mbrojtje</li> <li>• Komunikon informacione komplekse</li> <li>• Komunikon informacione të personalizuar</li> <li>• Përshtat teknikat e komunikimit me rrethanat personale të aplikuesit për mbrojtje</li> <li>• Mund të sigurojë diskutime konfidenciale</li> <li>• Mund të sigurojë kuptueshmërinë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkon kohë</li> <li>• Mund t'u drejtohet vetëm individëve ose grupeve më të vogla</li> <li>• Mund të mos jetë në dispozicion për aplikuesit për mbrojtje në çdo kohë</li> <li>• Kërkon përkthim</li> </ul>



#### **Këshillë praktike për krijimin e grupeve të aplikuesëve për mbrojtje për dhënie e informacionit**

- Formoni grupe aplikuesish për mbrojtje për seancat e dhënies së informacionit verbalisht duke parë rrethanat e tyre personale.

Ndonjëherë mund të formohen grupe më të mëdha, për shembull kur informacioni i përgjithshëm u jepet aplikuesëve për mbrojtje që kanë formime të ngjashme për sa i përket gjuhës, kombësisë dhe kulturës. Herë të tjera, duhet të merren parasysh grupet më të vogla apo edhe dhënia e informacionit në mënyrë individuale, për shembull kur aplikuesit për mbrojtje duhet të marrin informacion specifik dhe/ose informacioni duhet t'u komunikohet atyre në një mënyrë specifike për t'u siguruar që ata e kuptojnë, për shembull për fëmijët ose personat me vështirësi njohëse dhe të të mësuarit.

- Merrni parasysh madhësinë dhe përbërjen e grupit për të siguruar dhënie efektive të informacionit.

Madhësia e grupit nuk duhet të jetë aq e madhe sa ta bëjë të vështirë për një aplikues për mbrojtje të bëjë pyetje ose që ju të aplikoni metodat e verifikimit për të siguruar kuptueshmërinë. Përbërja e grupit duhet të marrë parasysh se çfarë nevojitet që një aplikues për mbrojtje të ndihet i sigurt për të ngritur pyetje. Për shembull, gratë mund të mos flasin ose të bëjnë pyetje që janë personalisht të rëndësishme për to, ndërsa janë në prani të burrave.

Gjatë dhënies së informacionit në grup, këshillohet që aplikuesit për mbrojtje të informohen në mënyrë të qartë se ata mund të bëjnë pyetje edhe privatisht dhe në mënyrë konfidenciale.





## Këshillë praktike për mbështetjen e informacionit të dhënë verbalisht me materialet informuese

- Mbështetini sesionet e informacionit të dhënë verbalisht me materiale të shtypura ose lidhje të burime digjitale në mënyrë që aplikuesi për mbrojtje të mund të rishikojë informacionin sipas ritmit të tij.

Dhënia e informacionit verbalisht ka shumë përparësi, por është kohëshkurtër nga natyra. Për aplikuesin për mbrojtje, mund të jetë sfiduese të thithë dhe të mbajë sasi të mëdha me përmbajtje të re në harkun kohor të caktuar. Kjo është arsyeja pse ju duhet t'i mbështesni seancat tuaja të informimit verbal me materiale të shkruara.

### (b) Materialet e shtypura

Printimet përfshijnë kryesisht informacione të shkruara, duke përfshirë fletëpalosje, broshura ose libërtha që mund të mbështeten nga mjete ndihmëse vizuale, të tilla si infografikat, vizatimet ose diagramet. Për këtë arsye, materialet e shtypura mund të komunikojnë mesazhe të detajuara dhe një sasi të madhe informacioni.

Printimet janë një kanal komunikimi i njëanshëm, i cili është i destinuar kryesisht për aplikuesit për mbrojtje me njohuri në shkrim-lexim. Në të njëjtën kohë, disa nga mesazhet kyçe mund të ilustrohen në mjete ndihmëse vizuale për t'u komunikuar përmbajtje të kufizuar aplikuesëve për mbrojtje që janë analfabetë ose kanë aftësi të dobëta në lexim. Materialet e shtypura të komunikimit mund t'i vihen në dispozicion aplikuesit për mbrojtje në çdo kohë.

Avantazhet	Disavantazhet
<ul style="list-style-type: none"><li>• Arrijnë audiencë të mëdha</li><li>• Janë të disponueshme për aplikuesin për mbrojtje në çdo kohë</li><li>• Mund të jenë në disa gjuhë</li><li>• Kursejnë kohë në procesin e dhënies së informacionit</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përdorim shumë i kufizuar për personat analfabetë/me aftësi të pakta në shkrim-lexim</li><li>• Të vështira për t'u bërë plotësisht të qasshme sipas rrethanave personale të azilkërkuarit</li><li>• Kanë nevojë për përshtatje për të komunikuar informacione të ndryshme të aplikues për mbrojtje të ndryshëm</li><li>• Nuk është e mundur të verifikohet kuptueshmëria</li><li>• Të kushtueshme për t'u printuar dhe për të mbajtur informacionin të përditësuar</li></ul>



### Këshilla praktike për t'u përdorur me personat analfabetë dhe me njohuri të pakta në shkrim-lexim

- Përdorni përmbledhje të thjeshta dhe ilustrime vetë-shpjeguese

Personat me aftësi të pakta në lexim e kuptojnë rëndësinë e informacionit të shkruar dhe shpesh kanë zhvilluar teknika për ta përdorur atë. Ata shpesh mund të kenë qasje në përmbajtjen e materialit të shkruar nëse ai përmban përmbledhje të thjeshta, të tilla si një kuti me përmbledhje të shkurtra në fillim të çdo kapitulli.

Një person analfabet do t'i marrë dhe do t'i mbajë materialet e shtypura nëse e kupton se informacioni është i rëndësishëm për të. Kjo mund të arrihet duke përdorur ilustrime vetë-shpjeguese në kopertinë.

Personat me aftësi të pakta në lexim dhe personat analfabetë shpesh do t'u kërkojnë të tjerëve nga komunitetet e tyre që t'u lexojnë me zë tekstet më të gjera.

#### (c) Komunikimi digjital

Informacioni mund të shpërndahet nëpërmjet platformave digjitale në mënyrë që të jetë në dispozicion të aplikuesit për mbrojtje gjatë të gjithë kohës. Megjithatë, kjo nënkupton që aplikuesi për mbrojtje ka aftësitë digjitale të nevojshme për të përdorur platformat e informacionit dhe qasje në pajisjet përkatëse (p.sh. lidhje interneti dhe kompjuter ose telefon celular). Për më tepër, platformat e informacionit duhet të jenë të qasshme në një gjuhë që aplikuesi për mbrojtje mund ta kuptojë.

Platformat digjitale mund të përdoren për të ruajtur lloje të ndryshme materiali informativ, duke përfshirë materiale me një nivel të lartë detajesh mbi një sërë temash informacioni. Në këtë mënyrë, aplikuesi për mbrojtje mund të gjejë informacion të detajuar për të gjitha temat që kanë të bëjnë me të.

Informacioni mund të shpërndahet nëpërmjet një sërë platformash digjitale, disa prej të cilave lejojnë ndërveprimin me aplikuesin për mbrojtje.

#### Komunikimi digjital i njëanshëm

Materiali informativ që shpërndahet në mënyrë digjitale shpesh synohet për komunikim të njëanshëm. Megjithatë, ai mund të përshtatet me rrethanat personale të aplikuesëve për mbrojtje dhe të përfshijë tekst të shkruar, artikuj komunikimi audio-vizualë.



### Këshillë praktike për përdorimin e mjeteve digjitale për të vënë në dispozicion informacionin në formate të ndryshme

- Përdorni sisteme të konvertimit të tekstit në të folur për ta vënë në dispozicion informacionin tuaj të shkruar në format audio.

Kjo është e dobishme si për personat me aftësi të kufizuara leximi ashtu edhe për ata që nuk e flasin rrjedhshëm gjuhën e përdorur.

### Komunikimi digjital i dyanshëm

Komunikimi digjital mund të përfshijë platforma interaktive, të tilla si aplikacionet për celular të dedikuara për dhënien e informacionit, media sociale dhe biseda të integruara në një faqe interneti. Këto platforma i lejojnë aplikuesit për mbrojtje të kontaktojnë me ofruesin e informacionit për të marrë më shumë informacion ose sqarime.

Mund të përdoren gjithashtu edhe shërbimet e telefonatave dhe mesazheve për të komunikuar drejtpërdrejt me aplikuesin për mbrojtje. Këto përfshijnë linjat telefonike, emailin, telefonatat dhe aplikacionet për celular siç është WhatsApp. Këto kanale mund të përdoren për të shpërndarë informacione ose njoftime specifike. Duhet të jetë i disponueshëm përkthimi për të siguruar komunikim efektiv.

Edhe pse ndërveprimi digjital nuk mund të zëvendësojë dhënien e informacionit verbal ballë për ballë, mjetet e sipërpërmendura mund t'u përgjigjen pyetjeve ose shqetësimeve më të ngutshme që aplikuesi për mbrojtje mund të ketë ndërmjet seancave të dhënies së informacionit në mënyrë individuale.

Avantazhet	Disavantazhet
<ul style="list-style-type: none"><li>• Arrin audienca të mëdha</li><li>• Formati i dhënies së informacionit mund të përshtatet për nevojat e aplikuesëve për mbrojtje, duke përfshirë tekstin dhe mjetet ndihmëse audio-vizuale</li><li>• Mundëson ndërveprimin midis aplikuesit për mbrojtje dhe ofruesit të informacionit</li><li>• I disponueshëm në çdo kohë</li><li>• Mund të vihet në dispozicion në shumë gjuhë</li><li>• Mund të japë informacion specifik dhe të përditësuar</li><li>• Nuk kërkon kohë ose nuk kushton për të dhënë informacionin</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Vetëm për aplikuesit për mbrojtje me aftësitë e duhura digjitale</li><li>• Vetëm për aplikuesin për mbrojtje që kanë qasje në lidhje interneti dhe pajisjet përkatëse</li><li>• Duhet të zhvillohen materiale të specializuara për të komunikuar informacionin sipas rrethanave personale të aplikuesëve për mbrojtje</li><li>• Mundësi e kufizuar për t'u siguruar për kuptueshmërinë</li></ul>



### Këshilla praktike për pyetjet e shpeshta

- Përgatitni pyetjet e shpeshta (PESH) dhe përgjigjet për secilën temë informacioni. Kjo do të lehtësojë dhënie e informacionit si për ofruesin e informacionit ashtu edhe për aplikuesin për mbrojtje.

Pyetjet e shpeshta mund të automatizohen në platformat digjitale duke përdorur chatbot-et që “flasin” me aplikuesin për mbrojtje për pyetjet e tyre më të zakonshme mbi procedurën e azilit dhe u referohen materialeve përkatëse të informacionit. Chatbot-et mund të programohen për të komunikuar në gjuhë të ndryshme. Ato funksionojnë 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, dhe mund të vihen në dispozicion edhe në ambiente publike në qendrat e pritjes, ose në zonën e pritjes në shërbimin e azilit.

#### (d) Komunikimi audio-vizual

Komunikimi audio-vizual u referohet mediave transmetuese, duke përfshirë altoparlantët, ekranet, televizionin ose radion. Ky kanal komunikimi i njëanshëm ka për qëllim komunikimin e mesazheve ose njoftimeve të thjeshtuara që duhet të arrijnë tek aplikuesit për mbrojtje brenda një afati të shkurtër kohor. Informacioni i transmetuar shpesh shpërndahet në një mjedis me shpërqendrim, gjë që e bën transmetimin më pak të përshtatshëm për mesazhe të detajuara, komplekse ose të personalizuar.

Edhe pse mediat transmetuese mund të arrijnë audiencë të mëdha, ky kanal është më efektiv kur synon një audiencë të mirëpërcaktuar. Për shembull, altoparlantët janë një kanal i dobishëm për të dhënë njoftime dhe ekranet mund të përdoren për të shpërndarë video dhe animacione në ambientet e pritjes.

Avantazhet	Disavantazhet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arrin audiencë të mëdha</li> <li>• Mund të bëhet i qasshëm për aplikuesit për mbrojtje pavarësisht nga rrethanat e tyre personale</li> <li>• Nuk kërkon kohë për të dhënë informacionin</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vetëm për mesazhe ose njoftime të targetuara, jo për informacion kompleks, të detajuar ose të personalizuar</li> <li>• Audiencë e synuar e arritshme vetëm në kontekste të caktuara, të tilla si operacionet, kampet e refugjatëve dhe qendrat e pritjes</li> <li>• E vështirë për t'u vënë në dispozicion në shumë gjuhë</li> <li>• Nuk është e mundur të verifikohet kuptueshmëria</li> </ul>

### 1.3.2 Përdorni disa kanale në të njëjtën kohë

Është e dëshirueshme që të shpërndahet i njëjti informacion përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit për arsye të ndryshme.

- Informacioni është më i arritshëm kur vihet në dispozicion në disa kanale që mund t'u përshtaten rrethanave personale të secilit aplikues për mbrojtje, duke përfshirë shkallë të ndryshme të shkrim-leximit, arsimimit, kapacitetit njohës, pjekurisë, etj.
- Duke angazhuar më shumë shqisa (dëgjim, shikim, të folur), është më e lehtë të kuptohet dhe të ruhet informacioni i ri.
- Përsëritja e përmbajtjes rrit të kuptuarit dhe besimin në informacionin që ofrohet.
- Duke përdorur kanale shtesë ju rritni mundësinë për të arritur realisht te aplikuesi për mbrojtje.

Prandaj, përdorimi i kanaleve të ndryshme për të shpërndarë informacion ju ndihmon të arrini tek aplikuesi për mbrojtje dhe të përforconi mesazhin.

Aplikuesëve për mbrojtje duhet t'u jepet mundësia të marrin informacion të personalizuar. Kjo mund të bëhet përmes komunikimit verbal që përshtat teknikat e komunikimit sipas rrethanave personale të aplikuesit për mbrojtje dhe ju lejon të jepni mesazhe që lidhen drejtpërdrejt me të. Komunikimi verbal mund të kombinohet me kanale të tjera komunikimi për t'u siguruar që informacioni të jetë i disponueshëm për aplikuesin për mbrojtje në çdo kohë.

Kur informacioni vihet në dispozicion në disa kanale, është e nevojshme të sigurohet që ai të jetë i qëndrueshëm.



#### **Këshillë praktike për krijimin e një lidhjeje midis kanaleve të printuara dhe atyre digjitale**

- Përdorni materiale të shtypura për të orientuar aplikuesin për mbrojtje drejt informacionit në internet. Për ta bërë këtë:
  - bëjini të gjitha materialet tuaja të shtypura të qasshme në platformat digjitale;
  - përfshini një lidhje dhe/ose kod QR në materialin tuaj të shtypur.

### 1.3.3 Mbështetni dhënien e informacionit me materiale të ndryshme informative

Për të shpërndarë informacionin përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, duhet të keni në dispozicion materiale informative. Ju mund të zgjidhni midis llojeve të shumta të materialeve informative për ta mbajtur informacionin në format të shkruar, vizual dhe/ose audio. Shumica e llojeve të materialeve ju lejojnë të kombinoni formate të ndryshme, gjë që rrit qasjen në informacion për aplikuesit për mbrojtje.



Tabela 1 rendit llojet më të zakonshme të materialeve informative, të grupuara në kategori sipas formatit të tyre dhe të shoqëruara me avantazhet dhe disavantazhet përkatëse.

**Tabela 1. Avantazhet dhe disavantazhet e llojeve të ndryshme të materialeve**

Lloji i materialit	Avantazhet	Disavantazhet
<b>Komunikimi me shkrim që mund të mbështetet me mjete ndihmëse vizuale</b>		
Fletëpalosje / broshurë / buletin informativ	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lejon mesazhe të synuara</li> <li>• Mund të komunikojë informacion të përgjithshëm dhe të detajuar</li> <li>• Mund të komunikojë një sërë temash të ndryshme informacioni</li> <li>• Mund të shpërndahet përmes sesioneve të dhënies së informacionit verbalisht, printimeve dhe platformave digjitale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I përshtatshëm për mesazhe komplekse vetëm nëse ato mund të thjeshtohen</li> <li>• Jo i përshtatshëm për të dhënë shpjegime të gjera ose shumë detaje</li> </ul>
Libërth / udhëzues	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I përshtatshëm për mesazhe dhe informacione komplekse për një temë specifike</li> <li>• Mund të komunikojë detaje të gjera</li> <li>• Mund të komunikojë shumë tema të ndryshme informacioni</li> <li>• Mund të shpërndahet përmes sesioneve të dhënies së informacionit verbalisht, printimeve dhe platformave digjitale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Objektivi kryesor nuk janë aplikuesit për mbrojtje, por praktikuesit e azilit</li> <li>• Informacioni i gjerë dhe i detajuar mund të jetë i vështirë për t'u përvetësuar nga aplikuesi për mbrojtje</li> <li>• Kërkon kohë për t'u lexuar</li> </ul>



Lloji i materialit	Avantazhet	Disavantazhet
<b>Komunikimi vizual që mund të mbështetet me informacion të shkruar</b>		
Poster	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I përshtatshëm për mesazhet ose njoftimet e thjeshtuara</li> <li>• Mund të përdoret për të theksuar ose për t'i dhënë vizibilitet një teme informacioni</li> <li>• Mund të shpërndalet përmes shtypshkrimeve dhe platformave digjitale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I përshtatshëm vetëm për mesazhet kyçe të thjeshtuara</li> <li>• Hapësirë e kufizuar për informacion; jo për informacion të detajuar</li> <li>• Vetëm për maksimumi dy tema informative</li> <li>• Posterët e shtypur kërkojnë hapësirë të madhe në mur</li> </ul>
Diagram	<ul style="list-style-type: none"> <li>• U përshtatet mesazheve që mund të ilustrohen si një kohështirje ose proces kronologjik</li> <li>• Mund të përdoret për të shpjeguar ose thjeshtuar informacione komplekse</li> <li>• Mund të komunikojë informacion të detajuar</li> <li>• Mund të shpërndalet përmes sesioneve të dhënies së informacionit verbalisht, printimeve dhe platformave digjitale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mund të mbulojë vetëm një temë informacioni ose një numër të kufizuar temash</li> <li>• Vetëm për informacion që mund të paraqitet si proces kronologjik</li> </ul>
Film vizatimor / libër me figura / libër për t'u ngjyrosur / libër aktivitetesh	<ul style="list-style-type: none"> <li>• U përshtatet mesazheve kyçe</li> <li>• Mund të komunikojë mesazhe të ngarkuara emocionalisht</li> <li>• Mund të komunikojë disa tema informacioni</li> <li>• Format i përshtatshëm për fëmijët</li> <li>• Mund të shpërndalet përmes sesioneve të dhënies së informacionit verbalisht, printimeve dhe platformave digjitale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryesisht për mesazhe të thjeshtuara; nuk ka vend për shpjegime</li> <li>• Vetëm për mesazhet që mund të komunikohen përmes një numri të kufizuar kuadrosh me fotografi</li> <li>• Jo për informacion të detajuar</li> </ul>





Lloji i materialit	Avantazhet	Disavantazhet
<b>Komunikimi audio që mund të mbështetet me informacion të shkruar</b>		
Skedar audio / podcast	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mund të komunikojë mesazhe komplekse</li> <li>• Shpesh i përshtatet informacionit për një temë specifike</li> <li>• Mund të komunikojë informacion të përgjithshëm dhe të detajuar</li> <li>• Mund të përmbajë disa tema informacioni</li> <li>• Mund të konvertohet nga formati i shkruar</li> <li>• Mund të shpërndalet përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, të tilla si seancat e dhënies së informacionit verbalisht, ekranet në zonat e pritjes dhe platformat digjitale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mund të jetë i vështirë përqendrimi te skedarët audio të gjatë</li> <li>• Shpjegimet e hollësishme mund të jenë të vështira për t'u ndjekur pa vizualizim ose tekst</li> <li>• Audioja nuk mund të shpërndalet si material i shtypur (mund të printohen transkriptet e skedarëve audio)</li> </ul>



Lloji i materialit	Avantazhet	Disavantazhet
<b>Kombinimi i komunikimit të shkruar, vizual dhe audio</b>		
Prezantim në PowerPoint	<ul style="list-style-type: none"> <li>• U përshtatet mesazheve të synuara</li> <li>• Mund të komunikojë informacion të përgjithshëm dhe të detajuar</li> <li>• Mund të komunikojë një sërë temash të ndryshme informacioni</li> <li>• I qasshëm për të gjithë aplikuesit për mbrojtje kur kombinon tekst të shkruar, pamje vizuale, audio dhe madje edhe video</li> <li>• Tërheq lehtë vëmendjen</li> <li>• Informacioni mund të modifikohet dhe përditësohet pa kosto të konsiderueshme</li> <li>• Prodhimi është më pak i kushtueshëm se një video/animacion</li> <li>• Mund të shpërndahet përmes sesioneve të dhënies së informacionit verbalisht, printimeve dhe platformave digjitale</li> <li>• Mund të dublohet në shumë gjuhë me pak kosto shtesë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryesisht për mesazhet kyçe me nivel të kufizuar detajesh</li> <li>• Jo për shpjegime apo detaje të gjerësishme</li> <li>• Vetëm për informacion që mund të komunikohet përmes një numri të kufizuar diapozitivësh</li> </ul>
Video/animacione	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përshtatshme për mesazhet kyçe të thjeshtuara</li> <li>• Mund të komunikojë mesazhe të ngarkuara emocionalisht</li> <li>• Mund të komunikojë informacion të përgjithshëm dhe të detajuar</li> <li>• Të qasshme për të gjithë aplikuesit për mbrojtje kur kombinohet teksti i shkruar, vizualizimi dhe audioja</li> <li>• Tërheq lehtë vëmendjen</li> <li>• Mund të shpërndahet përmes sesioneve të dhënies së informacionit verbalisht dhe platformave digjitale</li> <li>• Mund të dublohet në shumë gjuhë me pak kosto shtesë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryesisht për një temë informacioni ose një numër të kufizuar temash</li> <li>• Kryesisht për mesazhet kyçe me nivel të kufizuar detajesh</li> <li>• Nuk mund të shpërndahen si materiale të shtypura</li> <li>• Kërkon gatishmëri teknologjike, duke përfshirë shpejtësi të mjaftueshme interneti</li> <li>• Kosto të larta prodhimi; e vështirë për të përditësuar përmbajtjen</li> </ul>



## Trajnim i mëtejshëm për dhënien e informacionit

Dhënia e informacionit për aplikuesit për mbrojtje konsiderohet përgjithësisht një ekspertizë e veçantë. Metodologjitë për dhënien e informacionit shpjegohen shkurtimisht në këtë kapitull, por për të kuptuar kompleksitetin e plotë të temës dhe për të qenë në gjendje t'i përdorni ato njohuri në praktikë, EUAA-ja rekomandon ndjekjen e një moduli trajnimi të dedikuar mbi këtë temë.



### Trajnime të ngjashme të EUAA-së

EUAA-ja ofron modulin “**Komunikimi dhe dhënia e informacionit për azilkërkuesit**” i cili përshkruan aftësitë e nevojshme në hartimin, planifikimin dhe zbatimin e strategjive të komunikimit ndërkulturor. Qëllimi i këtij moduli është t'u mundësojë praktikuesve të vlerësojnë nevojat për informacion të personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, aplikuesëve për mbrojtje dhe përfituesve të mundshëm të mbrojtjes ndërkombëtare. Pas ndjekjes së këtij trajnimi, ju do të jeni në gjendje të përshtatni dhe shpërndani mesazhe të qasshme përmes kanaleve të duhura.

Nëse jeni i interesuar të ndiqni kurse trajnimi të EUAA-së, ju lutemi kontaktoni personin përgjegjës për trajnimin brenda autoritetit tuaj për të marrë informacion shtesë.



## 2. Struktura organizative e dhënies së informacionit

Rrethanat që lidhen me kohën kur informacioni i jepet aplikuesit për mbrojtje ndryshojnë në varësi të faktit nëse hapat proceduralë të qasjes në procedurë, kryerja, regjistrimi dhe depozitimi, ndodhin veçmas ose njëkohësisht dhe nëse ka mundësi shtesë për të bashkëvepruar me aplikuesin për mbrojtje. Kontekstet në të cilat jepet informacioni ndryshojnë në varësi të faktit nëse jeni në një mjedis operacional që i përgjigjet një numri të madh mbërritjesh ose në një mjedis zyre që mundëson takime individuale me një numër më të vogël aplikuesish për mbrojtje. Se kush e jep informacionin, kjo ndryshon në varësi të faktit nëse dhënia e informacionit është e centralizuar me një palë të interesuar apo jepet në bashkëpunim me organizata të shumta.

Autoritetet janë përgjegjëse për t'u siguruar që dhënia e informacionit u garantohet aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare (neni 12 i DPA-së së riformuluar). Kështu, ata janë përgjegjës për koordinimin e shpërndarjes së informacionit në mënyrë që mesazhet përkatëse të arrijnë tek aplikuesi për mbrojtje. Dhënia konsistente e informacionit mund të garantohet duke identifikuar, në kontekstin tuaj kombëtar, se cili informacion duhet të jepet, kur, ku dhe nga kush.

Qasja në procedurën e azilit shpesh përfshin dy mjedise: mjedisin e kontaktit të parë, që i referohet kontekstit të mbërritjes, duke përfshirë hapin procedural të kryerjes së një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare; dhe regjistrimin/depozitimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.



## Instrumente të ngjashme të EUAA-së

**EASO-Frontex, Udhëzuesi praktik për qasjen në procedurën e azilit, 2016** ndihmon zyrtarët e kontaktit të parë në rolin e tyre për të garantuar qasje efektive në mbrojtjen ndërkombëtare në kontekstin e kontaktit të parë, për shembull duke dhënë informacion.

Ky udhëzues praktik jep informacion në lidhje me detyrimet kryesore të zyrtarëve të kontaktit të parë, të drejtat e personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe informacion mbi garancitë procedurale dhe mbështetjen që jepet në kontekstin e kontaktit të parë.

Udhëzuesi praktik dhe përkthimet e tij janë në dispozicion këtu: <https://euaa.europa.eu/sq/publications/instrumente-praktike-zyrtaret-qe-kane-kontaktin-e-pare-udhezues-praktik>

**EASO, Udhëzues praktik mbi regjistrimin – Depozitimi i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, 2021** mbështet zyrtarët në punën e tyre të përditshme për regjistrimin dhe depozitimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare në kontekstin pas kontaktit të parë, duke iu përmbajtur standardeve të përbashkëta evropiane të regjistrimit.

Ky udhëzues praktik përcakton kuadrin ligjor në lidhje me tre hapat e qasjes në procedurë, duke përfshirë informacion të detajuar mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin në hapa të ndryshëm të regjistrimit. Udhëzuesi, ndër të tjera, përshkruan karakteristikat kryesore të mjedisit të kontaktit të parë dhe jep informacion për identifikimin e aplikuesëve për mbrojtje me cenueshmëri të mundshme ose raste të Dublinit.

Udhëzuesi praktik dhe përkthimet e tij janë në dispozicion këtu: <https://euaa.europa.eu/sq/publications/easo-udhezues-praktik-regjistrimin>

Ky kapitull prezanton mjediset lidhur me kur, ku dhe nga kush mund t'u jepet informacion aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare. Ai paraqet se si mjedise të ndryshme mund të ndikojnë në dhënie e informacionit në praktikë.

## 2.1 Koha e dhënies së informacionit

Të drejtat e aplikuesit për mbrojtje zbatohen që nga fillimi i procedurës së azilit. Prandaj është e rëndësishme që informacioni të jepet në kohë për t'u mundësuar atyre të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të përmbushin detyrimet e tyre <sup>(16)</sup>.

Është e nevojshme të merret parasysh koha kur aplikuesit për mbrojtje duhet të marrin informacione të caktuara për të marrë pjesë plotësisht në procedurën e azilit. Në të njëjtën kohë, duhet të keni kujdes që të mos e mbingarkoni aplikuesin për mbrojtje me shumë informacione në fillim të procedurës.

<sup>(16)</sup> Neni 12(1)(a) i DPA-së (e riformuluar).

## 2.1.1 Identifikoni mundësitë për të dhënë informacion

Qasja në procedurë përfshin disa mundësi për të bashkëvepruar me aplikuesin për mbrojtje. Dhënia e informacionit me faza ju lejon të jepni informacion në kohë të ndryshme gjatë qasjes në procedurë, pa e mbingarkuar aplikuesin për mbrojtje me shumë informacione ose informacion tepër të detajuar në të njëjtën kohë. Ajo ju lejon gjithashtu t'ia përsërisni disa herë informacionin kyç aplikuesit për mbrojtje dhe të ndërtoni mbi informacionin kyç me më shumë detaje sa herë që ndërveproni me aplikuesin për mbrojtje.

Përveç dhënies së informacionit me faza, informacioni mund t'u vihet në dispozicion aplikuesëve për mbrojtje në çdo kohë nëpërmjet platformave digjitale dhe materialeve të shtypura. Për më shumë informacion referojuni seksionit [1.3 "Si të përcillni informacionin"](#).

### (a) Hapat proceduralë gjatë qasjes në procedurë

Hapat proceduralë që ndodhin gjatë qasjes në procedurë u referohen aktiviteteve të kryera nga autoritetet për regjistrimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare. Në përputhje me Nenin 6 të DPA-së së riformuluar), ekzistojnë tre hapa në qasjen në procedurë: kryerja, regjistrimi dhe depozitimi.

**Kryerja** e një kërkesë i referohet aktit të shprehjes së dëshirës për të bërë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare te një autoritet. Pas këtij hapi, aplikuesi për mbrojtje konsiderohet si azilkërkuar dhe gëzon të drejtat dhe detyrimet që i takojnë këtij statusi.

**Regjistrimi i kryerjes** nënkupton krijimin e një regjistri për qëllimin e aplikuesit për mbrojtje për të kërkuar mbrojtje, duke dokumentuar kështu se personi në fjalë është kërkuar i mbrojtjes ndërkombëtare. Në disa kontekste kombëtare mblidhen gjithashtu të dhëna bazë nga aplikuesi për mbrojtje gjatë hapit të regjistrimit.

Regjistrimi duhet të bëhet brenda afateve të caktuara kohore pas kërkesës (neni 6 i DPA-së së riformuluar):

- maksimumi 3 ditë pune për kërkesat e kryera pranë autoriteteve përgjegjëse për regjistrimin e tyre;
- maksimumi 6 ditë pune për kërkesat e kryera pranë autoriteteve të tjera që nuk janë përgjegjëse për regjistrimin e tyre;
- maksimumi 10 ditë pune për një numër kërkesash të shumta dhe të njëkohshme, të cilat e bëjnë të vështirë respektimin e afatit kohor prej 3 ose 6 ditësh.

**Depozitimi** përfundon procedurën e regjistrimit. Procedura e shqyrtimit të kërkesës fillon në këtë fazë.

Depozitimi zakonisht i referohet një faze kur mblidhen të dhëna më gjithëpërfshirëse nga aplikuesit për mbrojtje për të përfunduar regjistrimin. Më pas, kërkesa i dorëzohet autoritetit përcaktues dhe fillon shqyrtimi i tij.



Këto hapa proceduralë nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht tri faza të ndara. Kryerja mund të ndodhë para regjistrimit ose në të njëjtën kohë me të, dhe disa vende BE+ i kombinojnë hapat e regjistrimit dhe akomodimit në një fazë.

Hapat proceduralë ofrojnë një mundësi për të dhënë informacion, veçanërisht mbi procedurën që duhet ndjekur dhe të drejtat e detyrimet e aplikuesit për mbrojtje. Autoritetet shpesh i kryejnë këto hapa duke i dhënë në të njëjtën kohë informacion aplikuesit për mbrojtje dhe i shpjegojnë atij informacionin procedural në terma praktike.

Hapat proceduralë shpesh kërkojnë që aplikuesi për mbrojtje të paraqitet personalisht dhe aplikuesit për mbrojtje i ofrohet mundësia për të dhënë informacion verbalisht. Meqenëse informacioni bazë mbledhet shpesh nga aplikuesit për mbrojtje gjatë regjistrimit, kjo lejon që mesazhi të përshtatet me situatën personale të secilit aplikues për mbrojtje, për shembull për tema të tilla si mbështetja e disponueshme në lidhje me nevojat e mundshme të veçanta procedurale ose të pritjes, ose një procedurë e veçantë shqyrtimi që duhet ndjekur nëse kërkesa është kanalizuar në një procedurë të caktuar. Këto hapa ofrojnë gjithashtu një mundësi për të verifikuar kuptueshmërinë e aplikuesit për mbrojtje dhe e lejojnë të bëjë pyetje dhe të sqarojë çdo dyshim.

#### **(b) Mundësi të tjera gjatë qasjes në procedurë**

Qasja në procedurë ofron shumë mundësi për t'i dhënë informacion aplikuesit për mbrojtje, përveçse gjatë hapave proceduralë të vetë qasjes në procedurë. Këto mundësi përfshijnë sa vijon:

- konteksti i mbërritjes, duke përfshirë aktivitetet gjatë kontaktit të parë në kufi;
- kontrolli mjekësor;
- marrja e gjurmëve të gishtave;
- takim me konsulentin ligjor ose kujdestarin;
- referimi tek aktorët e specializuar për mbështetje të linjës së dytë;
- marrja e shërbimeve mbështetëse.

Këto mundësi ju lejojnë të jepni informacion më të detajuar mbi hapin në fjalë, për shembull, çfarë përfshin kontrolli mjekësor ose çfarë mund të pritët nga mbështetja e linjës së dytë.

Përveç sa më sipër, ju mund të jepni çdo informacion në lidhje me procedurën e azilit, duke përfshirë informacionin e përgjithshëm procedural ose informacionin që fokusohet mbi një temë të caktuar gjatë:


- pritjes në qendrën e pritjes;
- aktiviteteteve në komunitet.

Ju mund t'i përdorni këto mundësi për të plotësuar informacionin e dhënë gjatë hapave proceduralë dhe për të përsëritur dhe eksploruar informacione të mëtejshme të ndara më parë.



Figura 1 tregon mundësi të ndryshme që mund të lejojnë ndërveprim me azilkërkuesin gjatë qasjes në procedurë. Në kontekstin tuaj kombëtar, hapat proceduralë mund të zhvillohen njëkohësisht dhe mundësi të tjera për të dhënë informacion mund të lindin në një rend tjetër, të mos ndodhin fare, ose mund të ketë mundësi shtesë.

**Figura 1. Mundësi të ndryshme që mund të lejojnë ndërveprim me aplikuesin për mbrojtje**



- **Hapat proceduralë dhe kërkesat e tjera procedurale**
- **Mundësi të tjera**





### **Këshillë praktike për bërjen e informacionit të disponueshëm gjatë të gjithë kohës gjatë qasjes në procedurë**

Krahas këtyre mundësive për dhënie e informacionit personalisht, informacioni duhet t'i vihet në dispozicion aplikuesit për mbrojtje në çdo kohë nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit. Shih seksionin [1.2. "Si të komunikoni informacionin"](#) për detaje të mëtejshme.

## **2.1.2 Përcaktoni kohën e dhënies së informacionit për tema të caktuara**

Në procesin e dhënies së informacionit, rekomandohet të bëhet dallimi midis:

- kur ju duhet të jepni informacion kyç;
- kur mund të jepni informacion të mëtejshëm të detajuar.

Duke qenë se informacioni mund të jepet me faza, fillimisht mund të jepni informacionin bazë për secilën temë dhe më pas ta plotësoni me detaje të mëtejshme, si më poshtë:

- identifikoni mesazhet kyçe që lidhen me secilën temë informacioni;
- përsëritni mesazhet kyçe gjatë hapave të ndryshëm të procedurës;
- çdo herë, shoqëroni mesazhin/mesazhet bazë me detaje të mëtejshme.

Për më shumë informacion se kur duhet dhënë informacion për tema të caktuara, shih [Kapitulli 3](#).

## **2.2 Vendi i dhënies së informacionit**

Aspektet praktike të dhënies së informacionit janë të lidhura rreptësisht me mjedisin operacional ku në të vërtetë ndodh qasja në fazat e procedurave të azilit.

Zakonisht, komponenti i dhënies së informacionit është pjesë e një fluksi më të gjerë pune që rregullon rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të interesuara në të njëjtën kohë me zbatimin e procedurave të azilit. Një rrjedhë pune si kjo varet nga mjedisi operacional. Për shembull, fluksi i informacionit në një vendndodhje që pranon një numër të madh aplikuesish për mbrojtje do të jetë i ndryshëm nga ai që ndodh në një hapësirë zyre ku kërkesat për azil përpunohen individualisht.

Kur kemi të bëjmë me një numër të madh mbërritjesh, është e rëndësishme të dallojmë midis:

- mjedisit operacional ku aplikuesit për mbrojtje supozohet të strehohen në të njëjtin vendndodhje ku mbërrijnë deri në përfundimin e procesit të shkallës së parë (si p.sh. në kontekstin e një pike të nxehtë);
- situatat kur aplikuesit për mbrojtje zhvendosen shpejt nga porti ose limani i mbërritjes në një qendër të pritjes së parë.

Në rastin e parë, autoritetet përkatëse dhe partnerët operacionalë mund të përfitojnë nga qëndrimi më i gjatë i aplikuesëve për mbrojtje për të përcjellë mesazhe më të detajuara gjatë gjithë fazave të procedurave të azilit. Kjo do të lejojë të sqarohen dyshimet dhe të aktivizohen shtigjet përkatëse të referimit.

Në rastin e fundit, për shkak të kufizimeve në kohë dhe hapësirë, zyrtarët përgjegjës të kontaktit të parë duhet të sigurohen që aplikuesëve për mbrojtje t'u përcillen mesazhet kyçe në mënyrë të qartë dhe efikase, veçanërisht në lidhje me atë që ndodh më pas në procedurë.

Mjedisi operacional është një tjetër aspekt kyç për t'u marrë parasysh kur bëhet fjalë për sigurimin e një mjedisi konfidencial për të bashkëvepruar me aplikuesin për mbrojtje, veçanërisht me profile të caktuara si personat LGBTIQ, viktimat e dhunës me bazë gjinore ose personat me probleme shëndetësore ose aftësi të kufizuara. Konfidencialiteti është një kusht paraprak gjatë ndërveprimit me persona të tillë, për të siguruar mbrojtjen e tyre dhe për të nxitur bashkëpunimin me autoritetet.



### Këshilla praktike për numrin e madh të mbërritjeve

**Zbarkimi:** aplikuesit për mbrojtje mund të kontrollohen pas mbërritjes dhe më pas të transferohen në qendrat e pritjes së parë.

- **Përdorni materiale të shtypura dhe audio-vizuale ose kode QR që lidhen me materialin digjital** kur jepni informacion për procedurën e azilit. Ky material mund të plotësojë informacionin që është dhënë gojarisht në kohën e zbarkimit.
- **Grupojini aplikuesit për mbrojtje sipas gjuhës**, bazuar në informacionin e disponueshëm në bord për kombësitë. Drejtojuni grupeve për të dhënë informacion mbi procedurat e azilit në vendin e zbarkimit.
- **Shikoni për cenueshmëritë.** Nëse janë identifikuar paraprakisht profile të cenueshme në bazë të treguesve të disponueshëm, sigurohuni që atyre t'u jepet informacioni përkatës. Merrni parasysh sa më shumë që të jetë e mundur kërkesat e konfidencialitetit, për shembull duke i mbledhur ata persona në një grup tjetër.

**Mjediset e ngjashme me pikat e nxehta.** Duke qenë se aplikuesit për mbrojtje mund të strehohen deri në përfundimin e procedurës së azilit, fluksi i informacionit mund të strukturohet duke marrë parasysh rekomandimet standarde metodologjike të përshkruara në këtë dokument udhëzues.

- **Kujdesuni për cenueshmëritë.** Nëse ka, përdorni **zona të sigurta dhe/ose hapësira të përshtatshme për fëmijët** për të dhënë informacion mbi procedurat e azilit për profilet e cenueshëm dhe fëmijët e pashoqëruar. Kjo do të ndihmojë në përmbushjen e kërkesave të konfidencialitetit duke lejuar një ndërveprim më pjesëmarrës, pasi mund të përdorni materiale informacioni të përshtatura për nevojat e komunikimit të profileve të cenueshëm dhe fëmijëve.





### Këshilla praktike për ndërveprimin individual

- **Rregulloni flukset tuaja të punës për të kapërcyer kufizimet e hapësirës dhe për të garantuar konfidencialitetin**

Administratat e përfshira në mjediset operative ndonjëherë ballafaqohen me kufizime të përkohshme ose të përhershme të hapësirës që mund ta bëjnë të vështirë garantimin e kërkesave të konfidencialitetit.

- **Programoni një regjistrim në një orar për të garantuar konfidencialitetin**

Mund të merren parasysh përshtatjet e rrjedhës së punës për të ulur rrezikun që një aplikues për mbrojtje të dëgjohet nga të tjerë. Për shembull, mund të merrni parasysh të planifikoni vetëm një regjistrim në një orar për t'u siguruar që aplikuesit për mbrojtje dhe përkthyesit përkatës nuk mund ta njohin dhe/ose dëgjojnë njëri-tjetrin.

- **Regjistroni aplikues për mbrojtje që flasin gjuhë të ndryshme në të njëjtën kohë**

Nëse një numër i konsiderueshëm akumulimi nuk lejon regjistrimet individuale, ju mund të planifikoni në të njëjtin hark kohor aplikues për mbrojtje që flasin gjuhë të ndryshme. Kjo do të ulë rrezikun për t'u dëgjuar nga të tjerë. Zyrtarët e regjistrimit duhet të kontrollojnë paraprakisht nëse aplikuesit për mbrojtje që regjistrohen nuk arrijnë ta kuptojnë gjuhën e aplikuesit për mbrojtje tjetër dhe, për rrjedhojë, nuk mund ta kuptojnë historinë që ata po tregojnë.

- **Instaloni barriera shikueshmërie ose zhvillojini regjistrimet në internet**

Konfidencialiteti mund të mbështetet më tej duke instaluar barriera shikueshmërie në mënyrë që aplikuesit për mbrojtje të mos shohin njëri-tjetrin.

Përpunimi në distancë, si regjistrimet e azilit në internet, është gjithashtu një opsion në rast se disponueshmëria e hapësirës adekuate fizike është problem. Megjithatë, autoriteti përkatës duhet të sigurohet që ekzistojnë pajisjet e TI-së dhe kërkesat teknike për përpunimin në distancë.

## 2.2.1 Jepni informacion në kontaktin e parë

Dhënia e informacionit në kontaktin e parë shpesh bëhet në një situatë kur personi që kërkon azil ka ardhur së fundmi në vend dhe ka njohuri të pakta për procedurën e azilit. Këto situata të kontaktit të parë mund të ndodhin në kontekste të ndryshme, duke përfshirë:

- në **kufirin e jashtëm**, si në pikat e kalimit kufitar, kufijtë e gjelbër, porte dhe në zonat e tranzitit të një aeroporti;
- brenda **territorit** të një vendi BE+, kur takohet me autoritetet me synimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare.

Kontaktit i parë në kufirin e jashtëm shpesh karakterizohet nga një mjedis operacional në kontekstin e lëvizjeve ndërkufitare. Ky mund të përfshijë mbërritje të njëkohshme të rregullta dhe të çrregullta, ndërsa kontakti i parë brenda territorit zakonisht ndodh në një mjedis zyre të ngritur.

Një nga qëllimet kryesore të dhënies së informacionit në kontaktin e parë është të identifikojë ata persona që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe t'u ofrojë atyre informacione për të siguruar qasje efektive në procedurën e azilit.



### Instrumenti i EUAA-së për këtë aspekt

Për më shumë informacion mbi mjediset përreth konteksteve të kontaktit të parë dhe si të njihni një aplikues të mundshëm për mbrojtje ndërkombëtare, shihni EASO-Frontex, [\*Udhëzues praktik mbi qasjen në procedurën e azilit\*, 2016.](#)

Për të siguruar dhënien efektive të informacionit gjatë kontaktit të parë, duhet të merrni parasysh sfidat e veçanta që lidhen me dhënien e informacionit në këtë kontekst.

**Tabela 2. Sfidat dhe zgjidhjet e mundshme për sigurimin e dhënies efektive të informacionit gjatë kontaktit të parë**

Sfidat	Zgjidhjet e mundshme
<p><b>Ambient shpërqendruar</b></p> <p>Një fluks aplikuesish për mbrojtje mund të krijojë presionin e kohës dhe sfida koordinimi në pritjen e të ardhurave të rinj. Zonat e kufirit të jashtëm mund të jenë mjedise shpërqendruar dhe të mbushura me njerëz, duke kufizuar kështu kanalet e komunikimit të disponueshme për shpërndarjen e informacionit dhe kohën e disponueshme për dhënien e informacionit.</p>	<p><b>Koordinoni dhe krijoni flukset e punës</b></p> <p>Mund të krijohen nivele të avancuara koordinimi dhe fluksesh pune për të dhënë informacione në mënyrë efektive gjatë kohës kur ka një numër të madh mbërritjesh njëkohsisht, për shembull pas operacioneve të kërkim-shpëtimit ose mbërritjeve masive në kufijtë tokësorë. Mund të kontraktohen partnerë zbatues për dhënien e informacionit.</p>



### Sfidat

#### Aftësi e kufizuar për të përthithur informacion

Para mbërritjes, aplikuesit për mbrojtje shpesh kanë përfunduar një udhëtim të gjatë dhe të pasigurt, gjatë të cilit ata mund të kenë qenë subjekt i shfrytëzimit dhe abuzimit ose keqtrajtimeve të tjera. Kjo mund të ndikojë në gjendjen e tyre fizike dhe mendore. Ata mund të kenë nevoja të ngutshme që nuk lidhen domosdoshmërisht me azilin. Stresi mund të kufizojë aftësinë e tyre për të përthithur informacion.

Aplikuesi për mbrojtje gjithashtu mund të kenë pak ose aspak njohuri të mëparshme për mbrojtjen ndërkombëtare dhe procedurën e azilit, ose se si kryhen procedurat administrative në Evropë. Kjo mungesë e njohurive të mëparshme mund të kufizojë aftësinë e tyre për të përthithur sasi të mëdha informacioni të ri ose për të kuptuar terminologjinë ligjore.

#### Mundësi e kufizuar për të dhënë informacion të përshtatur

Mund të jetë e vështirë të identifikohen menjëherë rrethanat personale të secilit aplikues për mbrojtje, për shkak të kufizimeve në ndërveprim dhe mbledhjen e të dhënave nga aplikuesi për mbrojtje pas mbërritjes. Kështu, mundësia për të dhënë informacion të përshtatur në një mënyrë që i përshtatet situatës së aplikuesit për mbrojtje është e kufizuar.

### Zgjidhjet e mundshme

#### Jepni informacion më pak të detajuar


Dhënia e informacionit mund të fokusohet në dhënie e informacionit kyç me më pak detaje në mjedise që janë shpërqendruese ose kur aplikuesit për mbrojtje mund të kenë një aftësi të kufizuar për të përthithur informacionin. Ky informacion kyç më vonë mund të plotësohet me më shumë detaje dhe tema informacioni shtesë.

Aplikuesëve për mbrojtje mund t'u jepet material informativ i shtypur që ata mund ta rishikojnë më vonë. Materiali mund të përfshijë udhëzime se si të qaseni në më shumë informacion në platformat digjitale ose verbalisht.

#### Inkurajojini aplikuesit për mbrojtje të paraqesin rrethanat e tyre personale

Meqenëse mund të jetë e vështirë të identifikohen rrethanat personale që nuk janë të dukshme gjatë kontaktit të parë, aplikuesit për mbrojtje mund të inkurajohen që t'ua tregojnë autoriteteve rrethanat e tyre. Kështu, ju duhet të shpjegoni qartë dhe në mënyrë të kuptueshme se cilat janë nevojat e veçanta dhe si mund t'i paraqesin aplikuesit për mbrojtje ato.





## 2.2.2 Jepni informacion gjatë regjistrimit dhe akomodimit

Gjatë regjistrimit dhe akomodimit, informacioni zakonisht jepet në një mjedis të ngritur, si p.sh. një mjedis zyre ose një qendër akomodimi. Në varësi të kontekstit tuaj kombëtar, kjo shpesh ndodh pasi aplikuesi për mbrojtje ka qëndruar në vend për një kohë të shkurtër dhe tashmë janë plotësuar disa nga nevojat e tij më të ngutshme, të tilla si nevojat shëndetësore, ushqimore ose për strehim. Kështu, aplikuesi për mbrojtje mund të jetë në gjendje të përthithë më shumë informacion sesa në kontekstin e kontaktit të parë.

**Një mjedis i ngritur** mundëson një mjedis potencialisht të qetë në të cilin jepet informacion. Ky kontekst shpesh përfshin një takim individual me aplikuesin për mbrojtje në një mjedis që garanton konfidencialitet dhe siguri. Megjithatë, ai mund të përfshijë gjithashtu takime me grupe aplikuesish për mbrojtje. Konteksti shpesh lejon që informacioni të shpërndahet përmes disa kanaleve të komunikimit, duke përfshirë komunikimin verbal, materialet e shtypura dhe platformat digjitale.

Aplikuesit për mbrojtje zakonisht marrin pjesë në **takime individuale** për mbledhjen e të dhënave personale gjatë regjistrimit dhe akomodimit. Këto takime janë një mundësi e mirë për t'i dhënë aplikuesit për mbrojtje informacion të individualizuar sipas rrethanave të tyre personale. Është gjithashtu e mundur të përcaktohet se cili material informativ do të ishte më efektiv.



### Instrumenti i EUAA-së për këtë aspekt

Për më shumë informacion mbi cilësimet e regjistrimit/strehimit, shihni EASO, [Udhëzues praktik mbi regjistrimin – Depozitimi i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare](#), dhjetor 2021.



## 2.3 Kush e jep informacionin?

Ju mund të mos jeni personi i vetëm që i jepni informacion aplikuesit për mbrojtje. Edhe autoritete dhe organizata të tjera që punojnë në fushën e azilit mund të japin informacion në partneritet me ju. Përgjegjësia për të siguruar dhe koordinuar dhënien e informacionit bie mbi autoritetet. Në të njëjtën kohë, të gjithë aktorët e përfshirë kanë përgjegjësinë të angazhohen në koordinimin në terren dhe të sigurohen që informacioni i tyre është koherent.

### 2.3.1 Përcaktoni se cilat organizata duhet të japin informacion

Informacioni jepet kryesisht nga autoritetet përgjegjëse për kryerjen e hapave proceduralë të qasjes në procedurë në kontekstin tuaj kombëtar. Këto mund të përfshijnë:

- autoritetin përcaktues,
- administratat e policisë,
- administratat e rojës kufitare dhe bregdetare,
- zyrat lokale të qytetarëve.

Dhënia e informacionit mund të bëhet gjithashtu nga autoritete ose organizata të tjera që ndërveprojnë me aplikuesin për mbrojtje gjatë qasjes në procedurë (neni 21(1) i DKP-së (e riformuluar))<sup>(17)</sup>. Këto mund të përfshijnë:

- aktorë që drejojnë qendrat e pritjes;
- organizatat e shoqërisë civile;
- konsulentët ligjorë;
- organizatat ndërkombëtare, si UNHCR-ja ose Organizata Ndërkombëtare për Migracionin;
- Agjencitë e Bashkimit Evropian;
- konsulentët ligjorë;
- aktorët që drejojnë objektet e ndalimit;
- institucionet e vuajtjes së dënimit.

Listat e mësipërme janë të përgjithshme. Në mjediset tuaja kombëtare, organizatat e përfshira në situatën e kontaktit të parë dhe gjatë regjistrimit/strehimit mund të mos jenë gjithmonë të njëjta. Gjithashtu, vlen të theksohet kontributi i çmuar në dhënien e informacionit nga organizatat e shoqërisë civile dhe vullnetarët e komunitetit.

---

<sup>(17)</sup> Neni 21(1) i DPK-së (e riformuluar) "Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që informacioni ligjor dhe procedural i përmendur në nenin 19 të ofrohet falas nga organizata joqeveritare, ose nga profesionistë të autoriteteve qeveritare ose nga shërbime të specializuara të Shtetit."



Është gjithashtu mirë të kihet parasysh se jo të gjitha organizatat kanë domosdoshmërisht kapacitetin për të ofruar informacion mbi një shumëllojshmëri të gjerë temash që mund të jenë përtej specializimit të tyre.



### **Këshillë praktike për të kundërshtuar dezinformimin e marrë nga burime jozyrtare**

Aplikuesit për mbrojtje me formime të caktuar kulturore mund të tërhiqen që të kërkojnë këshilla nga anëtarët e komunitetit të tyre, për shembull sepse nuk janë mësuar të kërkojnë informacion nga autoritetet, të cilët, pa dashje, mund të përhapin informacione të pasakta dhe/ose të paplota. Si rezultat, aplikuesit për mbrojtje mbështeten te dezinformimi në vend të informacionit institucional.

Dezinformimi mund të vijë gjithashtu nga përpjekjet e qëllimshme të kontrabandistëve ose trafikantëve për të mashtruar aplikuesit për mbrojtje duke u dhënë atyre informacione të fabrikuara dhe të manipuluar.

Këtë mund ta kundërshtoni me përsëritjen e shpeshtë dhe konsistencën e informacionit nga burime të autorizuara, përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit.

## **2.3.2 Koordinoni midis organizatave që japin informacion**

Për të pasur besimin e aplikuesit për mbrojtje në procedurën e azilit, është me rëndësi të madhe që të gjitha autoritetet, ofruesit e shërbimeve dhe organizatat e shoqërisë civile të përfshira të përhapin një mesazh të qëndrueshëm.

Duke qenë se organizata të shumta mund të përfshihen në dhënien e informacionit gjatë qasjes në procedurë, mund të nevojitet koordinim për të siguruar dhënien e mesazheve koherente për të gjithë aplikuesit për mbrojtje dhe për të garantuar që informacioni të arrijë te të gjithë aplikuesit për mbrojtje. Kini parasysh se mund të nevojiten koordinime të ndryshme për situatat e kontaktit të parë dhe gjatë regjistrimit/akomodimit.

Kur koordinoni dhënien e informacionit, do t'ju duhet të merrni parasysh të paktën përmbajtjen dhe qasjen.

**Koordinimi i përmbajtjes** lidhet me mënyrën se si mesazhet koherente u dërgohen në mënyrë sistematike aplikuesëve për mbrojtje. Kjo mund të marrë parasysh, për shembull, çfarë materialesh informimi përdoren, cili është materiali referues, kush i harton këto materiale dhe si mund të trajtohen ofruesit e informacionit. Mund të nevojitet gjithashtu koordinim për ta mbajtur informacionin të përditësuar dhe konsistent me kalimin e kohës.

**Koordinimi i qasshmërisë** i referohet mënyrës se si të gjithë aplikuesit për mbrojtje marrin informacion. Ai mund të marrë në konsideratë, për shembull, se cilat organizata janë përgjegjëse për dhënien e informacionit të caktuar në çdo fazë të qasjes në procedurë dhe se si mund të sigurohemi për një grup të përshtatshëm aftësish në mënyrë që stili i komunikimit t'i përshtatet audiencës.





Koordinimi përfshin, për shembull, mekanizmat e mëposhtëm:

- një sistem i centralizuar ku informacioni shpërndahet nga një organizatë;
- procedurat operacionale standarde;
- mekanizmat e referimit;
- partneritetet zyrtare me autoritetet;
- marrëveshjet kuadër.



### Praktikat e mira të koordinimit përmes grupeve tematike të punës dhe rrugëve të referimit

Në kontekste komplekse operacionale, dhënia e informacionit mund të koordinohet përmes grupeve tematike të punës. Çdo grup pune do të koordinojë disa organizata të përfshira në aktivitetet e dhënies së informacionit rreth të njëjtës temë. Koordinimi i përditshëm mund të organizohet nëpërmjet pikave ndërlidhëse të caktuara për çdo grup pune.

Në kontekste komplekse, si ngjarjet e zbarkimit, rrugët e referimit luajnë një rol vendimtar për të adresuar siç duhet nevojat për mbrojtje dhe për t'u dhënë aplikuesëve për mbrojtje përgjigje në kohë, veçanërisht për sa i përket shërbimit dhe mbështetjes së specializuar. Për këtë qëllim, ofruesit e informacionit dhe shërbimeve duhet të kontribuojnë për t'i mbajtur rrugët e referimit funksionale dhe lehtësisht të qasshme.

Marrëveshjet praktike të mëposhtme mund të përdoren për të dhënë informacion në vendndodhje të ndryshme, nga një ose shumë organizata:

- ekipet e lëvizshme/shëtitëse që udhëtojnë në vendndodhjet e ndryshme ku mbërrijnë ose banojnë aplikuesit për mbrojtje;
- kabinat e informacionit të instaluar në vendndodhje ku ndodhen një numër i madh aplikuesish për mbrojtje;
- linjat telefonike që i lejojnë aplikuesit për mbrojtje t'ju kontaktojnë në shumë vendndodhje - sigurohuni që të njoftoni gjerësisht numrat e linjave telefonike në vendet e frekuentuara nga aplikuesit për mbrojtje.

Nëse jepet informacion nga shumë organizata, sigurohuni që aplikuesi për mbrojtje të kuptojë rolin e organizatës që u jep informacion atyre. Nëse ofruesi i informacionit nuk është autoriteti përgjegjës për kërkesën e tyre, aplikuesi për mbrojtje duhet të paktën të marrë informacion se si mund të kontaktojë me autoritetin përgjegjës në rast se ka pyetje në lidhje me kërkesën e tij personale.



### 3. Temat e dhënies së informacionit

Ky kapitull ofron një pasqyrë të temave të dhënies së informacionit në kontekstin e qasjes në procedurë.




Temat bazohen në dispozitat ligjore të Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit, të cilat mund të jenë të detyrueshme (“klauzolat e detyrueshme”) ose diskreionale (“klauzolat opsionale”). Rëndësia e temave që lidhen me “klauzolat opsionale” do të varet nga përfshirja e neneve përkatëse në legjislacionin kombëtar dhe nga rrethanat individuale të aplikuesit për mbrojtje.

Udhëzimi i paraqitur në këtë kapitull përfshin gjithashtu edhe pika informacioni plotësuese, në rastet kur ato përmirësojnë ndjeshëm kuptueshmërinë nga aplikuesi për mbrojtje për procesin administrativ.

Tabela 3 ofron një pasqyrë të temave të dhënies së informacionit që konsiderohen si minimumi që duhet t’u jepet aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare gjatë qasjes në procedurë. Vendet BE+ mund ta plotësojnë më tej informacionin me tema që janë të rëndësishme në kontekstin e tyre specifik kombëtar.

Tabela pasqyron fazat e qasjes në procedurën e azilit dhe bën dallimin ndërmjet fazës së kryerjes dhe fazës së regjistrim-depozitimit. Për secilën temë, ajo tregon gjithashtu fazën në të cilën duhet të trajtohet tema dhe nëse dhënia e informacionit duhet të jetë standarde apo e detajuar.

Kodi i mëposhtëm i ngjyrave është aplikuar për temat e informacionit:

-  temat e dhënies së informacionit që do të mbulohen në të gjitha rrethanat;
-  informacioni që do të jepet vetëm nëse është i përshtatshëm në rrethanat personale të aplikuesit për mbrojtje;
-  mesazhet në udhëzim që janë veçanërisht të rëndësishme për kontaktin e parë (kryerjen).



**Tabela 3. Një pasqyrë e temave të dhënies së informacionit që konsiderohen si minimumi për t'ia dhënë aplikuesit për mbrojtje gjatë fazës së qasjes në procedurë**

Temat e informacionit	Kontakti i parë (kryerja)	Regjistrimi/ akomodimi
<u>Konceptet dhe parimet kryesore të procedurës së azilit</u>		
<u>Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare?</u>	standarde	e detajuar
<u>Çfarë është procedura e azilit?</u>	standarde	e detajuar
<u>Konfidencialiteti</u>	standarde	e detajuar
<u>Parimi i interesit më të lartë të fëmijës</u>	standarde	e detajuar
<u>Mekanizmi i ankesave</u>		standarde
<u>Informacioni procedural</u>		
<u>Procedura e regjistrimit</u>	e detajuar	e detajuar
<u>Regjistrimi i personave të rritur në ngarkim</u>	standarde	e detajuar
<u>Regjistrimi i fëmijëve</u>	standarde	e detajuar
<u>Vlerësimi i moshës (kur është relevante)</u>		e detajuar
<u>Intervista personale</u>		standarde
<u>Afatet kohore për shqyrtimin</u>	standarde	standarde
<u>Ndalimi</u>		e detajuar
<u>Hapat e mëtejshëm nëse kërkesa kanalizohet në procedurë të veçantë shqyrtimi</u>		
<u>Procedura e Dublinit</u>	standarde	e detajuar
<u>Kërkesat e mëvonshme</u>		e detajuar
<u>Procedura e pranueshmërisë</u>		e detajuar
<u>Procedura e përsheptuar</u>		e detajuar
<u>Procedura në kufi</u>		e detajuar
<u>Të drejtat e një aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare</u>		
<u>Qëndrimi në vendin që është në pritje të procedurës së shqyrtimit</u>	standarde	e detajuar
<u>E drejta për të pasur përkthyes</u>	standarde	e detajuar



<b>Temat e informacionit</b>	<b>Kontakti i parë (kryerja)</b>	<b>Regjistrimi/ akomodimi</b>
<u>Asistenca dhe përfaqësimi ligjor</u>		e detajuar
<u>E drejta për të komunikuar me UNHCR-në dhe organizata të tjera që ofrojnë konsulencë ligjore</u>	standarde	standarde
<u>E drejta për kushte materiale pritjeje</u>	standarde	e detajuar
<u>Tërheqja e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare</u>	standarde	e detajuar
<u>Të drejtat në lidhje me fëmijët (e pashoqëruar).</u>		
<u>Caktimi i një përfaqësuesi/ kujdestari</u>		e detajuar
<u>Gjurmimi i familjes, anëtarëve të familjes në vende të tjera BE+ dhe bashkimi familjar</u>	standarde	standarde
<u>Të drejtat për azilkërkuesit me nevoja të veçanta</u>		
<u>Mbështetje e përshtatshme për të përfutur nga të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet gjatë procedurës së azilit</u>	standarde	e detajuar
<u>Detyrimet e një aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare</u>		
<u>Bashkëpunimi me autoritetet</u>	standarde	e detajuar
<u>Nënshtrimi ndaj kontrollit personal për arsye sigurie</u>	standarde	
<u>Marrja e të dhënave biometrike</u>	standarde	e detajuar
<u>Komunikimi te autoritetet i adresës së kontaktit dhe ndryshimeve në adresë</u>		e detajuar
<u>Paraqitja e elementeve për të mbështetur kërkesën</u>	standarde	e detajuar
<u>Pasojat e mundshme të mospërmbushjes së detyrimeve</u>		
<u>Kërkesa mund të konsiderohet si e tërhequr ose e braktisur në mënyrë të nënkuptuar</u>	standarde	e detajuar



Temat e informacionit	Kontakti i parë (kryerja)	Regjistrimi/akomodimi
<a href="#">Mund të ketë ndikim te vlerësimi i elementeve të rëndësishëm të kërkesës për azil</a>		e detajuar
<a href="#">Procedura e azilit mund të përshpejtohet</a>		e detajuar
<a href="#">Kushtet materiale të pritjes mund të pakësohen ose edhe të hiqen fare në raste të rralla</a>		e detajuar
<a href="#">Kthimi vullnetar</a>		
<a href="#">Kthimi vullnetar</a>		standarde

Ju mund të klikoni mbi lidhjet në tabelë për t'u ridrejtuar te udhëzimi plotësues që vjen me secilën temë informacioni.

Udhëzimi përmban, për secilën temë:

1. **informacion mbështetës** mbi atë që zyrtari i regjistrimit duhet të dijë në lidhje me temën;
2. **një mesazh për dhënien e informacionit** mbi informacionin që duhet t'i jepet aplikuesit për mbrojtje <sup>(18)</sup>.

Brenda mesazheve të dhënies së informacionit, mesazhet që janë veçanërisht të rëndësishme për **kontaktin e parë (kryerjen)** janë shënuar me hijezim me sfond rozë. Informacioni i mbetur mund të jepet gjatë fazës së regjistrimit ose të akomodimit.

Udhëzimi plotësohet më tej me **këshilla praktike** se si të jepet ky informacion në praktikë: çfarë të theksohet, çfarë duhet pasur kujdes, si të shpjegohet informacioni dhe të siguroheni se është kuptuar, etj.

Mos harroni të përshtatni të gjitha temat e dhënies së informacionit sipas kontekstit tuaj kombëtar, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me legjislacionin tuaj kombëtar dhe praktikën e përcaktuar.

Mos harroni gjithashtu të përshtatni nivelin e detajeve të informacionit të dhënë për çdo hap specifik të procedurës dhe të përshtatni stilin tuaj të komunikimit me rrethanat personale të aplikuesit për mbrojtje.

<sup>(18)</sup> Ky udhëzues praktik nuk synon të japë formulime specifike që duhet t'i përcillen drejtpërdrejt aplikuesit për mbrojtje. Më shumë ai përshkruan mesazhet e dhënies së informacionit. Shembuj konkretë të formulimeve që duhet t'i përcillen drejtpërdrejt aplikuesit për mbrojtje do të jenë të disponueshëm në dosjen e shablloneve në portalin Let's Speak Asylum.



## 3.1 Konceptet dhe parimet kryesore të procedurës së azilit

### 3.1.1 Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare?

#### (a) Informacion mbështetës

Mbrojtja ndërkombëtare zëvendëson mbrojtjen kombëtare. Kur një shtet nuk arrin të mbrojë qytetarët e vet nga përndjekja ose dëmtimi serioz ose kur vetë shteti është aktori i përndjekjes, lind nevoja për mbrojtje ndërkombëtare. Mbrojtja ndërkombëtare përfshin statusin e refugjatit <sup>(19)</sup> dhe mbrojtjen shtesë <sup>(20)</sup>.

Konventa e Gjenevës <sup>(21)</sup> parashikon pesë arsye përndjekjeje në bazë të të cilave njihet statusi i refugjatit: raca, feja, kombësia, anëtarësia në një grup të caktuar shoqëror dhe bindjet politike.

Mbrojtja plotësuese jepet kur aplikuesit për mbrojtje përballen me një rrezik real për dëmtim të rëndë, i cili përfshin dënimin me vdekje ose ekzekutimin, torturën ose trajtimin ose ndëshkimin çnjerëzor ose poshtërues, ose dëmtim të rëndë që rezulton nga dhuna e verbër në situata të konfliktit të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm.

Arsyet e kërkesës për azil mund të jenë shumë delikate ose personale. Ky mund të jetë rasti, për shembull, kur aplikuesi për mbrojtje është viktimë e dhunës në familje, trafikimit të qenieve njerëzore, torturës, përdhunimit ose formave të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale, ose nëse përndjekja lidhet me shprehjen e identitetit gjinor, orientimit seksual, etj. Në raste të tilla, aplikuesit për mbrojtje mund të hezitojnë ta ndajnë informacionin hapur. Është e rëndësishme të jeni vetëdijshëm për këto situata të mundshme dhe ta merrni parasysh këtë kur jepni informacion.

<sup>(19)</sup> Përkufizimi i “refugjatit” është dhënë në nenin 2(d) të DK-së (e riformular): “refugjat” nënkupton një shtetas të një vendi të tretë, i cili si pasojë e frikës së bazuar për përndjekje për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose të vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk është në gjendje ose, i detyruar nga kjo frikë, nuk ka dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, ose një person pa nënshtetësi, i cili, i ndodhur jashtë vendit të vendbanimit të zakonshëm për të njëjtat arsye siç është përmendur më lart, nuk është në gjendje ose, për shkak të frikës, nuk ka dëshirë të kthehet në atë vend dhe për të cilin nuk zbatohet Neni 12.

<sup>(20)</sup> Përkufizimi i “personit që ka të drejtë për mbrojtje plotësuese” është dhënë në nenin 2(f) të DK-së (e riformular): “personi që ka të drejtë për mbrojtje plotësuese” nënkupton shtetasin e një vendi të tretë ose një person pa nënshtetësi që nuk kualifikohet si refugjat, por duke respektuar arsyet e konsiderueshme që ka treguar për të besuar se personi në fjalë, nëse kthehet në vendin e tij ose të saj të origjinës, ose në rastin e një personi pa nënshtetësi, në vendin e tij ose të saj të mëparshëm të banimit, do të përballëj me një rrezik real që të pësojë dëmtim të rëndë siç përkufizohet në Nenin 15, dhe për të cilin Neni 17(1) dhe (2) nuk aplikohen, dhe nuk është në gjendje, ose për shkak të këtij rreziku, nuk është i gatshëm të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi.

<sup>(21)</sup> Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, “[Konventa për statusin e refugjatëve](#)”, *Seria e Traktateve të Kombeve të Bashkuara*, Vol. 189, Gjenevë, 28 korrik 1951, fq. 137; Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, “[Protokolli në lidhje me statusin e refugjatëve](#)”, *Seria e Traktateve të Kombeve të Bashkuara*, Vol. 606, 31 janar 1967, fq. 267 – (referuar në legjislationin e BE-së për azilin dhe nga GjDBE-ja si “Konventa e Gjenevës”).



### Instrumenti i EUAA-së për këtë aspekt

Për udhëzime të mëtejshme në lidhje me kualifikimin për mbrojtje ndërkombëtare, këshillohuni me EASO, *Udhëzues praktik mbi kualifikimin për mbrojtje ndërkombëtare*, prill 2018.

#### (b) Mesazh për dhënie e informacionit

- Gjithkush ka të drejtë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare.
- Nevoja për mbrojtje ndërkombëtare lind kur një person nuk është në gjendje të kthehet në vendin e tij sepse do të ekspozohet ndaj rrezikut të përndjekjes ose dëmtimit të rëndë dhe vendi i tij nuk do ta mbronte. Rreziku i përndjekjes ose dëmtimit të rëndë përfshin kërcënimet ndaj jetës, lirisë ose integritetit fizik.
- Ligji i BE-së njih dy lloje të mbrojtjes ndërkombëtare: statusin e refugjatit ose mbrojtjen plotësuese. Statusi i refugjatit jepet nëse aplikuesi për mbrojtje do të përballlet me përndjekje për arsye të racës, fesë, kombësisë, bindjes politike ose përkatësisë në një grup të caktuar pas kthimit në vendin e tij dhe nëse shteti nuk do ta mbronte. Mbrojtja plotësuese jepet nëse aplikuesi për mbrojtje do të përballej me një rrezik serioz për shkak të një konflikti në vendin e tij ose një formë tjetër dëmtimi të rëndë dhe nëse shteti nuk do ta mbronte.
- Pas depozitimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, administrata së pari do të kontrollojë nëse mund të jepet statusi i refugjatit dhe, nëse jo, nëse mund të jepet mbrojtja plotësuese.
- Nëse është e nevojshme, jepni informacion mbi format e tjera të mbrojtjes të aplikuar nga administrata juaj kombëtare.



#### Këshillë praktike mbi shpjegimin e terminologjisë përkatëse për aplikuesin për mbrojtje

Aplikuesi për mbrojtje mund ta njohin termin “azil” ose “mbrojtje e refugjatëve”, por jo “mbrojtje ndërkombëtare”. Kur i referohemi mbrojtjes ndërkombëtare, është e këshillueshme që të shpjegohet se mbrojtja ndërkombëtare është e njëjtë me “azilin”. Shpjegoni gjithashtu se, ligjërisht, mbrojtja ndërkombëtare mund të nënkuptojë ose statusin e refugjatit ose mbrojtje plotësuese sipas Direktivës 2011/95/BE. Pasi të jepet shpjegimi, është e rëndësishme të qëndroni konsistent në zgjedhjen e fjalëve.

## 3.1.2 Çfarë është procedura e azilit?

### (a) Informacion mbështetës

Një nga themelet e procedurës së azilit është parimi i **moskthimit**. Është një nga të drejtat kryesore themelore dhe i referohet detyrimit të shteteve që të shmangin dëbimin ose kthimin e një personi në çfarëdo mënyre në një situatë ku ai mund të përballet me përndjekje dhe/ose torturë, trajtim çnjerëzor ose poshtërues ose ndëshkim.

Për të garantuar respektimin e parimit të moskthimit dhe që e drejta për azil të jetë efektive, çdo personi që mund të ketë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare duhet t'i sigurohet **qasje** në procedurën e azilit. Si të tillë, zyrtarët kombëtarë kanë për detyrë të japin informacion në lidhje me mundësinë e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare në pikat e kufirit të jashtëm ose në ndalim sa herë që ka indikacione se personat mund të dëshirojnë ta bëjnë këtë. Indikacionet mund të rrjedhin nga një synim i shprehur për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare ose këto indikacione mund të jenë më indirekte, për shembull një shprehje ankthi ose nga fakti që aplikuesi për mbrojtje i përket një grupi të caktuar pakice në vendin e tij të origjinës. Këta tregues të fundit mund të identifikohen nëpërmjet një qëndrimi proaktiv nga zyrtarët e kontaktit të parë<sup>(22)</sup>.


Qasja në procedurat e azilit përfshin tri faza të ndryshme: kryerjen e kërkesës, regjistrimin e kryerjes dhe depozitimin. Kryerja e një kërkesë do të thotë veprimi i shprehjes, në çdo mënyrë dhe te çdo autoritet, të dëshirës së dikujt që të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare. Regjistrimi i kryerjes konsiston në regjistrimin e qëllimit të aplikuesit për mbrojtje për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare. Së fundmi, depozitimi i një kërkesë do të thotë që aplikuesi për mbrojtje të japë informacion/dokumente për të plotësuar dosjen e krijuar në momentin e regjistrimit të kërkesës. Depozitimi i kërkesës aktivizon fillimin e shqyrtimit të shkallës së parë. Këto tri hapa proceduralë mund të kryhen njëkohësisht ose veçmas, në varësi të strukturës kombëtare ose vendndodhjes ku kryhet kërkesa. Shkrirja e këtyre hapave është një praktikë mjaft e zakonshme në operacionet që krijohen për t'iu përgjigjur mbërritjeve masive të azilkërkuesve, për shembull, gjatë zbarkimeve ose në zona tranziti.

Në thelb të procedurës së azilit është **intervista personale**, gjatë së cilës aplikuesi për mbrojtje mund të shpjegojë pse nuk mund të kthehet në vendin e tij, edhe kur nuk mund të japë prova dokumentare të përndjekjes nga e cila frikësohet ose dëmtimit të rëndë. Pas intervistës personale, kërkesa vlerësohet. **Vendimi** mbi kërkesën duhet të jetë me shkrim dhe duhet të tregojë arsyet e vendimit në fakt dhe në ligj. Në rast të një vendimi negativ, aplikuesi për mbrojtje ka të drejtën e një **zgjidhjeje efektive** para një gjykate ose tribunali (apeli) dhe të drejtën për të marrë këshillim juridik falas. Në disa vende, ndihma juridike falas mund të ofrohet tashmë gjatë procedurës së shkallës së parë në kushte të caktuara. Ju lutemi referojuni praktikës suaj kombëtare për udhëzime të mëtejshme.

<sup>(22)</sup> EASO-Frontex, *Udhëzues praktik mbi qasjen në procedurën e azilit*, Seksioni "Indikacionet që dikush mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare", 2016, fq. 12–13.



Figura 2. Infografikë e procedurës së azilit



### (b) Mesazhet për dhënie e informacionit

- Procedura e azilit është një proces që përcakton nëse një aplikues për mbrojtje do t'i jepet mbrojtje ndërkombëtare apo jo.
- Procedura e azilit është falas.
- Procedura e azilit përfshin disa hapa. Sapo aplikuesi për mbrojtje shpreh dëshirën për të bërë kërkesë për azil, nuk ka rrezik që aplikuesi për mbrojtje të kthehet në vendin e origjinës ose në një vend të tretë, përpara përfundimit të shqyrtimit.
- Kërkesa fillimisht duhet të regjistrohet dhe të depozitohet (shih për detaje të mëtejshme temën "[Procedura e regjistrimit](#)".)
- Autoritetet do të vlerësojnë nëse asnjë vend tjetër BE+ nuk është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës në përputhje me rregulloren e Dublinin (shih për detaje të mëtejshme temën "[Procedura e Dublinin](#)".)
- Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, aplikuesi për mbrojtje do të ftohet në një intervistë personale, ku ai mund të shpjegojë pse u largua nga vendi i vet.
- Autoriteti më pas do të vlerësojë të gjithë informacionin e disponueshëm dhe do të vendosë nëse aplikuesit për mbrojtje do t'i jepet mbrojtje ndërkombëtare apo jo.



### **Këshillë praktike për prezantimin e informacionit gradualisht, duke filluar me një përmbledhje të procedurës**

Në fazën e hershme të procedurës së azilit, aplikuesit për mbrojtje duhet t'i jepet vetëm një pasqyrë bazë e procedurës së azilit në mënyrë që të jetë i vetëdijshëm se çfarë hapash përfshin ajo. Aplikuesi për mbrojtje nuk duhet të mbingarkohet me informacion të detajuar gjatë kontaktit të parë. Informacion më i detajuar do të jepet në çdo fazë të procedurës së azilit. Për shembull, ju mund të përshtatni informacionin mbi hapat proceduralë dhe të shpjegoni se në cilin hap është aplikuesi për mbrojtje aktualisht, cilët hapa janë kryer dhe çfarë vjen më pas. Mos harroni të përshtatni informacionin për nevojat e aplikuesit për mbrojtje.

Këshillohet që ofrimi i informacionit të mbështetet me një ndihmë vizuale që shpjegon procedurën e azilit.

## **3.1.3 Konfidencialiteti**

### **(a) Informacion mbështetës**

Parimi i konfidencialitetit qëndron në themel të të gjithë procedurës së azilit. Është e rëndësishme që aplikuesi për mbrojtje të kuptojë se fshehtësia garantohet nga autoritetet: informacioni i dhënë nga aplikuesi për mbrojtje nuk i zbulohet asnjë pale përtej autoriteteve kompetente pa lejen e aplikuesit për mbrojtje <sup>(23)</sup>. Në praktikë kjo do të thotë që të dhënat e dhëna nga aplikuesi për mbrojtje nuk ndahen me askënd që nuk ka të drejtë të ketë qasje tek ato, se sistemi i menaxhimit të çështjeve drejtohet nga rregullat e duhura të mbrojtjes së të dhënave dhe se mjediset ku aplikuesi për mbrojtje dëgjohet sigurojnë privatësi të përshtatshme.

### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Autoritetet i trajtojnë të gjitha të dhënat e dhëna nga aplikuesi për mbrojtje me konfidencialitetin maksimal. Kjo do të thotë që të dhënat nuk ndahen jashtë autoritetit pa pëlqimin e azilkërkuarit.
- Të dhënat e dhëna nga aplikuesi për mbrojtje në asnjë rrethanë nuk ndahen me autoritetet në vendin e origjinës.
- Të dhënat e ofruara nga aplikuesi për mbrojtje mund të ndahen me autoritetet e tjera në rrethana të caktuara të rregulluara nga legjislacioni juaj kombëtar. Shpjegojini aplikuesit për mbrojtje se çfarë ndahet, me kë dhe pse, në përputhje me praktikën tuaj kombëtare.
- Parimi i konfidencialitetit vlen edhe për mënyrën se si menaxhohen dhe ruhen të dhënat.
- Të dhënat mund të ndahen me përfaqësuesin ligjor të aplikuesit për mbrojtje, nëse është e aplikueshme.

<sup>(23)</sup> Neni 48 i DPA-së (e riformular): "Shtetet Anëtare do të garantojnë që autoritetet të cilat zbatojnë këtë Direktivë kanë detyrimin e konfidencialitetit sipas përcaktimeve në legjislacionin e brendshëm, sa u takon informacioneve që ato marrin gjatë punës së tyre."



- Nëse është e nevojshme, mund të ndahen gjithashtu të dhëna të caktuara me shërbime të caktuara <sup>(24)</sup> që ofrojnë ndihmë për aplikuesin për mbrojtje, por vetëm nëse aplikuesi për mbrojtje jep pëlqimin e tij që këto të dhëna të ndahen.
- Nëse aplikuesi për mbrojtje ka bërë kërkesë për azil së bashku me anëtarët e familjes së tij, vendet duhet ta informojnë aplikuesin për mbrojtje për praktikën e tyre për të përdorur informacionin në kërkesat e anëtarëve të familjes sipas praktikës së tyre kombëtare. Kjo ka të bëjë me të gjithë anëtarët e familjes, duke përfshirë fëmijët e shoqëruar. Në përgjithësi, shqyrtimi do të marrë parasysh të gjitha arsyet për kërkesë për azil të deklaruar nga aplikuesi për mbrojtje dhe anëtarët e familjes së tij. Prandaj, aplikuesi për mbrojtje duhet t'u tregojë autoriteteve të azilit nëse ka arsye të forta për të mos i ndarë arsyet e kërkesës për azil me anëtarët e familjes së vet.



### Këshillë praktike për t'i ilustruar aplikuesit për mbrojtje se çfarë do të thotë konfidencialitet në praktikë

Për shembull, nëse ka një kamerë në dhomë, shpjegoni aplikuesit për mbrojtje se kamera është në dhomë vetëm për arsye sigurie dhe se personeli i sigurisë mund të shohë vetëm përmes kamerës, por nuk mund të dëgjojnë asgjë që thuhet. Ju gjithashtu mund të shpjegoni se transkripti (ose regjistrimi, nëse është i përshtatshëm) i intervistës po bëhet për qëllimin e vendimmarrjes. Në mënyrë të ngjashme, konfidencialiteti sigurohet nga organizime specifike gjatë intervistës, siç janë dhomat e ndara të intervistave.

## 3.1.4 Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

### (a) Informacion mbështetës

Nëse aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare është fëmijë, konsiderohet parësor interesi i tij më i lartë <sup>(25)</sup>. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës nënkupton që, në çdo hap të procedurës së azilit, duhet të merren parasysh rrethanat specifike të secilit fëmijë. Këto përfshijnë mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijës, mirëqenien dhe zhvillimin social, identitetin dhe prejardhjen, situatën familjare dhe unitetin familjar, si dhe pikëpamjet e fëmijës sipas moshës dhe pjekurisë së tij. Duhet të ekzistojnë mbrojtje dhe garanci specifike procedurale për të siguruar zbatimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Kjo do të thotë që një fëmijë aplikues për mbrojtje duhet të marrë informacion specifik në lidhje me garancitë e veçanta që jepen në zbatim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës.



### Instrumenti i EUAA-së për këtë aspekt

Për më shumë informacion shih EASO, *Udhëzues praktik për interesin më të lartë të fëmijës në procedurat e azilit*, 2019.

<sup>(24)</sup> Për shembull, neni 29(1)(b) i DPA-së (e riformuluar) nënkupton që Shtetet Anëtare do t'i lejojnë UNHCR-së "të ketë qasje në informacione mbi kërkesat individuale për mbrojtje ndërkombëtare, mbi rrjedhën e procedurës dhe mbi vendimet e marra, me kusht që aplikuesi për mbrojtje të jetë dakord me këtë".

<sup>(25)</sup> Neni 25(6) i DPA-së (e riformuluar).





## (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Informojini aplikuesin për mbrojtje se, në Evropë, çdo person nën moshën 18 vjeç konsiderohet fëmijë dhe kështu ka të drejtë për disa mbrojtje dhe garanci. Nëse aplikuesi për mbrojtje është nën moshën 18 vjeç, ose nuk është i sigurt nëse është më i madh, ai duhet të informojë zyrtarët në mënyrë që të marrë mbështetjen e duhur.
- Çdo person i pashoqëruar duhet të informojë autoritetet nëse është më i vogël se 18 vjeç (ose nëse nuk është i sigurt nëse është). Të miturit e pashoqëruar kanë të drejtë për mbrojtje dhe ndihmë të veçantë. Për detaje të mëtejshme shih temën "[Të drejtat në lidhje me fëmijët \(e pashoqëruar\)](#)".
- Interesi më i lartë dhe mirëqenia e fëmijës janë konsideratat kryesore gjatë të gjitha hapave të procedurës së azilit për të garantuar sigurinë, mirëqenien, zhvillimin social, etj.
- Fëmija ka të drejtë të shprehë pikëpamjet dhe opinionet e tij (shqetësimet, frikën, dëshirat). Këto do të merren parasysh nëse u përshtaten interesave dhe mirëqenies së tyre.
- Kur merren parasysh pikëpamjet dhe opinionet e fëmijës, do të merret parasysh moshja dhe pjekuria e tyre.
- Shpjegoni se si fëmija mund të ndajë pikëpamjet dhe opinionet me administratën e azilit, qoftë nëpërmjet prindërve ose kujdestarit të tij ose drejtpërdrejt, sipas praktikës suaj kombëtare.

## 3.1.5 Mekanizmi i ankesave

### (a) Informacion mbështetës

Mekanizmat e ankesave sigurojnë që të respektohen të drejtat themelore të aplikuesëve për mbrojtje. Aplikuesi për mbrojtje mund të paraqesë një ankesë nëse ato preken negativisht nga veprimet e administratave të BE-së ose kombëtare ose të një personi që përfaqëson administratën. Kështu ndodh veçanërisht kur një institucion nuk vepron në përputhje me ligjin ose parimet e administrimit të mirë ose cenon të drejtat e tij themelore. Në varësi të karakterit të shkeljes dhe administratës në fjalë, aplikuesi për mbrojtje mund të paraqesë një ankesë, për shembull, para një ombudsmani rajonal ose kombëtar <sup>(26)</sup>. Në rast se administrata kombëtare mbështetet nga një agjenci e BE-së, siç është EUAA <sup>(27)</sup> ose Frontex <sup>(28)</sup>, dhe sjellja e gabuar ka të bëjë me ekipet mbështetëse të dërguara nga këto agjenci, parashikohen mekanizma specifikë ankesash. Për më shumë informacion në lidhje me mekanizmin tuaj kombëtar të ankesave, ndiqni ligjin dhe praktikën tuaj kombëtare.

<sup>(26)</sup> Ombudsmani Evropian, [Anëtarët e Rrjetit Evropian të Ombudsmanëve](#).

<sup>(27)</sup> Neni 51 i rregullores së themelimit të EUAA-së: [Rregullorja \(BE\) 2021/2303](#) e Parlamentit Evropian dhe i Këshillit të datës 15 dhjetor 2021 mbi Agjencinë e Bashkimit Evropian për Azilin dhe shfuqizimin e Rregullores (BE) Nr. 439/2010 (OJ L 468, 30.12.2021).

<sup>(28)</sup> Frontex, "[Mekanizmi i ankimeve](#)".





## (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Aplikuesit për mbrojtje mund të ngrenë një ankesë në situata të ndryshme, për shembull, nëse:
  - janë shkelur të drejtat e tyre themelore;
  - një autoritet shtetëror i trajton ata në mënyrë të papërshtatshme ose joetike.
- Si të dorëzohet ankesa, kujt dhe në cilin format dhe gjuhë, duke përfshirë adresat ose lidhjet përkatëse.
- Paraqitja e ankesës është pa pagesë.
- Çfarë informacioni duhet të jepet në ankesë (për shembull emri, të dhënat e kontaktit, numri i dosjes së lëndës). Nuk është e mundur të ndiqen ankesat anonime.
- Sigurojeni aplikuesin për mbrojtje se paraqitja e një ankese nuk do të ndikojë negativisht në rezultatin e kërkesës së tyre.
- Ankesa nuk është apelim kundër vendimit në kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare. Një ankesë mund të ngrihet përpara se të merret një vendim për kërkesën për azil.
- Nëse është e aplikueshme, jepni informacion në lidhje me afatet.



### Këshilla praktike

- **Sigurojeni aplikuesin për mbrojtje se nuk ka rrezik që të bëni ankesa jo-anonime**

Aplikuesit për mbrojtje mund të hezitojnë të japin të dhëna personale dhe të kontaktit në ankesë. Ju mund të shpjegoni se informacioni është i nevojshëm për t'i informuar ata për rezultatet, në rast se nevojiten informacione shtesë, etj.

- **Shpjegoni ndryshimin midis një ankese dhe një apelimi**

Për të shmangur çdo ngatërrësë, është e dobishme të shpjegohet se procedurat e ankimit janë të ndryshme nga procedurat e apelimit. Procedura e ankimit nuk duhet të përdoret për të kërkuar rishikimin e vendimit.



## 3.2 Procedurat që duhen ndjekur

### 3.2.1 Procedura e regjistrimit

#### (a) Informacion mbështetës

Pasi një aplikues për mbrojtje ka shprehur qëllimin për të bërë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, kërkesa regjistrohet. Regjistrimi përgatit bazat për shqyrtimin e kërkesës dhe garanton që kërkesat vërtet të kanalizohen në mënyrë efikase në procedurën e duhur të shqyrtimit.

DPA-ja (e riformular) specifikon tre hapa të qasjes në procedurë <sup>(29)</sup>: kryerja, regjistrimi i kryerjes dhe depozitimi (për më shumë detaje shih [Seksioni 2.1.1 “Identifikoni mundësitë për të dhënë informacion”](#)).

Në varësi të organizimit të strukturave në vend, regjistrimi dhe paraqitja e kërkesës mund të kryhen në të njëjtën kohë ose veçmas nga autoritetet e ndryshme.

Regjistrimi i plotë (kryerja, regjistrimi i kryerjes dhe depozitimi) konsiderohet i plotë kur të kenë përfunduar hapat e mëposhtëm.

- Të dhënat e aplikuesit për mbrojtje janë regjistruar në databazat kombëtare.
- Formulari ose raporti zyrtar i depozituar nga aplikuesi për mbrojtje merret nga autoritetet kombëtare.

Janë marrë të dhënat biometrike. Menjëherë merren gjurmët e gishtave të çdo aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare të paktën nga moshja 14 vjeç dhe ato duhet të transmetohen në sistemin qendror të Eurodac <sup>(30)</sup> sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 72 orë pas paraqitjes së kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

Mund të bëhet gjithashtu një kontroll sigurie.

Gjithashtu, brenda 3 ditëve nga depozitimi, aplikuesit për mbrojtje duhet të marrin një **dokument që vërteton statusin e tyre si azilkërkuar** <sup>(31)</sup>. Ky dokument dëshmon se personi lejohet të qëndrojë ligjërisht në territorin e shtetit ndërkohë që kërkesa e tij është duke u shqyrtuar.

<sup>(29)</sup> Neni 6 i DPA-së (e riformular).

<sup>(30)</sup> [Rregullorja \(BE\) nr. 603/2013](#) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2013 “Për themelimin e Eurodac për krahasimin e gjurmëve të gishtave me synimin e zbatimit të efektshëm të Rregullores (BE) 604/2013 e cila përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur në një Shtet Anëtar nga një shtetas i një vendi të tretë ose nga një person pa shtetësi dhe për kërkesat për krahasim me të dhënat e Eurodac të paraqitura nga autoritetet ligjzbatuese të Shteteve Anëtare dhe Europol për qëllime të zbatimit të ligjit dhe për të ndryshuar Rregulloren (BE) 1077/2011 e cila krijon një agjenci evropiane për menaxhimin operacional në shkallë të gjerë të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie (e riformular)”, Fletorja Zyrtare nr. 180, 29.6.2013).

<sup>(31)</sup> Neni 6(1) i DKP-së (e riformular): “Shtetet Anëtare do të sigurojnë që, brenda tri ditëve nga depozitimi i një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, aplikuesit për mbrojtje t’i jepet një dokument i lëshuar në emrin e tij ose të saj që vërteton statusin e tij ose të saj si aplikuesi për mbrojtje ose që dëshmon se ai ose ajo lejohet të qëndrojë në territorin e Shtetit Anëtar ndërkohë që kërkesa e tij/saj është në pritje ose në shqyrtim. Nëse mbajtësi nuk është i lirë të lëvizë brenda të gjithë ose një pjese të territorit të Shtetit Anëtar, dokumenti gjithashtu duhet ta vërtetojë këtë fakt.”



## (b) Mesazh për dhënie e informacionit

- Pasi një person shpreh dëshirën për të bërë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, ju duhet të jepni informacion praktik se si mund të regjistrohet kërkesa, duke përfshirë sa vijon.
  - Vendi ku do të zhvillohet procesi i regjistrimit dhe si mund të arrijë aplikues për mbrojtje atje.
  - Ora e takimit dhe orari i hapjes së zyrës kompetente.
  - Çfarë mund të pritët nga procesi i regjistrimit (dorëzimi i një formulari, intervistë e shkurtër, etj.)
  - Cilat dokumente duhet të sjellë dhe kush duhet ta shoqërojë aplikuesin për mbrojtje nëse ka anëtarë të familjes ose persona në ngarkim.
  - Do të merren të dhënat biometrike (shih për detaje të mëtejshme detyrimin e aplikuesit për mbrojtje “[Marrja e të dhënave biometrike](#)”).
  - Mund të kryhen kontrolle sigurie (shih për detaje të mëtejshme detyrimin e aplikuesit për mbrojtje “[Nënshtrimi ndaj kontrollit personal për arsye sigurie](#)”).
  - Mund të kryhen kontrolle mjekësore.
  
- Aplikuesi për mbrojtje do të marrë dokumentacionin që vërteton statusin e tij si azilkërkues. Ky është një dokument personal. Nuk mund të ndahet apo t’i jepet dikujt tjetër. Jepni informacion të mëtejshëm në përputhje me praktikën tuaj kombëtare, për shembull:
  - si do të dorëzohet dokumenti;
  - kohëzgjatjen e vlefshmërisë së certifikatës dhe procedurën për rinovimin e saj;
  - pasojat e mosrinovimit të certifikatës nga aplikuesi për mbrojtje;
  - cilat hapa duhet të ndjekë aplikuesi për mbrojtje nëse certifikata dëmtohet ose humbet;
  - detyrimin, në varësi të legjislacionit kombëtar, për të mbajtur dokumentin me vete gjatë gjithë kohës;
  - aplikuesi për mbrojtje duhet të kontrollojë nëse të dhënat personale në dokument janë të sakta;
  - si të informohen autoritetet nëse të dhënat në dokument nuk janë të sakta.

### Informacion shtesë në rast se regjistrimi dhe depozitimi i kërkesës bëhen veçmas

- Nëse fazat e regjistrimit dhe depozitimit ndodhin në kohë të ndryshme dhe/ose në vende të ndryshme, aplikuesi për mbrojtje duhet të kuptojë se procesi nuk do të përfundojë pas regjistrimit. Duhet të jepet informacion i qartë për t’u siguruar që aplikuesi për mbrojtje në fakt mund ta depozitojë kërkesën sa më shpejt të jetë e mundur.



- Jepni informacion praktik në lidhje me takimin për depozitimin e kërkesës, duke përfshirë se ku dhe kur duhet të depozitohet kërkesa. Kjo mund të plotësohet me informacione nëse është e mundur të ndryshoni takimin dhe si ta bëni këtë.



### Këshilla praktike

- **Bëni pyetje testuese për t'u siguruar që aplikuesit për mbrojtje e ka kuptuar mesazhin**

Për shembull, mund t'i kërkonti aplikuesit për mbrojtje të përsërisë se ku dhe kur duhet të paraqitet për regjistrimin dhe/ose depozitimin e kërkesës.

- **Mblidhni të gjitha informacionet përkatëse të kontaktit të aplikuesit për mbrojtje**

Informacioni i kontaktit i aplikuesit për mbrojtje (p.sh. adresa e akomodimit dhe numri i telefonit) mund të përdoren për të kontaktuar me aplikuesin për mbrojtje kur është e nevojshme, për të përfunduar hapin tjetër të procedurës në kohën e duhur.

- **Kërkoni që të dalin përpara personat nën 18 vjeç kur jepni informacion për një grup të madh aplikuesish për mbrojtje pas mbërritjes**

Gjatë sesioneve të dhënies së informacionit në grup, këshillohet të përcaktohet se çdo person më i vogël se 18 vjeç konsiderohet se është fëmijë. Për këtë arsye, personat nën 18 vjeç pa praninë e prindërve ose kujdestarit duhet të informojnë autoritetet për t'u siguruar që të marrin mbështetjen e duhur.

## 3.2.2 Regjistrimi i personave të rritur në ngarkim

### (a) Informacion mbështetës

Çdo aplikues për mbrojtje ka të drejtë të bëjë një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në emër të vet.

Nëse një kërkesë bëhet përmes të afërmit të aplikuesit për mbrojtje në emër të tij, i rrituri në ngarkim duhet të informohet privatisht për të drejtën e tij për të bërë një kërkesë të veçantë. Kjo është për të siguruar që çdo i rritur (i varur) të ketë një mundësi efektive për të bërë një kërkesë të veçantë për mbrojtje ndërkombëtare.

Nëse kërkesa bëhet nëpërmjet të afërmit të aplikuesit për mbrojtje, personi madhor në ngarkim duhet të informohet privatisht për pasojat procedurale të mosparaqitjes së një kërkesë vetë. Këto pasoja mund të përfshijnë nxjerrjen e një vendimi të vetëm. Duhet të kërkohet dhënia e pëlqimit të të rriturit në ngarkim në momentin e paraqitjes së kërkesës ose, më së voni, kur kryhet intervista personale me të rriturin në ngarkim<sup>(32)</sup>.

<sup>(32)</sup> Neni 7(2) i DPA-së (e riformuluar): "Kërkesat e bëra në emër të personave në ngarkim ose të të miturve".





## (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Ndërsa mund të jetë e mundur (në varësi të legjislacionit kombëtar) që një aplikues për mbrojtje të depozitojë një kërkesë në emër të të rriturve në ngarkim, çdo aplikues për mbrojtje i rritur mund të aplikojë gjithmonë për mbrojtje ndërkombëtare në emër të tij.
- Nuk është detyrim për të depozituar një kërkesë të vetme për të gjithë familjen. Të rriturit në ngarkim kanë të drejtë të depozitojnë një kërkesë të veçantë për mbrojtje ndërkombëtare.
- Informoni aplikuesin për mbrojtje se si të depozitojë një kërkesë të veçantë.
- Nëse një aplikues për mbrojtje aplikon në emër të të rriturve në ngarkim, të rriturit në ngarkim duhet të japin pëlqimin për depozitimin e kërkesës në emër të tyre. Duhet të jepet informacion se si të jepet pëlqimi.
- Pavarësisht nëse një aplikues për mbrojtje po bën kërkesë vetë apo dikush po bën kërkesë në emër të tij, aplikuesi për mbrojtje do t'i jepet mundësia për një intervistë personale. Kjo normalisht duhet të bëhet pa praninë e anëtarëve të familjes në mënyrë që të sigurohet konfidencialiteti.
- Nëse kërkesa depozitohet në emër të të rriturve në ngarkim, normalisht do të jepet një vendim që merr në konsideratë pse anëtarët e familjes kanë frikë të kthehen në vendin e tyre.
- Shqyrtimi do të marrë parasysh të gjitha arsyet për kërkesë për azil të deklaruar nga aplikuesi për mbrojtje dhe anëtarët e familjes së tij. Aplikuesi për mbrojtje duhet t'u tregojë autoriteteve të azilit nëse ka arsye të forta për të mos i ndarë arsyet e kërkesës për azil me anëtarët e familjes së tij.



### **Këshilla praktike për dhënien e informacionit për aplikuesit për mbrojtje në ngarkim individualisht**

- Bëni organizimet e duhura në mënyrë që të jeni në gjendje t'i jepni informacion aplikuesit për mbrojtje në ngarkim individualisht dhe në një vend që garanton privatësi të mjaftueshme.
- Kushtojini vëmendje të veçantë identifikimit aktiv të aplikuesëve për mbrojtje për të cilët ky informacion është i rëndësishëm, siç janë gratë dhe të moshuarit. Në raste të tilla, sigurohuni që aplikuesi për mbrojtje (i perceptuar) i varur të ketë një mundësi për të marrë një vendim të pavarur pa ndërhyrë apo pa folur askush në emër të tij.



### 3.2.3 Regjistrimi i fëmijëve

#### (a) Informacion mbështetës

Nëse aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare është fëmijë, kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare mund të depozitohet në të paktën në një nga mënyrat e mëposhtme:

- në emër të tij (nëse ka zotësi juridike);
- nëpërmjet prindërve të tij;
- nëpërmjet një anëtari të rritur të familjes ose një të rrituri përgjegjës për të, nëse kjo është në përputhje me ligjin ose praktikën kombëtare;
- nëpërmjet një kujdestari ligjor.

Ligji kombëtar do të specifikojë më tej kushtet për depozitimin e një kërkesë në secilën nga mënyrat e listuara më sipër. Në të njëjtën kohë, duhet të merret parasysh interesi më lartë i fëmijës kur shqyrtohet mundësia e kryerjes së kërkesës në emër të tij ose nëpërmjet prindërve <sup>(33)</sup>.

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

##### Për fëmijët e shoqëruar

- Fëmijët mund të bëjnë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare nëpërmjet prindërve të tyre, një anëtari të rritur të familjes, një të rrituri përgjegjës për ta ose në emër të vet, nëse fëmija ka zotësinë ligjore për ta bërë këtë. Shpjegoni çdo kusht të mëtejshëm siç përcaktohet në legjislacionin kombëtar.

##### Për fëmijët e pashoqëruar

- Nëse një person nën 18 vjeç ka ardhur vetëm, pa prind ose një të rritur tjetër përgjegjës, ata konsiderohen fëmijë të pashoqëruar.
- Kërkesa mund të depozitohet në emër të tij nëse fëmija ka zotësinë ligjore për ta bërë këtë ose nëpërmjet një kujdestari ligjor. Për detaje të mëtejshme mbi temën shih "[Caktimi i një përfaqësuesi/kujdestari](#)".

### 3.2.4 Vlerësim i moshës

#### (a) Informacion mbështetës

Nëse, pas shqyrtimit të informacionit të disponueshëm, ka dyshime të konsiderueshme për moshën e një fëmije të pashoqëruar, autoritetet mund të kryejnë një vlerësim të moshës për të përcaktuar nëse personi është i rritur apo fëmijë. Vlerësimi i moshës mund të përfshijë metoda të ndryshme shqyrtimi. Duhet të përdoret gjithmonë metoda më pak intruzive. Nëse metodat më pak intruzive nuk janë në mënyrë të arsyeshme indikative, vlerësimi i moshës mund të

<sup>(33)</sup> Neni 7 i DPA-së (e riformular) "Kërkesat e bëra në emër të personave në ngarkim ose të të miturve".



përfshijë një kontroll mjekësor. Në këtë rast, aplikuesi për mbrojtje dhe/ose kujdestari i tij duhet të japin pëlqimin për kontrollin <sup>(34)</sup>.



### Instrumenti i EUAA-së për këtë aspekt

Për më shumë informacion shih EASO, *Udhëzuesi praktik për vlerësimin e moshës*, botimi i dytë, 2018.

#### (b) Mesazh për dhënie e informacionit

- Aplikuesit për mbrojtje mund t'i kërkohet t'i nënshtrohet një vlerësimi të moshës për të përcaktuar moshën e tij, nëse ka dyshime për këtë.
- Vlerësimi i moshës nuk përcakton nëse një kërkesë duhet të pranohet apo të refuzohet; ajo ndihmon për të përcaktuar se cilat garanci duhet të japë një administratë.
- Vlerësimi i moshës kryhet nga profesionistë të kualifikuar në respekt të dinjitetit të aplikuesit për mbrojtje. Procedura nuk shkakton dëm apo dhimbje.

Nëse është relevante, përfshini sa vijon.

- Jepni informacion të mëtejshëm në lidhje me metodën e ekzaminimit dhe procedurën.
- Jepni informacion praktik në lidhje me takimin (adresën, orën).
- Për vlerësimin e moshës që përfshin ekzaminimin mjekësor, informoni aplikuesin për mbrojtje dhe/ose kujdestarin për kërkesën për të dhënë pëlqimin për ekzaminimin dhe pasojat e mundshme të një refuzimi, i cili në çdo rast nuk do të çojë vetvetiu në një vendim refuzimi.
- Shpjegoni pasojat e mundshme që mund të ndodhin nëse aplikuesi për mbrojtje konsiderohet i rritur si rezultat i procedurës së vlerësimit të moshës. Garancitë për fëmijët e pashoqëruar do të hiqen dhe mund të zbatohet një procedurë e veçantë. Shih seksionin 3.2.8 "Hapat e ardhshëm nëse kërkesa kanalizohet një procedurë të veçantë shqyrtimi".

### 3.2.5 Intervista personale

Intervista personale është hapi procedural i radhës pas përfundimit të regjistrimit të kërkesës. Gjatë intervistës personale, aplikuesit për mbrojtje i jepet mundësia të paraqesë të gjithë elementët e nevojshëm për të mbështetur kërkesën e tij <sup>(35)</sup>. Aplikuesi për mbrojtje mund të shprehë kërkesa specifike në lidhje me intervistën, duke përfshirë dëshirën për t'u intervistuar nga një zyrtar i çështjes dhe/ose një përkthyes i të njëjtës gjini, dhe për disa palë të treta

<sup>(34)</sup> Neni 25(5) i DPA-së (e riformuluar) "Garancitë për të miturit e pashoqëruar".

<sup>(35)</sup> Neni 4(2) i DK-së (e riformuluar): "Elementët ... lidhen me deklaratimet e aplikuesit për mbrojtje dhe me të gjithë dokumentacionin në dispozicion të aplikuesit për mbrojtje për moshën, origjinën duke përfshirë atë të të afërmeve, identitetin, shtetësinë(të), vendin(et) dhe vendbanimin(et) e mëparshëm, kërkesat e mëparshme për azil, rrugët e udhëtimit, dokumentet e udhëtimit dhe arsyet e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare."



(avokatët, punonjësit socialë, mjekët, kujdestari, një person mbështetës i besuar, etj.) për të marrë pjesë në intervistën personale, sipas kushteve të përcaktuara në praktikën tuaj kombëtare.

Në rrethana të jashtëzakonshme, autoritetet kombëtare mund të vendosin të mos kryejnë një intervistë personale. Kjo mund të ndodhë kur informacioni i disponueshëm konsiderohet i mjaftueshëm për autoritetin për t'i dhënë statusin e refugjatit aplikuesit për mbrojtje. Mund të ndodhë gjithashtu kur autoriteti mendon se aplikuesi për mbrojtje nuk mund të marrë pjesë në intervistë për arsye të vërtetuara mjekësore <sup>(36)</sup>. Nëse keni dyshime, duhet të konsultoheni me një mjek për të përcaktuar nëse aplikuesi për mbrojtje pritet të shërohet ose nëse problemi mjekësor është i një natyre të qëndrueshme.

#### (a) Mesazh për dhënien e informacionit

- Pas përfundimit të procedurave të regjistrimit, aplikuesi për mbrojtje do të marrë një ftesë për intervistë personale. Duhet të specifikohet se si aplikuesi për mbrojtje do të informohet në përputhje me praktikën kombëtare.
- Nëse intervista nuk bëhet, aplikuesëve për mbrojtje duhet t'u jepet informacion në lidhje me arsyet për mos kryerjen.
- Intervista do të jetë në gjuhën e preferuar nga aplikuesi për mbrojtje, ose ndryshe në një gjuhë që aplikuesi për mbrojtje mund ta kuptojë dhe në të cilën ai është në gjendje të komunikojë qartë. Një përkthyes do të jetë në dispozicion gjatë intervistës.
- Intervista personale është mundësia që aplikuesi për mbrojtje t'i tregojë autoritetit me detaje arsyet pse u largua nga vendi i origjinës dhe pse nuk mund të kthehet atje. Çdo lloj dhune, dëmtimi ose kërcënimi, fizik ose psikologjik, ose kufizimi i lirive dhe të drejtave të tyre, nga autoritetet ose grupet e caktuara në shoqëri ose nga individë apo edhe anëtarë të familjes, mund të jetë i rëndësishëm për kërkesën e tyre.
- Aplikuesi për mbrojtje është i detyruar të tregojë të vërtetën gjatë intervistës personale.
- Azilkërkuuesi duhet gjithashtu të sjellë dhe të paraqesë dokumentet përkatëse dhe/ose çdo provë tjetër që mund të mbështesë kërkesën, duke përfshirë dokumentet që kanë të bëjnë me identitetin dhe prejardhjen e aplikuesit për mbrojtje. Për më shumë informacion shih temën "[Paraqitja e elementeve për të mbështetur kërkesën](#)".
- Nëse informacioni është i disponueshëm, informoni aplikuesin për mbrojtje për kohën dhe vendin e intervistës personale. Mund të përfshihen informacione të tjera praktike, për shembull, si të arrijnë atje dhe kohëzgjatja e përafërt e intervistës. Nëse nuk është e mundur të jepni një datë ose një hark të saktë kohor në organizimin tuaj kombëtar, jepni të paktën një hark kohor të përafërt në mënyrë që të lejoni aplikuesin për mbrojtje të përgatitet për intervistën dhe të mbledhë dokumentet përkatëse.

<sup>(36)</sup> Neni 14(2) i DPA-së (e riformuluar): "Intervista personale në themel të kërkesës mund të mos kryhet në rast se: (a) autoriteti përcaktues është në gjendje të marrë një vendim pozitiv në lidhje me statusin e refugjatit në bazë të provave në dispozicion; ose (b) autoriteti përcaktues është i mendimit se aplikuesi për mbrojtje është i papërshtatshëm ose i paafët për t'u intervistuar për shkak të rrethanave të qëndrueshme jashtë kontrollit të tij ose të saj. Kur ka dyshime, autoriteti përgjegjës duhet të konsultohet me një profesionist të mjekësisë për të përcaktuar nëse kushtet që e bëjnë aplikuesin për mbrojtje të papërshtatshëm ose të paafët për t'u intervistuar kanë natyrë të përkohshme apo afatgjatë."



- Pasojat e mosparaqitjes në intervistë pa dhënë një shpjegim të vlefshëm për autoritetin, në përputhje me ligjin ose praktikën kombëtare.
- Aplikuesëve për mbrojtje që kanë nevojë për garanci të veçanta procedurale do t'u sigurohet mbështetja e duhur. Aplikuesi për mbrojtje duhet të theksojë nëse ka nevoja të veçanta shtesë që nuk dihen ende nga autoriteti. Në varësi të nevojave të veçanta të aplikuesit për mbrojtje, mund të merret një gamë e gjerë masash mbështetëse, për shembull, asistencë e veçantë mjekësore, organizime të veçanta për intervistën dhe zgjatje kohore.
- Intervista organizohet në kushte që garantojnë konfidencialitet dhe pa praninë e familjarëve, përveç rasteve kur prania e tyre konsiderohet e nevojshme <sup>(37)</sup>. Nëse është e nevojshme, informojeni aplikuesin për mbrojtje nëse do t'i duhet të organizojnë përkujdesje për fëmijët e tyre ose nëse kjo do të ofrohet gjatë intervistës në përputhje me praktikën kombëtare.
- Mundësia e pranisë së një këshilltari ligjor gjatë intervistës dhe roli i këshilltarit ligjor.
- Mundësia për të kërkuar marrëveshje të veçanta, duke përfshirë dëshirën për t'u intervistuar nga një zyrtar i çështjes dhe/ose një përkthyes i së njëjtës gjini.
- Informacion bazë për hapat e mëtejshëm, për shembull, koha e nevojshme për autoritetin për të vlerësuar deklaratat e aplikuesëve për mbrojtje dhe çdo informacion tjetër në dispozicion dhe për të marrë një vendim. Aplikuesi për mbrojtje do të marrë një vendim me shkrim që tregon arsyet e vendimit. Në rast të një vendimi negativ, do të shpjegohet mënyra për ta kundërshtuar atë vendim (duke përfshirë informacionin në lidhje me efektet pezulluese).



### **Këshillë praktike për fokusimin vetëm në tema të rëndësishme për fazën e regjistrimit**

Këshillohet që të ndani vetëm informacione bazë dhe të fokusoheni në temat që janë të rëndësishme në fazën e regjistrimit, për shembull, se si aplikuesi për mbrojtje mund të përgatitet për intervistën. Në të njëjtën kohë, shmangni dhënie të detajeve që nuk janë relevante në këtë fazë dhe që do të shtjellohen pasi të bëhet takimi për intervistë, si p.sh. informacione të detajuara për hapin pas përfundimit të intervistës personale.

<sup>(37)</sup> Neni 15(1) i DPA-së (e riformular): “Intervista personale normalisht kryhet pa praninë e pjesëtarëve të familjes, përveç rasteve kur autoriteti përgjegjës e konsideron të domosdoshme praninë e pjesëtarëve të tjerë të familjes për shqyrtimin e duhur të kërkesës.”



### 3.2.6 Afatet kohore për shqyrtimin

#### (a) Informacion mbështetës

Parimi i përgjithshëm është se procedura e shqyrtimit në shkallë të parë (pra, duke mos përfshirë ankesën) përfundon brenda **6 muajve** nga depozitimi i kërkesës <sup>(38)</sup>. Në rrethana të caktuara, të shpjeguara në seksionin vijues, afati kohor mund të zgjatet. Megjithatë, procedura nuk mund të përfundojë më vonë se **21 muaj** nga depozitimi i kërkesës <sup>(39)</sup>.

Afati prej 6 muajsh mund të zgjatet me 9 muaj të tjerë, pra duke arritur një afat total prej 15 muajsh, në rastet e mëposhtme:

- kur përfshihen çështje komplekse të fakteve dhe/ose të ligjit;
- kur ka një numër të madh kërkesash të depozituara në një Shtet Anëtar njëkohësisht;
- nëse vonesa mund t'i atribuohet qartë mosbashkëpunimit të kërkuarit me autoritetin.

Afati kohor prej 15 muajsh mund të zgjatet në mënyrë përjashtimore edhe me 3 muaj të tjerë, pra, duke arritur një afat kohor total prej 18 muajsh, kur është e nevojshme dhe e arsyetuar siç duhet, në mënyrë që të sigurohet shqyrtimi adekuat dhe i plotë i një kërkesë.

Së fundmi, për shkak të një situatë të pasigurt, por të përkohshme në vendin e origjinës, kryerja e procedurës së ekzaminimit mund të shtyhet kur autoriteti përcaktues nuk mund të vendosë brenda afateve të përcaktuara më sipër. Megjithatë, në çdo rast, edhe nëse kryerja e shqyrtimit shtyhet, shqyrtimi duhet të përfundojë brenda 21 muajve.

Për procedurat e përshpejtuara ose procedurat e tjera të veçanta zakonisht zbatohet një kornizë kohore e ndryshme. Për më shumë informacion, ju lutemi referojuni seksionit [3.2.8. "Hapat e ardhshëm mëtejshëm nëse kërkesa kanalizohet përmes një procedure të veçantë shqyrtimi"](#).

Në raste të veçanta, shqyrtimi i një kërkesë mund të ketë prioritet dhe vendimi nxirret brenda një afati më të shkurtër kohor <sup>(40)</sup>. Këto përfshijnë situata kur kërkesa ka të ngjarë të jetë e mirëbazuara dhe statusi i azilit ose mbrojtja plotësuese do t'i jepet dhe/ose kur aplikuesi për mbrojtje është i cenueshëm dhe ka nevojë për garanci të veçanta procedurale, veçanërisht fëmijët e pashoqëruar.

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Procedura e shqyrtimit mund të zgjasë disa muaj (harku i përafërt kohor duhet të tregohet në përputhje me praktikën kombëtare).

<sup>(38)</sup> Neni 6(4) i DPA-së (e riformular). "... një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare konsiderohet e depozituar pasi një formular i paraqitur nga aplikuesi për mbrojtje ose, aty ku përcaktohet në ligjin kombëtar, një raport zyrtar, ka arritur te autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në fjalë."

<sup>(39)</sup> Nenet 31(3),(4),(5) dhe (9) të DPA-së (e riformular), "Procedura e shqyrtimit".

<sup>(40)</sup> Neni 31(7) i DPA-së (e riformular) "Procedura e shqyrtimit".



- Procedura e shqyrtimit normalisht duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe aplikuesit për mbrojtje duhet t'i jepet një vendim brenda 6 muajve pas depozitimit të kërkesës. Kjo nuk përfshin procedurën e apelit.
- Ky afat kohor për dhënie të një vendimi mund të zgjatet në rrethana të caktuara. Megjithatë, afati total nuk do të kalojë 21 muaj. Nëse procedura e shqyrtimit zgjatet, aplikuesi për mbrojtje duhet të informohet brenda një kohe të arsyeshme për arsyet e shtyrjes. Mund të ketë arsye të ndryshme për zgjatjen e afateve kohore, të cilat mund të përfshijnë faktorë të jashtëm, për shembull, në situatat kur bëhet njëkohësisht një numër i madh kërkesash. Vonesat gjithashtu mund të lidhen drejtpërdrejt me vlerësimin e një kërkesë nëse ajo është veçanërisht komplekse.
- Nëse afati kohor për nxjerrjen e një vendimi zgjatet (pra, përtej 6 muajsh), autoritetet do të njoftojnë aplikuesin për mbrojtje. Informojeni aplikuesin për mbrojtje se si do të njoftohet në përputhje me praktikën kombëtare.
- Aplikuesi për mbrojtje mund të pyesë për arsyet e kësaj vonesa dhe të kërkojë një vlerësim se kur do të merret vendimi. Jepni informacion shtesë mbi procedurën për të kërkuar këtë informacion bazuar në praktikën tuaj kombëtare.
- Procedurat dhe afatet kohore mund të jenë të ndryshme nëse kërkesa vlerësohet brenda një procedure të veçantë, siç është procedura e përshpejtuar, procedura në kufi ose procedura e pranueshmërisë. Kërkesës gjithashtu mund t'i jepet përparësi. Në raste të tilla, aplikuesëve për mbrojtje u jepen informacione specifike nga autoritetet kombëtare të azilit.



#### **Këshillë praktike për të dhënë shpjegime shtesë dhe garanci në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës**

Koha e pritjes për të marrë një vendim mund të ndryshojë, në varësi të një game të gjerë faktorësh. Një aplikues për mbrojtje që ka mbërritur më vonë mund të marrë një vendim më herët. Ju duhet ta garantoni aplikuesin për mbrojtje se kjo nuk është arsye për t'u shqetësuar, çdo kërkesë është e ndryshme dhe shqyrtohet individualisht. Aplikuesi për mbrojtje nuk duhet të largohet nga vendi, pasi largimi nga vendi dhe kthimi do të kenë pasoja. Për më shumë informacion, shih temën "[Pasoja të mundshme të mospërbushjeje së detyrimeve dhe për mosbashkëpunimi me autoritetet](#)".

### **3.2.7 Ndalimi**

#### **(a) Informacion mbështetës**

Ndalimi është mbyllja e një aplikuesi për mbrojtje në një vend të caktuar, ku atij i hiqet liria e lëvizjes <sup>(41)</sup>.

<sup>(41)</sup> Neni 2(h) i DKP-së (e riformuluar) "Përkufizimet".





Një aplikues për mbrojtje mund të ndalohet për qëllimet e mëposhtme, kur këto nuk mund të arrihen pa ndalim (duke përfshirë kur ekziston rreziku i arratisjes) <sup>(42)</sup>:

- përcaktimin ose verifikimin e identitetit ose kombësisë së një aplikuesi për mbrojtje;
- përcaktimin e elementeve të kërkesës kur këto nuk mund të merren pa ndalimin, veçanërisht kur ekziston rreziku që aplikuesi për mbrojtje të arratiset;
- vendosja për të drejtën e aplikuesit për mbrojtje për të hyrë në territor;
- përgatitja ose ekzekutimi i një kthimi në bazë të Direktivës së Kthimit të vitit 2008 <sup>(43)</sup>;
- për sigurinë kombëtare ose rendin publik;
- në përputhje me nenin 8(3) të Rregullores së Dublinit III <sup>(44)</sup>.

Një aplikues për mbrojtje mund të ndalohet vetëm për aq kohë sa arsyet janë të zbatueshme dhe për një periudhë sa më të shkurtër të jetë e mundur <sup>(45)</sup>. Për informacion të plotë në lidhje me bazat e ndalimit dhe afatet kohore, referojuni ligjit tuaj kombëtar.

Ndalimi është ndër masat e fundit në mungesë të alternativave efektive, por më pak shtrënguese. Ai aplikohet në bazë të një vlerësimi individual. Në të njëjtën kohë, duhet të përmbushen disa rregulla dhe kushte.

- Aplikuesi për mbrojtje duhet të informohet me shkrim për arsyet e ndalimit të tij dhe zgjidhjet juridike.
- Ligjshmëria e ndalimit duhet të rishikohet në intervale të rregullta ose me kërkesë të aplikuesit për mbrojtje.
- Aplikuesi për mbrojtje duhet të ketë qasje në asistencë ligjore dhe përfaqësim falas për shqyrtimin gjyqësor të urdhrin të ndalimit.
- Aplikuesit për mbrojtje duhet të mbahen, si rregull, në ambiente të specializuara ndalimi, të ndarë nga të burgosurit e zakonshëm.
- Aplikuesit për mbrojtje duhet të kenë qasje në hapësirat e hapura.
- Duhet t'u jepet qasje anëtarëve të familjes dhe këshilltarëve ose konsulentëve, në kushte që respektojnë privatësinë (me përjashtime të kufizuara).
- Aplikuesit për mbrojtje duhet të informohen për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe rregullat në institucionin e ndalimit, në një gjuhë që ata e kuptojnë ose që në mënyrë të arsyeshme supozohet ta kuptojnë.

<sup>(42)</sup> Neni 8(2) dhe nenet 8(3)(a) dhe (b) të DKP-së (e riformular) "Ndalimi".

<sup>(43)</sup> [Direktiva 2008/115/KE](#) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetor 2008 "Për standardet dhe procedurat e përbashkëta në Shtetet Anëtare për kthimin shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të paligjshëm" (Fletorja Zyrtare L 348, 24.12.2008, fq. 98).

<sup>(44)</sup> [Rregullorja \(BE\) nr. 604/2013](#) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, me të cilën përcaktohen kriteret dhe mekanizmat për të përcaktuar Shtetin Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur në një prej Shteteve Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë ose nga një person pa shtetësi (e riformular), (Fletorja Zyrtare nr. L 180, 29.6.2013).

<sup>(45)</sup> Neni 9(1) e DKP-së (e riformular) "Garancitë për aplikuesit për mbrojtje e ndaluar".







- Për grupe të veçanta, siç janë personat e cenueshëm, të miturit (e pashoqëruar) dhe familjet, zbatohen disa rregulla dhe kushte ndalimi, sipas nenit 11 të DKP-së (e riformuluar).

#### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Arsyetja(et) e ndalimit të aplikuesit për mbrojtje dhe kohëzgjatja maksimale e parashikuar nga ligji kombëtar (informacioni duhet dhënë nga autoritetet me shkrim).
- Si të kundërshtoni urdhrin e ndalimit dhe si të kërkonti ndihmë juridike dhe përfaqësim pa pagesë (informacioni duhet të jepet nga autoritetet me shkrim).
- Kontaktet e organizatave ose grupeve të personave që ofrojnë ndihmë juridike.
- Mundësia për të komunikuar me familjen.
- Mundësia për të komunikuar me një përfaqësues të UNHCR-së dhe si të keni qasje te një përfaqësues i UNHCR-së.
- Të drejtat dhe detyrimet e aplikuesit për mbrojtje në objektin e ndalimit <sup>(46)</sup>.
- Për shqyrtimin e kërkesës aplikohen të njëjtat garanci dhe standarde si për çdo aplikues për mbrojtje që nuk është i ndaluar.



#### **Këshillë praktike për të shpjeguar qartë se ndalimi nuk është burg**

Shpjegoni të gjithë nocionin e ndalimit dhe ndryshimin midis burgut dhe ndalimit pasi ky mund të jetë një koncept i ri për disa aplikues për mbrojtje dhe mund të sjellë kujtime traumatike.

### **3.2.8 Hapat e ardhshëm nëse kërkesa kanalizohet përmes një procedure të veçantë shqyrtimi**

#### **i. Procedura e Dublinit**

##### **(a) Informacion mbështetës**

Sapo një shtetas jo i BE-së ose person pa shtetësi paraqet një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në një vend BE+, ai vend duhet të vlerësojë se cili vend i BE-së është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës në përputhje me Rregulloren e Dublinit III <sup>(47)</sup>.

Nëse gjatë fazës së depozitimit regjistrohen “faktorë aktivizues të Dublinit”, aplikuesi për mbrojtje kanalizohet në procedurën e Dublinit, ku dosja e tij trajtohet nga Njësia e Dublinit e vendit tuaj.

<sup>(46)</sup> Neni 9 DKP-së (e riformuluar) “Garancitë në ndalim”.

<sup>(47)</sup> [Rregullorja \(BE\) nr. 604/2013](#) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, me të cilën përcaktohen kriteret dhe mekanizmat për të përcaktuar Shtetin Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur në një prej Shteteve Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë ose nga një person pa shtetësi (e riformuluar), (Fletorja Zyrtare nr. L 180, 29.6.2013).



Prandaj rekomandohet që të jepet informacion bazë për procedurën e Dublinit sa më shpejt të jetë e mundur. Nëse aplikuesi për mbrojtje është një fëmijë i pashoqëruar, duhet të caktohet sa më shpejt të jetë e mundur një përfaqësues ligjor. Një vlerësim i interesit më të lartë të fëmijës do të kryhet si pjesë e procedurës për përcaktimin e vendit të BE+ përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

Dispozita të hollësishme në lidhje me zbatimin e Rregullores së Dublinit III jepen në Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 1560/2003, e ndryshuar nga Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) Nr. 118/2014 <sup>(48)</sup>. Ai përmban gjithashtu tekstet e plota të fletëpalosjeve të zakonshme informative, duke përfshirë një fletëpalosje specifike për të miturit e pashoqëruar, të cilat janë hartuar për t'u shpjeguar aplikuesëve për mbrojtje procedurën e Dublinit dhe që duhet t'u jepen atyre.



### Instrumenti i EUAA-së për këtë aspekt

Për më shumë informacion referoju EASO, *Udhëzues praktik për dhënien e informacionit mbi procedurën e Dublinit*, dhjetor 2021. Informacioni rreth kriterëve të Dublinit jepet në seksionin 1.7. "Kriteret e përdorura për të përcaktuar përgjegjësinë dhe hierarkinë e tyre".

Referojuni gjithashtu modulit të trajnimit të EUAA-së mbi identifikimin e rasteve të Dublinit.

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Informojeni aplikuesin për mbrojtje se procedura e Dublinit është një sistem i BE-së për të përcaktuar se cili vend BE+ është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës të tyre për mbrojtje ndërkombëtare. Kjo do të thotë se aplikuesi për mbrojtje nuk mund të zgjedhin vendin në të cilin bëjnë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare. Autoritetet do të përcaktojnë se cili vend do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës të tyre.
- Aplikuesi për mbrojtje nuk duhet të largohet nga vendi i cili është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së tij dhe të shkojë në një vend tjetër me nismën e vet përpara përfundimit të procedurës. Nëse e bën këtë, ai do të kthehet në vendin që është përgjegjës për kërkesën e tij.
- Shpjegojini aplikuesit për mbrojtje se është e rëndësishme të bashkëpunojë me autoritetet dhe të japë informacionin përkatës, veçanërisht nëse ai ka një anëtar të familjes në një vend tjetër evropian, pasi mund të ribashkohet me ta përmes procedurës së Dublinit.

<sup>(48)</sup> [Rregullorja e Komisionit \(KE\) Nr. 1560/2003](#) e datës 2 shtator 2003 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 343/2003 që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil të paraqitur në një nga Shtetet Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë (Fletorja Zyrtare Nr. L 222, 5.9.2003, fq. 3), e ndryshuar nga Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) Nr. 118/2014 e datës 30 janar 2014.



- Nëse zbulohen faktorë aktivizues të Dublinit, jepni informacion shtesë në lidhje me procedurën e Dublinit dhe shpërndani fletëpalosjen e informacionit që është zhvilluar për këtë qëllim <sup>(49)</sup>.



### Këshillë praktike për njohjen e ndjeshmërisë së temës dhe inkurajimin e aplikuesit për mbrojtje për të bërë pyetje

Kjo temë për dhënie e informacionit mund të jetë e ndjeshme pasi përfshin mundësinë e ribashkimit me të afërmit. Për këtë arsye, inkurajojeni aplikuesin për mbrojtje të bëjë pyetje. Kjo do të ndihmojë për të sqaruar çdo keqkuptim dhe për të pakësuar pritshmëritë e mundshme që nuk janë në përputhje me procedurën e Dublinit.

#### ii. Kërkesat e mëvonshme

##### (a) Informacion mbështetës

Në rast se për kërkesën e mëparshme është marrë vendimi i formës së prerë (qoftë ky vendim negativ ose vendim me të cilin jepet mbrojtje plotësuese), kërkesa e re do të regjistrohet si kërkesë e mëvonshme dhe do të kryhet shqyrtimi paraprak për të vlerësuar elementët e rinj.

Kërkesa e re do të jetë e pranueshme nëse elementë të rinj shtojnë ndjeshëm mundësinë për t'u kualifikuar si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare. Në një rast të tillë, kërkesa e mëpasshme do të jetë e pranueshme dhe shqyrtimi i kërkesës do të vazhdojë.

Ajo do të jetë e papranueshme nëse nuk jepen elementë të rinj nga aplikuesi për mbrojtje ose nuk dalin gjetje të reja. Në një rast të tillë, autoriteti përcaktues nuk do ta shqyrtojë kërkesën e aplikuesit për mbrojtje në bazë të meritave <sup>(50)</sup>.

E drejta për të qëndruar në vendin pritës gjatë shqyrtimit mund të jetë e kufizuar nëse aplikuesi për mbrojtje ka përfituar tashmë nga një shqyrtim i plotë i dy ose më shumë kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare të cilat janë refuzuar <sup>(51)</sup>.

<sup>(49)</sup> Aneksi X e [Rregullores së Komisionit \(KE\) Nr. 1560/2003](#) e datës 2 shtator 2003 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 343/2003 që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil të paraqitur në një nga Shtetet Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë (Fletorja Zyrtare Nr. L 222, 5.9.2003, fq. 3), e ndryshuar nga Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) Nr. 118/2014 e datës 30 janar 2014.

<sup>(50)</sup> Neni 40(2), (3) dhe (5) të DPA-së (e riformular) "2. ... një kërkesë e mëvonshme për mbrojtje ndërkombëtare do t'i nënshtrohet fillimisht një shqyrtimi paraprak nëse kanë dalë ose janë paraqitur elementë ose gjetje të reja nga aplikuesi për mbrojtje që kanë të bëjnë me shqyrtimin nëse aplikuesi për mbrojtje kualifikohet si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare ... 3. Nëse ekzaminimi paraprak ... arrin në përfundimin se kanë dalë ose janë paraqitur elementë ose gjetje të reja ... kërkesa do të shqyrtohet më tej në përputhje me Kapitullin II. ... 5. "Nëse kërkesa e mëvonshme nuk shqyrtohet më tej sipas këtij Neni, ajo konsiderohet e papranueshme, sipas Nenit 33(2)(d)".

<sup>(51)</sup> Neni 41(1) i DPA-së (e riformular). "1. Shtetet Anëtare mund të bëjnë përjashtim nga e drejta për të qëndruar në territor ku një person: a. ka depozituar një kërkesë të parë vijuese, e cila nuk shqyrtohet më tej në përputhje me nenin 40(5), thjesht për të vonuar ose penguar zbatimin e një vendimi që do të rezultonte në dëbimin e tij të afërt nga ai Shtet Anëtar; ose b. bën një kërkesë tjetër vijuese në të njëjtin Shtet Anëtar, pas një vendimi të formës së prerë që e konsideron një kërkesë të parë vijuese të papranueshme në përputhje me nenin 40(5) ose pas një vendimi të formës së prerë për ta refuzuar atë kërkesë si të pabazuar. Shtetet Anëtare mund të bëjnë një përjashtim të tillë vetëm kur autoriteti përcaktues konsideron se një vendim kthimi nuk do të çojë në rikthim direkt ose indirekt në shkelje të detyrimeve ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian që ka ai Shtet Anëtar."





## Instrumenti i EUAA-së për këtë aspekt

Për më shumë informacion lutemi referoju EASO, *Udhëzues praktik për kërkesat vijuese*, dhjetor 2021.

### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Informojeni aplikuesin për mbrojtje se kërkesa e tij e mëparshme ka përfunduar dhe kërkesa e tij e re do të vlerësohet si kërkesë vijuese. Kërkesa vijuese nuk është një mundësi tjetër për të apeluar vendimin e mëparshëm, por një mundësi për të paraqitur elementë të rinj, ose ngjarje të reja që kanë ndodhur pas refuzimit të kërkesës së mëparshme ose prova ose dokumente të reja që lidhen me arsyet pse aplikuesi për mbrojtje nuk mund të kthehet në vendin e tij, të cilat nuk mund të prezantoheshin më parë.
- Informojeni aplikuesin për mbrojtje se si mund të paraqiten elementët dhe shpjegimet e reja në përputhje me praktikën kombëtare. Aplikuesit për mbrojtje mund t'i kërkohej gjithashtu të shpjegojë për arsyet pse këto elemente të reja nuk u paraqitën më parë dhe, sipas rastit, mënyrën se si këta elementë të rinj lidhen me (një) kërkesë(a) të mëparshme.
- Informojeni aplikuesin për mbrojtje se në hapin e ardhshëm autoriteti do të vlerësojë elementët e rinj. Ky vlerësim quhet shqyrtim paraprak. Ai mund të arrijë në përfundimin se kërkesa vijuese është ose e pranueshme ose e papranueshme. Ju gjithashtu mund ta informoni aplikuesin për mbrojtje për afatin kohor të shqyrtimit paraprak.
- Nëse është në përputhje me praktikën kombëtare, informojeni aplikuesin për mbrojtje se shqyrtimi mund të kryhet vetëm në bazë të parashtrimeve me shkrim, pa intervistë personale <sup>(52)</sup>.
- Nëse është e nevojshme, informojeni aplikuesin për mbrojtje se e drejta për të qëndruar në vendin pritës mund të kufizohet dhe kushtet e pritjes mund të reduktohen ose të hiqen.

### iii. Procedura e pranueshmërisë

#### (a) Informacion mbështetës

Çdo vend BE+ mund të përcaktojë procedurat e pranueshmërisë brenda legjisllacionit të vet kombëtar të azilit në mënyrë që të vendosë nëse një kërkesë është e papranueshme dhe nuk do të vlerësohet më tej në bazë të meritave.

Arsyet për kanalizimin e një kërkesë për azil në procedurën e pranueshmërisë lidhen me rrethanat e mëposhtme.

<sup>(52)</sup> Neni 42(2)(b) DPA-së (e riformuluar) "Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë në legjisllacionin kombëtar rregulla për shqyrtimin paraprak në përputhje me nenin 40. Këto rregulla, ndër të tjera, mund: a. të lejojnë që shqyrtimi paraprak të kryhet vetëm në bazë të parashtrimeve me shkrim pa intervistë personale, me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 40(6)."



- Një shtet tjetër anëtar i ka dhënë aplikuesin për mbrojtje, mbrojtje ndërkombëtare <sup>(53)</sup>.
- Aplikuesi për mbrojtje është njohur si refugjat nga një vend tjetër jashtë BE-së ose ai mund të gëzojë mbrojtje të mjaftueshme në atë vend, duke përfshirë përfitimin nga parimi i **moskthimit** <sup>(54)</sup>.
- Aplikuesi për mbrojtje ka një lidhje me një vend të tretë që konsiderohet si vend i tretë i sigurt <sup>(55)</sup> nga vendi pritës, ku aplikuesi për mbrojtje mund të kërkojë mbrojtje ndërkombëtare <sup>(56)</sup>.
- Një aplikues për mbrojtje në ngarkim dëshiron të paraqesë një kërkesë më vete, por autoritetet mendojnë se nuk ka fakte që justifikojnë një kërkesë të tillë pas pëlqimit të aplikuesit për mbrojtje për një kërkesë në emër të tij ose të saj <sup>(57)</sup>.

#### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Informoni aplikuesin për mbrojtje se kërkesa e tij do të vlerësohet në një procedurë pranueshmërie dhe shpjegoni arsyen(et) e veçantë. Autoriteti do të vlerësojë vetëm arsyen(et) se përse kërkesa e tij është kanalizuar në procedurën e pranueshmërisë, por jo arsyet pse aplikuesi për mbrojtje është larguar nga vendi i tij dhe nuk mund të kthehet atje, të cilat do të vlerësohen vetëm nëse kërkesa konsiderohet e pranueshme.
- Aplikuesin për mbrojtje kanë të drejtë të paraqesin pikëpamjet e tyre në lidhje me arsyen(et) pse ata janë kanalizuar në procedurën e pranueshmërisë përmes një interviste personale <sup>(58)</sup>.
- Sa herë që një kërkesë konsiderohet e papranueshme, përshtatshmëria e aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare nuk do të shqyrtohet më tej dhe për këtë arsye procedura administrative do të përfundojë.
- Aplikuesi për mbrojtje ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi të pranueshmërisë.

#### **iv. Procedura e përshpejtuar**

##### **(a) Informacion mbështetës**

Bazuar në DPA-në (e riformuluar) <sup>(59)</sup> dhe legjislacionin kombëtar, vendi juaj mund të kryejë një shqyrtim sipas procedurës së përshpejtuar mbi bazat e mëposhtme.

- Aplikuesi për mbrojtje po paraqet fakte që nuk janë relevante për shqyrtimin nëse ai kualifikohet për mbrojtje ndërkombëtare.
- Aplikuesi për mbrojtje është nga një vend origjine i sigurt.

<sup>(53)</sup> Neni 33(2a) i DPA-së (e riformuluar).

<sup>(54)</sup> Neni 33(2a) i DPA-së (e riformuluar).

<sup>(55)</sup> Neni 38 i DPA-së (e riformuluar) "Koncepti i vendit të tretë të sigurt".

<sup>(56)</sup> Neni 33(2c) i DPA-së (e riformuluar).

<sup>(57)</sup> Neni 33(2e) i DPA-së (e riformuluar).

<sup>(58)</sup> Neni 34(1) i DPA-së (e riformuluar) "Rregulla të veçanta mbi intervistën e pranueshmërisë".

<sup>(59)</sup> Neni 31(8) i DPA-së (e riformuluar) "Procedura e shqyrtimit e përshpejtuar".





- Aplikuesi për mbrojtje ka mashtruar autoritetet duke u dhënë informacione ose dokumente të rreme ose duke fshehur informacione ose dokumente të rëndësishme për identitetin dhe/ose kombësinë e tij, të cilat mund të kishin ndikim negativ në vendim.
- Ka të ngjarë që, në keqbesim, aplikuesi për mbrojtje të ketë shkatërruar ose asgjësuar dokumentet e identifikimit ose të udhëtimit të cilat do të kishin ndihmuar në përcaktimin e identitetit ose kombësisë së tij.
- Aplikuesi për mbrojtje ka dhënë dëshmi qartësisht kundërshtuese dhe kontradiktore, të rreme ose logjikisht të pamundshme, të cilat kundërshtojnë informacionet e verifikuara mjaftueshëm nga vendi i origjinës, duke i bërë deklaratimet e tij tërësisht mosbindëse;
- Aplikuesi për mbrojtje ka paraqitur një kërkesë vijuese që nuk është e papranueshme dhe për këtë arsye nuk do të shqyrtohet në thelb.
- Aplikuesi për mbrojtje po bën një kërkesë thjesht për të vonuar ose penguar një urdhër largimi.
- Aplikuesi për mbrojtje ka hyrë në territorin e Shtetit Anëtar në mënyrë të paligjshme ose ka zgjatur qëndrimin e tij në mënyrë të paligjshme dhe, pa një arsye të vlefshme, nuk është paraqitur vetë te autoritetet ose nuk ka dorëzuar kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare sa më shpejt të ishte e mundur, nisur nga rrethanat e hyrjes së tij në territor.
- Aplikuesi për mbrojtje refuzon të respektojë detyrimin për marrjen e gjurmëve të gishtave.
- Aplikuesi për mbrojtje, për arsye serioze, mund të konsiderohet si rrezik për sigurinë kombëtare ose rendin publik të Shtetit Anëtar, ose aplikuesi për mbrojtje është dëbuar me forcë për arsye serioze të sigurisë publike ose rendit publik sipas ligjit kombëtar.

#### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Informojeni aplikuesin për mbrojtje se kërkesa e tij do të vlerësohet në një procedurë të përshpejtuar dhe shpjegoni arsyen(et) e veçantë.
- Kjo do të thotë se afati kohor për të vendosur për kërkesën është më i shkurtër. Nëse është e mundur, informojeni aplikuesin për mbrojtje për afatin e saktë kohor në përputhje me praktikën tuaj kombëtare.
- Afati kohor për paraqitjen e apelimit kundër vendimit negativ është reduktuar. Informojeni aplikuesin për mbrojtje për afatin e saktë të apelimit në përputhje me praktikën tuaj kombëtare.
- Përveç afateve më të shkurtra, kërkesa e tij do të vlerësohet me të njëjtat standarde, të drejta dhe detyrime si procedura e rregullt.

#### **v. Procedura në kufi**

##### **(a) Informacion mbështetës**

Vendi juaj mund të ketë miratuar një procedurë të veçantë për kërkesat e bëra në kufi ose në një zonë tranziti, sipas së cilës shqyrtimi bëhet në kufi ose në zonat tranzit përpara se të jepet e





drejta e hyrjes në territor. Arsyet mbi të cilat një kërkesë për azil mund të vlerësohet në kufi ose në zonat e tranzitit janë për të shqyrtuar:

- pranueshmërinë e një kërkesë;
- thelbin e një kërkesë që mund të vlerësohet sipas procedurës së përshpejtuar.

Në të dyja rrethanat, vendimi duhet të merret në një afat kohor të arsyeshëm. Kur një vendim nuk mund të merret brenda 4 javësh, aplikuesi për mbrojtje duhet të autorizohet të hyjë në territorin e Shtetit Anëtar, ku do të bëhet vlerësimi i kërkesës së tij sipas procedurës normale <sup>(60)</sup>.

#### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Aplikuesi për mbrojtje nuk mund të hyjë në territorin e vendit sepse vendi ka miratuar një procedurë të veçantë të quajtur procedurë në kufi e cila zhvillohet në kufi ose në zonën e tranzitit. Informojeni aplikuesin për mbrojtje për arsyen për të cilën është miratuar procedura në kufi dhe nëse kërkesa do të vlerësohet në procedurën e pranueshmërisë.
- Nëse kërkesa konsiderohet e pranueshme, thelbi i saj do të shqyrtohet në një afat kohor të reduktuar. Nëse është e mundur, informojeni aplikuesin për mbrojtje për kornizën e saktë kohore në përputhje me praktikën tuaj kombëtare.
- Nëse kërkesa refuzohet, aplikuesi për mbrojtje do të ketë një afat kohor të reduktuar për të paraqitur një apelim, në përputhje me modalitetet e parashikuara në legjislacionin tuaj kombëtar. Informojeni aplikuesin për mbrojtje për afatin e saktë të apelimt në përputhje me praktikën tuaj kombëtare.
- Në çdo rast, nëse brenda 4 javësh nuk është marrë një vendim apo vendim i formës së prerë, aplikuesi për mbrojtje do të ketë të drejtë hyrjeje në territor.

### 3.3 Të drejtat e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare

Të drejtat e aplikuesit për mbrojtje zbatohen që nga momenti i kryerjes së kërkesës <sup>(61)</sup>. Prandaj, është e rëndësishme të jepet informacion mbi këto të drejta sa më shpejt që të jetë e mundur <sup>(62)</sup>.

<sup>(60)</sup> Neni 43 (2) i DPA-së (e riformuluar) "Procedura në kufi".

<sup>(61)</sup> GjDBE, gjykimi i datës 25 qershor 2020, *VL kundër Ministerio Fiscal*, C-36/20 PPU, EU:C:2020:495, paragrafët 90–92.

<sup>(62)</sup> EASO, *Udhëzuesi praktik mbi regjistrimin – Depozitimi i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare*, dhjetor 2021, fq. 19.



### 3.3.1 Qëndrimi në vendin që është në pritje të procedurës së shqyrtimit

#### (a) Informacion mbështetës

Aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare kanë të drejtë të qëndrojnë në vend gjatë shqyrtimit të kërkesës së tyre. E drejta për të qëndruar është një parim kyç i procedurës së azilit. Ajo zbatohet si rregull i përgjithshëm gjatë shqyrtimit të një kërkesë <sup>(63)</sup>.

Ka përjashtime të kufizuara nga kjo e drejtë (në rrethana shumë strikte) të cilat janë të ndryshme gjatë shkallës së parë dhe apelimit.

Gjatë shkallës së parë, përjashtimet mund të zbatohen vetëm në kontekstin e një kërkesë vijuese <sup>(64)</sup> ose të një ekstradimi <sup>(65)</sup>.

**Përjashtimet nga e drejta për të qëndruar në kontekstin e një kërkesë vijuese** zbatohen kur është bërë një kërkesë shtesë vijuese (kur një aplikues për mbrojtje ka bërë tre ose më shumë kërkesa dhe veçanërisht kur një aplikues për mbrojtje ka bërë një kërkesë të dytë), pasi e mëparshmeja është gjetur e papranueshme ose është refuzuar si e pabazuar.

**Përjashtimi në kontekstin e një ekstradimi** zbatohet kur Shteti Anëtar do të dorëzojë ose ekstradojë aplikuesin për mbrojtje pas një urdhër-arresti evropian ose për arsye të tjera të një Shteti Anëtar tjetër, të një vendi të tretë ose të një tribunali ose gjykatë ndërkombëtare. Ekstradimi nuk mund të bëhet nëse autoritetet nuk janë të bindura se personi nuk do të ekspozohet ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të **kthimit** (Neni 9(3) i DPA-së).

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Aplikuesi për mbrojtje ka të drejtë të qëndrojë në vend për aq kohë sa kërkesa e tij është duke u shqyrtuar. Përndryshe, duhet të jepet informacion në lidhje me përjashtimin, nëse është e nevojshme. Referojuni këshillës praktike të mëposhtme për “dhënien e detajeve mbi përjashtimet vetëm nëse janë të rëndësishme për aplikuesin për mbrojtje”.
- E drejta e qëndrimit përfundon kur merret një vendim i formës së prerë për refuzimin e kërkesës. “Vendim i formës së prerë” nënkupton një vendim që nuk i nënshtrohet më një zgjidhjeje juridike.

<sup>(63)</sup> Neni 9(1) i DPA-së (e riformuluar) “E drejta për të qëndruar në territorin e Shtetit Anëtar në pritje të shqyrtimit të kërkesës”.

<sup>(64)</sup> Neni 41(1) i DPA-së (e riformuluar) “Përjashtimet nga e drejta për të qëndruar në rast kërkesash vijuese”.

<sup>(65)</sup> Neni 9(2) i DPA-së (e riformuluar) “E drejta për të qëndruar në territorin e Shtetit Anëtar në pritje të shqyrtimit të kërkesës”.





### **Këshillë praktike për dhënien e detajeve mbi përjashtimet vetëm nëse janë të rëndësishme për aplikuesin për mbrojtje**

Nuk ka nevojë të informohen të gjithë aplikuesit për mbrojtje për përmbajtjen e përjashtimeve. Informacioni që detajon përjashtimet duhet t'u jepet vetëm atyre aplikuesëve për mbrojtje për të cilët mund të zbatohen këto përjashtime, pra, vetëm aplikuesëve për mbrojtje që paraqesin një kërkesë vijuese ose aplikuesëve për mbrojtje që preken nga një ekstradim.

## **3.3.2 E drejta për të pasur përkthyes**

### **(a) Informacion mbështetës**

Nëse komunikimi i duhur nuk mund të sigurohet pa përkthim, aplikuesi për mbrojtje ka të drejtë të marrë shërbimet e një përkthyesi, pa pagesë, të paktën gjatë intervistës personale <sup>(66)</sup>.

### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Aplikuesi për mbrojtje, kur është e nevojshme, do të ndihmohet gjatë intervistës personale nga një përkthyes i gjuhës së preferuar ose të paktën i një gjuhe që ai e kupton dhe në të cilën mund të komunikojë qartë.
- Përkthimi ofrohet pa pagesë.
- Aplikuesi për mbrojtje duhet të përmendë gjithmonë kur ka vështirësi për të kuptuar përkthyesin, ose kur përkthyesi nuk vepron në mënyrë neutrale.
- Përkthyesi ka detyrimin të zbatojë parimet e konfidencialitetit dhe paanshmërisë. Ai nuk mund të flasë për asgjë që u tha gjatë intervistës jashtë situatës së përkthimit. Përkthyesi nuk ka asnjë ndikim në rezultatin e vendimit.
- Roli i përkthyesit është rreptësisht i kufizuar në përkthimin e asaj që thuhet, pa shtuar ose hequr informacion.
- Është e mundur të kërkohet një përkthyes mashkull ose femër nëse kjo e ndihmon aplikuesin për mbrojtje të paraqesë kërkesën e tij ose të saj. Kërkesa do të plotësohet nëse është e mundur.



### **Këshillë praktike mbi sqarimin se e drejta për përkthim vlen vetëm për procedurën e azilit**

Nëse aplikuesi për mbrojtje kërkon përkthim për qëllime personale, shpjegoni aplikuesit për mbrojtje se përkthyesi është i disponueshëm vetëm për çështjet që lidhen me kërkesën e tyre për mbrojtje ndërkombëtare kur ka të bëjë me autoritetet. Kjo do të thotë që ndihma e një përkthyesi nuk përfshin, për shembull, ndihmën për një takim mjekësor. Për pyetje të tilla, jepni këshilla se ku mund të marrë ndihmë aplikuesi për mbrojtje, sipas praktikës suaj kombëtare.

<sup>(66)</sup> Neni 12(1)(b) i DPA-së (e riformuluar) "Garancitë për aplikuesin për mbrojtje".

### 3.3.3 Asistenca dhe përfaqësimi ligjor

#### (a) Informacion mbështetës

Aplikuesi për mbrojtje ka të drejtën e asistencës ligjore dhe përfaqësimit në të gjitha fazat e procedurës së azilit. Asistenca ligjore dhe përfaqësimi duhet të ofrohet pa pagesë të paktën në fazën e apelimit. Për fazat e tjera (regjistrimi dhe shkalla e parë), mund të jetë ose jo pa pagesë, në varësi të ligjeve dhe politikave kombëtare <sup>(67)</sup>.

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Aplikuesi për mbrojtje ka të drejtën e qasjes në asistencë dhe përfaqësim ligjor në çdo moment gjatë procedurës, duke përfshirë regjistrimin.
- Informojeni aplikuesin për mbrojtje për format e disponueshme të asistencës dhe përfaqësimit ligjor në vendin tuaj, për shembull, avokatë privatë, avokatë të përkushtuar që bashkëpunojnë me shërbimin e azilit dhe ndihmën juridike të ofruar nga organizatat e shoqërisë civile.
- Informojeni aplikuesin për mbrojtje se si mund të ketë qasje në asistencën dhe përfaqësimin ligjor.
- Informojeni aplikuesin për mbrojtje se kur asistenca ligjore është me shpenzimet e tij dhe kur ofrohet pa pagesë.



#### Këshilla praktike

- **Shpjegoni nocionin e përfaqësimit ligjor**

Shpjegoni të gjithë nocionin e përfaqësimit ligjor, pasi ky mund të jetë një koncept i ri për disa aplikues për mbrojtje. Përfshini një shpjegim në lidhje me rolin e përfaqësuesit ligjor, çfarë lloj shërbimesh/mbështetjeje mund të ofrojë përfaqësuesi ligjor, për shembull, këshilla ligjore në lidhje me çështjen e aplikuesit për mbrojtje dhe procedurat, përgatitjen e aplikuesit për mbrojtje për intervistë dhe asistencë në përgatitjen e apelimit dhe dokumenteve të tjera zyrtare.

- **Theksoni të drejtën e aplikuesit për mbrojtje për t'u informuar**

Mund të theksohet se aplikuesi për mbrojtje në përgjithësi ka të drejtë të bëjë pyetje dhe mund t'u kërkojë autoriteteve informacion në lidhje me procedurën, informacionin ligjor ose kërkesën e tij. Marrja e informacionit është falas.

<sup>(67)</sup> Neni 22 i DPA-së (e riformuluar) "E drejta për asistencë dhe përfaqësim ligjor në të gjitha fazat e procedurës".



### 3.3.4 E drejta për të komunikuar me UNHCR-në dhe organizata të tjera që ofrojnë konsulencë ligjore

#### (a) Informacioni mbështetës

Aplikuesi për mbrojtje ka të drejtë të komunikojë me UNHCR-në në të gjitha fazat e procedurës së azilit, duke përfshirë nëse aplikuesi për mbrojtje është në ndalim ose në zonat e tranzitit të aeroportit ose portit <sup>(68)</sup>. Pothuajse çdo vend mbulohet nga përfaqësimi i UNHCR-së dhe zakonisht do të ketë një faqe interneti të UNHCR-së që mbulon vendin tuaj në veçanti, që ofron të dhëna kontakti dhe informacion për personat në fjalë të UNHCR-së.

#### (b) Mesazh për dhënie e informacionit

- UNHCR-ja është agjencia e Kombeve të Bashkuara e mandatuar për të mbrojtur azilkërkuesit, refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat pa shtetësi në mbarë botën.
- Aplikuesi për mbrojtje ka të drejtë të komunikojë me UNHCR-në dhe të kërkojë konsulencë ose këshillë ligjore nga UNHCR-ja (dhe organizatat që punojnë në emër të saj) në çdo fazë të procedurës së azilit.
- Shpjegoni se si mund të kihet qasje te UNHCR-ja, duke përfshirë të dhënat e kontaktit të aplikueshme.



#### Këshillë praktike për të shpjeguar se çfarë është UNHCR-ja dhe çfarë bën ajo

Roli i UNHCR-së mund të jetë i paqartë për aplikuesit për mbrojtje dhe ata mund të mos e kuptojnë se deri në çfarë mase UNHCR-ja është e rëndësishme për situatën e tyre dhe çfarë mund të presin ose jo. Për këtë arsye, shpjegoni qëndrimin e UNHCR-së, çfarë lloj mbështetjeje mund të ofrojë UNHCR-ja, për shembull, këshillë ligjore për çështjen e aplikuesit për mbrojtje dhe procedurat, përgatitjen e aplikuesit për mbrojtje për intervistë dhe ndihmë në përgatitjen e dokumenteve zyrtare.

### 3.3.5 E drejta për kushte materiale pritjeje

Në varësi të situatës së aplikuesit për mbrojtje, ai do të marrë strehim, ushqim ose para për të blerë ushqime, kujdes mjekësor bazë dhe të nevojshëm, ndihmë sociale dhe arsimim për fëmijët.

Informacione të mëtejshme mbi të drejtën e kushteve materiale të pritjes jepen në platformën Let's Speak Asylum, e cila përmban të gjitha produktet e zhvilluara në kuadër të projektit Let's Speak Asylum. Platforma mund të qaset përmes faqes së internetit të EUAA-s.

<sup>(68)</sup> Neni 29 i DPA-së (e riformuluar) "Roli i UNHCR-së".



### 3.3.6 Tërheqja e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare

#### (a) Informacion mbështetës

Një tërheqje mund të jetë e nënkuptuar ose e qartë. Tërheqja e qartë ndodh kur aplikuesi për mbrojtje informon në mënyrë të qartë administratën se dëshiron të tërheqë kërkesën e tij. Kërkesa e aplikuesit për mbrojtje, në përgjithësi, duhet të regjistrohet me shkrim <sup>(69)</sup>. Një tërheqje është e nënkuptuar kur aplikuesit për mbrojtje e braktisin procedurën e azilit pa i informuar autoritetet. Për informacion në lidhje me tërheqjen e nënkuptuar, shih seksionin 3.5.1 “Kërkesa mund të konsiderohet si e tërhequr ose e braktisur në mënyrë të nënkuptuar”.

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Një aplikues për mbrojtje mund ta ndërpresë kërkesën e tij për mbrojtje ndërkombëtare në çdo kohë, për shembull, nëse vendos të kthehet në vendin e origjinës. Kjo quhet tërheqje e qartë.
- Pas tërheqjes së kërkesës në mënyrë të qartë, procedura e ekzaminimit përfundon. Si rrjedhojë, do të marrin fund edhe të drejtat që u jepen aplikuesëve për mbrojtje, përfshirë këtu të drejtën për të qëndruar në territorin e Shtetit Anëtar, me përjashtim të rastit kur ka arsye të tjera për të qëndruar në këtë shtet.
- Për të tërhequr kërkesën, aplikuesi për mbrojtje duhet të shprehë synimin për të tërhequr kërkesën e tij. Shpjegoni se si mund të bëhet kjo.
- Informojeni aplikuesin për mbrojtje për mundësinë për të marrë ndihmë me kthimin vullnetar (për më shumë informacion, shihni temën “Kthimi vullnetar”).

### 3.3.7 Të drejtat në lidhje me fëmijët (e pashoqëruar).

#### i. Caktimi i një përfaqësuesi/kujdestari

##### (a) Informacion mbështetës

Fëmijëve të pashoqëruar duhet t’u caktohet një kujdestar ligjor sa më shpejt të jetë e mundur dhe fëmija duhet të informohet menjëherë për caktimin. Për specifikat në lidhje me caktimin e një kujdestari ligjor, procedurën dhe afatet, ju lutemi referojuni ligjit tuaj kombëtar. Për fëmijët e pashoqëruar zbatohen dispozitat specifike në lidhje me pritjen <sup>(70)</sup>.

Një kujdestar vepron në emër të fëmijës në përputhje me interesin e tij më të lartë dhe e ndihmon fëmijën gjatë gjithë procedurës së azilit, duke u siguruar që fëmija të mund të përfitojë nga të drejtat e tij dhe të përmbushë detyrimet <sup>(71)</sup>. Një kujdestar sigurohet për interesin më të lartë të fëmijës, duke përfshirë që të adresohen nevojat e tij ligjore, mjekësore dhe të tjera siç duhet gjatë procedurës së azilit <sup>(72)</sup>. Kujdestari duhet të ketë ekspertizën e

<sup>(69)</sup> Neni 27 i DPA-së (e riformular) “Procedura në rast të tërheqjes së kërkesës”.

<sup>(70)</sup> Neni 24 i DKP-së.

<sup>(71)</sup> Shih seksionin 3.4 “Detyrimet e një aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare”.

<sup>(72)</sup> Neni 25(1)(a) i DPA-së (e riformular) “Garancitë për të miturit e pashoqëruar”; Nenet 31(1) dhe (2) të DK (e riformular) “Të miturit e pashoqëruar”.



nevojshme për të kryer detyrat e tij dhe do të ndryshohet vetëm kur është e nevojshme. Për informacion në lidhje me caktimin ose mundësinë për të ndryshuar një kujdestar, ju lutemi referojuni praktikës suaj kombëtare.

### (b) Mesazh për dhënie e informacionit

- Do të caktohet një kujdestar ligjor për të ndihmuar fëmijën e pashoqëruar dhe për të vepruar në emër të tij gjatë gjithë procedurës së azilit.
- Roli i një kujdestari ligjor është të qëndrojë në kontakt me autoritetet dhe të shoqërojë fëmijën e pashoqëruar gjatë takimeve, duke përfshirë intervistën personale, të informojë fëmijën për procedurën, të sigurohet që janë adresuar nevojat e fëmijës dhe të sigurohet që janë marrë në konsideratë pikëpamjet e fëmijës së pashoqëruar.
- Fëmija i pashoqëruar mund t'i drejtohet kujdestarit për çdo shqetësim ose pyetje që mund të ketë në çdo kohë gjatë procedurës së azilit.
- Duke pasur parasysh moshën e fëmijës, jepni shpjegime shtesë në lidhje me procedurën e caktimit të kujdestarit ligjor.
- Fëmija i pashoqëruar duhet të informojë autoritetet nëse ka shqetësime apo ankesa në lidhje me bashkëpunimin me kujdestarin ligjor. Duhet të jepet informacion se si t'i drejtohen autoriteteve dhe të paraqesin një ankesë zyrtare dhe mbi mundësinë e ndryshimit të kujdestarit ligjor.

Burim i dobishëm: Manuali i Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA), *Kujdestaria për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror* <sup>(73)</sup>.



### Këshillë praktike për të qenë shumë i qartë për rolin e kujdestarit ligjor

Sigurohuni që fëmija të kuptojë se roli i kujdestarit ligjor është ta mbështesë atë dhe mirëqenien e tij. Ai nuk duhet të hezitohet t'i tregojë kujdestarit pikëpamjet e tij, nevojat, shqetësimet, dëshirat, etj. Në të njëjtën kohë, shpjegojini se çfarë nuk është në kompetencat e kujdestarit. Për shembull, kujdestari ligjor nuk jeton me fëmijën ose nuk siguron para. Ju mund ta informoni fëmijën për strehimin dhe përfitimet që do të marrë.

### ii. Gjurmimi i familjes, anëtarëve të familjes në vende të tjera BE+ dhe bashkimi familjar

#### (a) Informacion mbështetës

DK-ja (e riformuluar) thekson parimin e unitetit të familjes. Nëse aplikuesi për mbrojtje nuk e di se ku janë prindërit ose kujdestarët e tij, ose nuk është në gjendje të kontaktojë me ta, administrata do të nisë një procedurë për të zbuluar se ku është familja dhe do t'i kontaktojë ata. Gjurmimi i anëtarëve të familjes duhet të nisë sa më shpejt që të jetë e mundur pasi

<sup>(73)</sup> FRA, *Kujdestaria për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror – Një manual për të përforcuar sistemet e kujdestarisë për të përmbushur nevojat specifike të fëmijëve viktimë të trafikimit*, 2015.



të bëhet kërkesa <sup>(74)</sup>. Mbledhja e informacionit për të afërmit e fëmijës duhet të bëhet në përputhje me parimin e konfidencialitetit. Gjurmimi i familjes duhet të jetë në interesin më të lartë të fëmijës <sup>(75)</sup>.



### Instrumenti i EUAA-së për këtë aspekt

Për më shumë informacion shih EASO, *Udhëzues praktik mbi gjurmimin e familjes*, mars 2016.

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Është e rëndësishme që aplikuesi për mbrojtje të japë çdo informacion në lidhje me vendndodhjen e prindërve ose kujdestarëve të tyre, të dhënat e tyre të kontaktit dhe çdo informacion tjetër përkatës.
- Është e rëndësishme që aplikuesi për mbrojtje të ndajë çdo shqetësim dhe arsye përse nuk do të donte që prindërit ose kujdestarët të kontaktoheshin.
- Sigurojeni aplikuesin për mbrojtje për konfidencialitetin. Informacioni që ai jep për anëtarët e familjes nuk do të ndahet me njerëzit që nuk kanë të drejtë ta dinë, për shembull, në vendin e origjinës. Pjesëtarët e familjes nuk do të vihen në rrezik.

### 3.3.8 Të drejtat për aplikuesit për mbrojtje për mbrojtje me nevoja të veçanta

#### i. Mbështetje e përshtatshme për të përfituar nga të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet gjatë procedurës së azilit

##### (a) Informacion mbështetës

*Disa aplikues për mbrojtje mund të kenë nevojë për garanci të veçanta procedurale, ndër të tjera, për shkak të moshës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, sëmundjeve të rënda, çrregullimeve mendore ose si pasojë e torturave, përdhunimit ose formave të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale <sup>(76)</sup>.*

Autoritetet kanë detyrimin të vlerësojnë nëse aplikuesi për mbrojtje ka nevojë për garanci të veçanta procedurale. Kur është kështu, aplikuesëve për mbrojtje duhet t'u sigurohet mbështetja dhe koha e duhur dhe kushtet e përshtatshme për të siguruar qasje efektive në procedurat e azilit dhe për t'u siguruar që ata mund të përfitojnë nga të drejtat dhe të përmbushin detyrimet <sup>(77)</sup>.

<sup>(74)</sup> Neni 24(3) i DKP-së është gjithashtu i rëndësishëm, pasi detyrimi për të filluar gjurmimin e familjes sa më shpejt që të jetë e mundur pas kërkesës buron prej tij.

<sup>(75)</sup> Neni 31(5) i DK-së (e riformuluar) "Të miturit e pashoqëruar".

<sup>(76)</sup> Teksti shpjegues 29 i DPA-së (e riformuluar).

<sup>(77)</sup> Neni 24(1) dhe (3) i DPA-së (e riformuluar) "Aplikuesit për mbrojtje që kanë nevojë për garanci të veçanta procedurale".





Procedurat që lidhen me identifikimin e nevojave të veçanta dhe natyra e mbështetjes do të varen nga nevojat individuale procedurale të aplikuesit për mbrojtje dhe nga praktika kombëtare. Kjo mund të përfshijë, për shembull, shërbime specifike për grupe të veçanta, të tilla si:

- asistencë mjekësore dhe psikologjike për aplikuesit për mbrojtje me aftësi të kufizuara ose aplikuesit për mbrojtje me probleme shëndetësore;
- mbështetje për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, siç është mekanizmi kombëtar i referimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore;
- shërbime të specializuara sociale për fëmijët, si përkujdesja për fëmijët;
- caktimi i një përfaqësuesi/kujdestari, që ofron ndihmë shtesë me procedurat dhe formalitetet përkatëse ose informacion mbi mundësinë e caktimit të një përfaqësuesi për aplikuesit për mbrojtje me aftësi të kufizuara intelektuale ose me çrregullime të rënda të shëndetit mendor.

#### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Aplikuesi për mbrojtje duhet të informojnë autoritetet nëse nuk janë mirë, nëse kanë nevojë për ndihmë psikologjike ose mjekësore, nëse janë shtatzënë, nëse kanë pasur përvoja të rënda traumatike, si tortura, përdhunim dhe forma të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale, në mënyrë që të marrin mbështetjen e duhur. Kjo duhet të përfshijë gjithashtu informimin e autoriteteve për çdo shqetësim për mbrojtjen në vendin pritës.
- Nëse aplikuesi për mbrojtje ka nevoja të veçanta, shpjegoni se si do të adresohen nevojat, mbështetjen e disponueshme dhe masat mbrojtëse procedurale përkatëse në përputhje me praktikën kombëtare. Këto mund të përfshijnë dhënien e kohës shtesë, caktimin e personelit të specializuar për çështjen dhe mundësinë për të kërkuar një oficer çështjeje dhe përkthyes mashkull ose femër.



#### **Këshillë praktike për marrjen në konsideratë të nevojës për marrëveshje të veçanta për intervistën personale**

Profile specifike (p.sh. aplikues për mbrojtje me aftësi të kufizuara, prindër të vetëm me fëmijë) mund të kenë nevojë për informacion shtesë në lidhje me organizime specifike për intervistën personale.

## 3.4 Detyrimet e një aplikuesi për mbrojtje ndërkombëtare

Detyrimet e aplikuesit për mbrojtje zbatohen që nga fillimi i procedurës së azilit. Prandaj, është e rëndësishme të jepet informacion mbi këto detyrime sa më shpejt që të jetë e mundur.

Është e rëndësishme të informohet aplikuesi për mbrojtje që nëse nuk mund të përmbushë një ose më shumë detyrime, duhet t'u drejtohet autoriteteve dhe të shpjegojë arsyet.



### 3.4.1 Bashkëpunimi me autoritetet

#### (a) Informacion mbështetës

Aplikuesi për mbrojtje ka detyrimin të bashkëpunojë me autoritetet për të përcaktuar identitetin e tij dhe elementë të tjerë si deklaratat e tij, dokumentacioni që disponon në lidhje me moshën, prejardhjen (duke përfshirë atë të të afërmeve përkatës), identitetin, kombësinë(të), shtetin(et) dhe vendin(et) e vendbanimit të mëparshëm, kërkesat e mëparshme për dokumente mbrojtjeje ndërkombëtare, rrugët e udhëtimit, dokumentet e udhëtimit dhe arsyet e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

Gjithashtu, në varësi të ligjeve dhe politikave tuaja kombëtare, aplikuesi për mbrojtje mund të ketë detyrimin të raportojë ose të paraqitet personalisht përpara autoriteteve kompetente <sup>(78)</sup> ose sa më shpejt të jetë e mundur ose kur i caktohet takim.

Mund të jetë gjithashtu e zbatueshme në kontekstin tuaj kombëtar që deklaratat verbale gjatë intervistës personale të regjistrohen <sup>(79)</sup>.

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Aplikuesi për mbrojtje duhet të bashkëpunojë me autoritetet për t'u lejuar autoriteteve të përpunojnë çështjen e tij.
- Aplikuesi për mbrojtje duhet të paraqitet personalisht para autoritetit nëse ka një takim. Shpjegoni se çfarë të bëjë dhe cilat hapa duhet të ndërmerren nëse aplikuesi për mbrojtje nuk mund të marrë pjesë në takim.
- Aplikuesi për mbrojtje duhet t'u japë autoriteteve të gjitha informacionet dhe dokumentet në dispozicion për të përcaktuar identitetin dhe kombësinë e tij.
- Aplikuesi për mbrojtje duhet t'u japë autoriteteve të gjithë informacionin që ka lidhje me kërkesën e tij, duke përfshirë dokumentacionin dhe provat e tjera që disponon.
- Aplikuesi për mbrojtje nuk duhet të japë informacion të rremë tek autoritetet.
- Aplikuesi për mbrojtje duhet t'u përgjigjet kërkesave për informacion (nëse kjo kërkohet në ligjin tuaj kombëtar).
- Shpjegoni se si aplikuesit për mbrojtje, në praktikë, mund të japin informacion dhe të paraqesin prova dokumentare tek autoritetet. Kjo përfshin se në cilën zyrë duhet të jepet informacioni dhe me çfarë mjetesh (p.sh. me postë, me email ose duke u paraqitur personalisht).
- Aplikuesi për mbrojtje duhet të qëndrojë në dispozicion të autoriteteve gjatë të gjithë procedurës së azilit

<sup>(78)</sup> Neni 13(2)(a) i DPA-së (e riformuluar) "Detyrimet e aplikuesëve për mbrojtje".

<sup>(79)</sup> Neni 13(2)(e) i DPA-së (e riformuluar) "Detyrimet e aplikuesëve për mbrojtje".





- Nëse është e nevojshme, autoriteti do të regjistrojë deklaratat verbale të aplikuesit për mbrojtje. Regjistrimi do të ruhet dhe përdoret në respekt të plotë të parimit të konfidencialitetit.
- Detyrime të tjera që mund të jenë të zbatueshme në kontekstin tuaj kombëtar.

### 3.4.2 Nënshtrimi ndaj kontrollit personal për arsye sigurie

#### (a) Informacion mbështetës

Në varësi të ligjeve dhe politikave tuaja kombëtare, autoritetet kompetente mund të kontrollojnë aplikuesni për mbrojtje dhe sendet që ai mban <sup>(80)</sup>.

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Aplikuesi për mbrojtje mund t'i nënshtrohet një kontrolli personal, duke përfshirë kontrollin e sendeve që ai mban.
- Kontrolli fizik i tyre do të kryhet nga një person i të njëjtës gjini, pa paragjykuar ndonjë kontroll të kryer për arsye sigurie.
- Kontrolli do të kryhet në respekt të plotë të parimeve të dinjitetit njerëzor dhe të integritetit fizik dhe psikologjik. Sendet e tyre personale do t'u kthehen atyre përsëri.

### 3.4.3 Marrja e të dhënave biometrike

#### (a) Informacion mbështetës

Aplikuesi për mbrojtje është i detyruar të japë gjurmët e gishtave maksimumi brenda 72 orëve pas paraqitjes së kërkesës, nëse është më i madh se 14 vjeç <sup>(81)</sup>.

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Aplikuesëve për mbrojtje do t'i merren gjurmët e gishtave. Aplikuesi për mbrojtje ka detyrimin të lejojë marrjen e gjurmëve të gishtave të tij <sup>(82)</sup>.
- Do të merren të 10 gjurmët e gishtave.
- Në kohën kur merren gjurmët e gishtave, shpjegoni se ku, kur, pse dhe nga kush merren gjurmët e gishtave.
  - Në mënyrë që informacioni të jetë më pak mbingarkues, kur shpjegohet arsyeja për të cilën merren gjurmët e gishtave, aplikuesit për mbrojtje mund t'i thuhet, për shembull, se gjurmët e gishtave merren për të parë nëse dikush është tashmë i njohur për autoritetet dhe për të ndihmuar në përcaktimin se cili vend i BE-së është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së tyre.

<sup>(80)</sup> Neni 13(2)(a) i DPA-së (e riformuluar) "Detyrimet e aplikuesëve për mbrojtje".

<sup>(81)</sup> Neni 9(1) i Rregullores (BE) Nr. 603/2013 "Mbledhja, transmetimi dhe krahasimi i gjurmëve të gishtave (ekstrakt)".

<sup>(82)</sup> Neni 9(1) i Rregullores (BE) Nr. 603/2013 "Mbledhja, transmetimi dhe krahasimi i gjurmëve të gishtave (ekstrakt)".



- Nëse aplikuesi për mbrojtje refuzon t'i merren gjurmët e gishtave, mund të zbatohet procedura e përshpejtuar së bashku me pasoja të tjera të mundshme, në varësi të kontekstit tuaj kombëtar.
- Autoriteti do të bëjë një fotografi të aplikuesit për mbrojtje. Aplikuesi për mbrojtje ka detyrimin të lejojë marrjen e fotografisë së tij <sup>(83)</sup>.
- Fotografia dhe të dhënat biometrike do të ruhen dhe përdoren në respekt të plotë të parimit të konfidencialitetit.

Burim i dobishëm: Fletëpalosja e FRA-së “[E drejta për informacion - Udhëzues për autoritetet kur marrin gjurmët e gishtave për Eurodac](#)” <sup>(84)</sup>. Një fletëpalosje e zhvilluar nga Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore për të ndihmuar oficerët dhe autoritetet në informimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare në një mënyrë të kuptueshme dhe të arritshme për përpunimin e gjurmëve të gishtave të tyre në Eurodac.

### 3.4.4 Komunikimi te autoritetet i adresës së kontaktit dhe ndryshimeve në adresë

#### (a) Informacion mbështetës

Në varësi të ligjeve dhe politikave tuaja kombëtare, aplikuesi për mbrojtje mund të ketë detyrimin të informojë autoritetet kompetente për adresën e tij aktuale dhe çdo ndryshim të saj, në mënyrë që ai të mund të kontaktohet nga autoritetet <sup>(85)</sup>.

Gjithashtu, në varësi të strukturës suaj kombëtare, autoritetet mund të vendosin edhe për vendbanimin e aplikuesit për mbrojtje <sup>(86)</sup>.

#### (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Aplikuesi për mbrojtje duhet të informojë autoritetet kompetente për adresën e tij aktuale dhe për çdo ndryshim të saj sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të mund të kontaktohet.
- Aplikuesi për mbrojtje duhet të jetë i kontaktueshëm në adresën më të fundit që ai u ka dhënë autoriteteve; shpjegoni procedurën që duhet ndjekur nëse personi kontaktohet në shtëpi, por nuk është i pranishëm.
- Autoritetet mund të vendosin për vendbanimin e aplikuesit për mbrojtje ose të vendosin kufizime se ku mund të lëvizë aplikuesi për mbrojtje.

<sup>(83)</sup> Neni 13(2)(e) i DPA-së (e riformuluar) “Detyrimet e aplikuesëve për mbrojtje”.

<sup>(84)</sup> FRA, [E drejta për informacion - Udhëzues për autoritetet kur marrin gjurmët e gishtave për Eurodac](#), 2019.

<sup>(85)</sup> Neni 13(2)(c) i DPA-së (e riformuluar) “Detyrimet e aplikuesëve për mbrojtje”.

<sup>(86)</sup> Neni 7(2) i DKP-së (e riformuluar) “Vendbanimi dhe liria e lëvizjes”



### 3.4.5 Paraqitja e elementeve për të mbështetur kërkesën

#### (a) Informacion mbështetës

Aplikuesi për mbrojtje ka për detyrë të mbështesë kërkesën e tij për mbrojtje ndërkombëtare dhe të paraqesë të gjithë elementët përkatës <sup>(87)</sup>. Në varësi të strukturës suaj kombëtare, aplikuesi për mbrojtje mund të ketë detyrimin të paraqesë elementë të tillë sa më shpejt që të jetë e mundur, ose brenda afatit kohor të përcaktuar në ligjin tuaj kombëtar nëse ekziston një afat i tillë <sup>(88)</sup>. Nëse sipas legjislacionit kombëtar, aplikuesit për mbrojtje i kërkohet të paraqesë dëshmi sa më shpejt të jetë e mundur, ky informacion duhet t'i jepet aplikuesit për mbrojtje në fillim të procesit. Në varësi të rrethanave, “sa më shpejt të jetë e mundur” do të thotë edhe sapo të jenë elementët **në dispozicion**, edhe sapo aplikuesi për mbrojtje **të ketë njohuri** të elementëve të tillë.

Këta elementë përbëhen nga deklaratat e aplikuesit për mbrojtje dhe të gjithë dokumentacionin në dispozicion të aplikuesit për mbrojtje në lidhje me veten e tij, duke përfshirë:

- moshën;
- formimin, duke përfshirë atë të të afërmeve përkatës;
- identitetin;
- kombësinë(të);
- vendin(et) e origjinës dhe vendndodhjen(et) e mëparshme të banimit;
- kërkesat e mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare;
- rrugët e udhëtimit;
- dokumentet e udhëtimit; dhe
- arsyet pse ka kërkuar mbrojtje ndërkombëtare.

Shembuj të llojeve të dokumenteve përfshijnë:

- dokumente personale/identiteti:
  - pasaportë,
  - kartë identiteti,
  - kartë identiteti e shkollës,
  - certifikatë lindjeje,
  - patentë,

<sup>(87)</sup> Neni 4(2) i DK-së (e riformuluar) “Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave”.

<sup>(88)</sup> Neni 4(1) i DK-së (e riformuluar) “Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave”.





- libri familjar,
  - certifikatë martese,
  - letërnjoftim ushtarak,
  - dëshmi punësimi,
  - certifikata, etj.,
  - kartë që tregojnë anëtarësimin në një parti politike;
- dokumente që mbështesin kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare:
    - fotografi;
    - vendime/urdhra gjykatë,
    - urdhër-arreste,
    - raportet nga hetimet policore dhe dokumente të tjera nga policia,
    - letra kërcënuese/paralajmëruese,
    - artikuj gazetash (duke përfshirë referenca për emra specifikë),
    - certifikatë pagëzimi,
    - postime në rrjetet sociale, etj.;
  - raporte dhe vërtetime mjekësore/psikologjike:
    - raport mjekësor/letër nga një mjek,
    - raport psikologjik,
    - vërtetim i akteve të dhunshme / torturave, etj.;
  - dokumente duke përfshirë materialet digjitale:
    - faqet e internetit,
    - blogje ose media të tjera sociale,
    - video, etj.

Në varësi të ligjeve dhe politikave tuaja kombëtare, aplikuesi për mbrojtje mund të ketë gjithashtu detyrimin të dorëzojë të gjitha dokumentet në zotërim të tij që janë të rëndësishme për shqyrtimin e kërkesës së tij, të tilla si pasaportat e tij <sup>(89)</sup>.

---

<sup>(89)</sup> Neni 13(2)(b) i DPA-së (e riformuluar) "Detyrimet e aplikuesëve për mbrojtje".





## (b) Mesazh për dhënien e informacionit

- Detyra e aplikuesit për mbrojtje për të bashkëpunuar përfshin një detyrim për të paraqitur elementë për të mbështetur kërkesën e tij për mbrojtje ndërkombëtare (sa më shpejt të jetë e mundur).
- Elementët përbëhen nga:
  - deklaratat e aplikuesit për mbrojtje, duke përfshirë arsyet e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare;
  - të gjithë dokumentacionin që disponon, duke përfshirë dokumentet personale/ të identitetit, dokumentet që lidhen me kërkesën e tij dhe raportet dhe vërtetimet mjekësore/psikologjike.
  - prova të tjera si përmbajtja e mediave sociale, video ose materiale të tjera digjitale.
- Informoni aplikuesin për mbrojtje për mjetet, vendin (adresat), marrësin dhe kohën që aplikuesi për mbrojtje mund të paraqesë prova, sipas ligjeve dhe politikave tuaja kombëtare.
- Mbuloni pikat e mëposhtme në lidhje me dokumentacionin.
  - Aplikuesi për mbrojtje **nuk duhet** të paraqesë dokumente që janë të rreme ose të falsifikuara pasi kjo mund të ndikojë negativisht në kërkesën e tij.
  - Shkatërrimi i dokumenteve të identitetit mund të ndikojë negativisht në kërkesën e tij.
  - Aplikuesi për mbrojtje duhet të japë dokumentet e tij origjinale nëse ka.
  - Dokumentet përkatëse duhet të dorëzohen sa më shpejt që të jetë e mundur tek autoritetet përkatëse.
  - Nëse është e aplikueshme, informojeni aplikuesin për mbrojtje për afatet kohore për të dorëzuar dokumentet për të plotësuar regjistrimin.
  - Shpjegoni se nuk ka nevojë të paraqesë dokumente që përmbajnë vetëm informacione të përgjithshme për vendin e tij të origjinës.
  - Shpjegoni se si, në praktikë, mund të japin informacion dhe të paraqesin prova dokumentare tek autoritetet. Kjo përfshin se në cilën zyrë duhet të jepet informacioni dhe me çfarë mjetesh (p.sh. me postë, me email ose duke u paraqitur personalisht).
  - Inkurajojeni aplikuesin për mbrojtje të bëjë ç'është e mundur të gjejë ndonjë dokument që mungon. Megjithatë, duhet ta bëni të qartë se nuk pritet që aplikuesi për mbrojtje të ekspozojë ndaj rrezikut veten ose persona të tjerë në përpjekje për të gjetur dokumente, qoftë duke kontaktuar autoritetet në vendin e origjinës, nëse kjo gjë do të përbënte rrezik.
  - Shpjegoni se si do të trajtohen dokumentet origjinale (p.sh. nëse autoriteti do t'i mbajë ato, nëse do të kopjohen dhe si dhe kur do të kthehen).
  - Specifikoni që nuk është problem nëse dokumentet origjinale janë në gjuhë të huaj.





### Këshilla praktike

- **Këshillojeni aplikuesin për mbrojtje të bëjë një kopje të dokumenteve origjinale**

Nëse aplikuesi për mbrojtje po dorëzon dokumente origjinale, ai duhet të këshillohet të bëjë një kopje të tyre për t'i mbajtur.

- **Përdorni teknika komunikimi për të mbuluar këtë temë komplekse**

Meqenëse informacioni në lidhje me detyrimet është mjaft kompleks, pas dhënies së informacionit, mund ta përmbledhni informacionin dhe të nënvizoni përsëri pikat kryesore. Është gjithashtu praktike ta ndani në pjesë informacionin, duke lejuar diskutime/pyetje të shkurtra përpara se të vazhdoni.

## 3.5 Pasoja e mundshme të mospërmbushjes së detyrimeve dhe për mosbashkëpunimin me autoritetet

Pasoja e mundshme të mospërmbushjes së detyrimeve mund të zbatohen gjatë procesit të regjistrimit dhe gjatë shqyrtimit të kërkesës. Duke qenë se pasoja të tilla mund të zbatohen në fillim të procedurës së azilit, është e rëndësishme të jepet informacion për këto pasoja sa më shpejt që të jetë e mundur.

### 3.5.1 Kërkesa mund të konsiderohet si e tërhequr ose e braktisur në mënyrë të nënkuptuar

#### (a) Informacion mbështetës

Autoriteti mund të supozojë se aplikuesi për mbrojtje ka hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga kërkesa e tij në një nga situatat e mëposhtme <sup>(90)</sup>.

- Aplikuesi për mbrojtje nuk arriti të depozitonte kërkesën e tij pasi e bëri një të tillë <sup>(91)</sup>.
- Aplikuesi për mbrojtje nuk u përgjigj kërkesave për të dhënë informacion thelbësor për kërkesën e tij.
- Arsye të tjera. Për një listë të plotë, referojuni pikës së mëposhtme (b) “Mesazh për dhënien e informacionit”.

Supozimi hiqet nëse aplikuesi për mbrojtje demonstron brenda një kohe të arsyeshme se veprimet e tij ishin për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të tij.

<sup>(90)</sup> Neni 28 i DPA-së (e riformular) “Procedura në rast të tërheqjes ose braktisjes së nënkuptuar të kërkesës”.

<sup>(91)</sup> Neni 6(2) i DPA-së (e riformular): “[...] Kur aplikuesi për mbrojtje nuk e depoziton kërkesën e tij ose të saj, Shtetet Anëtare mund të zbatojnë nenin 28, [procedurën në rast të tërheqjes ose braktisjes së nënkuptuar të një kërkesë], përkatësisht.”



Në rast të një tërheqjeje të nënkuptuar, autoriteti përcaktues do të marrë një vendim për:

- ndërprerjen e shqyrtimit; ose
- refuzimin e kërkesës.

Nëse vendimi është për të ndërprerë shqyrtimin, por aplikuesi për mbrojtje paraqitet sërish te autoriteti kompetent:

- çështja mund të rihapet; ose
- aplikuesi për mbrojtje mund të paraqesë një kërkesë të re e cila nuk do të konsiderohet si kërkesë vijuese.

Vendi BE+ mund të caktojë një afat kohor prej të paktën 9 muajsh, pas të cilit çështja nuk mund të rihapet, ose kërkesa e re do të konsiderohet si kërkesë vijuese.

Vendi BE+ mund të parashikojë që një çështje mund të rihapet vetëm një herë <sup>(92)</sup>.

#### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Nëse aplikuesi për mbrojtje nuk bashkëpunon me autoritetet, largohet (përgjithmonë) nga akomodimi pa informuar autoritetet ose nuk paraqitet për takime, kjo mund të ndikojë negativisht te kërkesa, e cila mund të ndërpritet ose refuzohet dhe, për rrjedhojë, aplikuesi për mbrojtje nuk do të konsiderohet më aplikues për mbrojtje.
- Kërkesa mund të ndërpritet ose refuzohet në rastet e mëposhtme, përveçse kur aplikuesi për mbrojtje demonstroi se veprimet e tij ishin për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të tij.
  - Nëse aplikuesi për mbrojtje nuk e ka përfunduar procedurën e regjistrimit dhe, në veçanti, nuk ka arritur të përfundojë depozitimin, që është hapi i fundit.
  - Nëse aplikuesi për mbrojtje nuk jep informacion thelbësor për kërkesën e tij, pasi i kërkohet ky informacion.
  - Nëse aplikuesi për mbrojtje nuk paraqitet për një intervistë personale ose takim tjetër.
  - Nëse aplikuesi për mbrojtje largohet (përgjithmonë ose për një kohë të gjatë) nga vendi ku ka jetuar pa informuar autoritetin përkatës.
  - Nëse aplikuesi për mbrojtje nuk ka përmbushur detyrimin e raportimit ose detyrimet e tjera për të komunikuar.
- Megjithatë, nëse kërkesa ndërpritet, ajo mund të rihapet, ose mund të paraqitet një kërkesë e re pa u konsideruar si kërkesë vijuese. Kjo mund të ndodhë nëse aplikuesi për mbrojtje paraqitet sërish pranë autoritetit kompetent brenda një kohe të caktuar të përcaktuar në kontekstin tuaj kombëtar.

<sup>(92)</sup> Neni 28(1) i DPA-së (e riformuluar) "Procedura në rast të tërheqjes ose braktisjes së nënkuptuar të kërkesës".





### **Këshillë praktike për dhënien e shembujve për të kuptuar mospërputhjen dhe pasojat e saj**

Është e dobishme të jepen shembuj praktikë, për shembull, nëse një aplikuesi për mbrojtje ka një takim për të depozituar kërkesën e tij dhe nuk paraqitet pavarësisht se është ftuar disa herë, kjo do të konsiderohet moskryerje e depozitimit, përveç se kur ka arsye të vlefshme për të mos ndjekur procesin e depozitimit (p.sh. arsye mjekësore).

## **3.5.2 Mund të ketë ndikim te vlerësimi i elementeve të rëndësishme të kërkesës për azil**

### **(a) Informacion mbështetës**

Në përgjithësi, aplikuesi për mbrojtje ka detyrimin të paraqesë të gjithë elementët e nevojshëm për të mbështetur kërkesën e tij sa më shpejt të jetë e mundur. Elementë të tillë përfshijnë informacione të rëndësishme për kërkesën e tij së bashku me të gjitha provat mbështetëse në dispozicion të tij <sup>(93)</sup>.

Dhënia e informacionit ose e provave të paplota ose të rreme mund të çojë në refuzimin e kërkesës. Nëse aplikuesi për mbrojtje prezanton në mënyrë të rreme ose lë jashtë fakte, duke përfshirë përdorimin e dokumenteve të rreme, të cilat ishin vendimtare për dhënien e mbrojtjes, gjithashtu mund të revokohet statusi i refugjatit dhe statusi i mbrojtjes plotësuese <sup>(94)</sup>.

### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Aplikuesi për mbrojtje duhet të paraqesë të gjithë elementët përkatës.
- Nëse aplikuesi për mbrojtje jep informacion, deklarata ose dokumente mashtruese në lidhje me identitetin e tij ose arsyet për të bërë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, kjo mund të ndikojë negativisht te vlerësimi. Informacioni i paplotë ose i rremë do të ndikojë në vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës dhe mungesa e besueshmërisë mund të jetë një arsye për të refuzuar kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.

## **3.5.3 Procedura e azilit mund të përshpejtohet**

### **(a) Informacion mbështetës**

Në një numër të kufizuar situatash, autoritetet mund të vendosin të aplikojnë procedurën e përshpejtuar, rast në të cilin një kërkesë shqyrtohet brenda afateve më të shkurtra kohore.

Në varësi të legjislacionit tuaj kombëtar, procedura e përshpejtuar mund të aplikohet, ndër të tjera, kur aplikuesi për mbrojtje jep informacione ose dokumente të rreme ose të paplota, nëse aplikuesi për mbrojtje refuzon t'i merren gjurmët e gishtave ose nëse ka të ngjarë që,

<sup>(93)</sup> Neni 4(1) i DK-së (e riformuluar) "Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave".

<sup>(94)</sup> Neni 14(3)(b) dhe neni 19(3)(b) i DK-së (e riformuluar).





në keqbesim, ai ka shkatërruar ose asgjësuar dokumentin e disponuar të identitetit <sup>(95)</sup>. Për më shumë detaje mbi procedurën e përshpejtuar shih temën e informacionit “[Procedura e përshpejtuar](#)”.

#### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

Procedura e përshpejtuar mund të aplikohet nëse aplikuesi për mbrojtje nuk bashkëpunon me autoritetet. Për shembull, nëse paraqet informacion të rremë ose dokumente false, refuzon t’i merren gjurmët e gishtave ose ka shkatërruar ose asgjësuar dokumentet e identitetit.

### **3.5.4 Kushtet materiale të pritjes mund të pakësohen ose të hiqen**

#### **(a) Informacion mbështetës**

Kushtet materiale të pritjes mund të reduktohen ose, në raste të jashtëzakonshme, të hiqen nëse aplikuesi për mbrojtje braktis vendbanimin ose nuk përmbush detyrimin e raportimit <sup>(96)</sup>.

#### **(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Në varësi të ligjit dhe praktikës suaj kombëtare, pasojat e mundshme të mosbashkëpunimit me autoritetet ose të pamundësisë për t’u kontaktuar nga autoritetet përfshijnë që të drejtat e pritjes mund të reduktohen ose të hiqen. Vendimet në lidhje me reduktimin ose heqjen e kushteve materiale të pritjes mund t’i nënshtrohen një procedure apelimi.

## **3.6 Kthimi vullnetar**

#### **(a) Informacion mbështetës**

Dhënia e informacionit për kthimin vullnetar nuk synon të jetë një inkurajim për të ndjekur kthimin vullnetar dhe nuk duhet të kuptohet në këtë mënyrë nga aplikuesi për mbrojtje. Megjithatë, kthimi vullnetar mund t’i përgjigjet, për arsye të ndryshme (personale), nevojës së aplikuesit për mbrojtje, edhe midis atyre që kanë ardhur së fundmi.

Aplikuesit për mbrojtje mund të largohen vullnetarisht në çdo moment gjatë procedurës së azilit dhe të kthehen në vendin e tyre të origjinës ose në vendbanimin e zakonshëm. Aplikuesi për mbrojtje mund të përballen me dyshime dhe paqartësi kur bëhet fjalë për mundësinë e kthimit dhe shpesh marrin informacione kontradiktore. Informacioni në kohë për mundësitë e kthimit mund t’i pengojë personat të qëndrojnë në procedurën e azilit dhe/ose në rrethana të

<sup>(95)</sup> Neni 31(8)(c) dhe (i) i DPA-së (e riformuluar) “Detyrimet e aplikuesëve për mbrojtje”.

<sup>(96)</sup> Neni 20(1)(a) dhe (b) i DKP-së (e riformuluar) “Reduktimi ose heqja e kushteve materiale të pritjes”: “Shtetet Anëtare mund të reduktojnë ose, në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara mjaftueshëm, të heqin kushtet materiale të pritjes kur një aplikues për mbrojtje: a. braktis vendbanimin e përcaktuar nga autoriteti kompetent pa e informuar atë ose, nëse është kërkuar, pa leje; ose b. nuk zbaton detyrimin e raportimit ose kërkesat për të dhënë informacion ose për t’u paraqitur për intervista personale në lidhje me procedurën e azilit gjatë një periudhe të arsyeshme të përcaktuar në ligjin kombëtar”.





vështira në territorin e vendit pritës për një kohë të panevojshme dhe të gjatë pas dhënies së një vendimi të formës së prerë.

Nëse aplikuesi për mbrojtje vendos të kthehet, në varësi të praktikës kombëtare, ai mund të jetë në gjendje të marrë këshillë dhe ndihmë nga administrata ose organizata të tjera <sup>(97)</sup>. Autoritetet mund të ofrojnë:

- informacione të përgjithshme dhe këshillë për kthimet vullnetare;
- prokurimin e dokumentacionit të nevojshëm të udhëtimit;
- rezervimin e fluturimeve dhe organizimin e udhëtimit;
- kostot financiare të udhëtimit të tyre;
- një grant të vogël për integrimin pas kthimit;
- regjistrimin në një program riintegrimi.

**(b) Mesazh për dhënien e informacionit**

- Ekziston dhe disponohet një program asistence për kthimin vullnetar.
- Shpjegoni elementët kryesorë të programit të asistencës.
- Tregojini aplikuesit për mbrojtje se cilat autoritete ose organizata të kontaktojë për informacione të mëtejshme mbi programin e asistencës për kthimin vullnetar.

---

<sup>(97)</sup> Organizata Ndërkombëtare për Migracionin është një nga organizatat më të rëndësishme që ndihmon për kthimet. Ndihmë mund të ofrohet edhe nga organizata të tjera dhe organizata joqeveritare (p.sh. Caritas International) ose drejtpërdrejt nga autoritetet shtetërore, etj.







Publications Office  
of the European Union

